



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/060 – 74479

Më: 18 qershor 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras mbledhjen e V/2025 (e pestë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **30 qershor 2025 (e hënë)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 11:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 29 maj 2025 e vazhduar më 03 qershor 2025 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore - KAB (2026-2028);
5. Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025;
6. Informatë rreth furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Prizrenit;
7. Raporti i punës së njësive për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për periudhën janar-qershor 2025;



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Br. 001/060 – 74479

Dana: 18 jun 2025

Na osnovu člana 43 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 30 stav 1 i člana 35 stav 2, Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15. oktobra 2008. godine sazivam V/2025 (petu) redovnu sednicu Skupštine opštine Prizren, koja će se održati **30 juna 2025 (ponedeljak)**, u sali za sastanke Skupštine opštine Prizren, u "Beloj Kući", sa početkom od **11:00 časova**.

Stoga ste pozvani da u svojstvu odbornika Skupštine opštine učestvujete u radu ove sednice pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ove sednice predlažem sljedeći:

D N E V N I R E D

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sjednice od 29. maja 2025. godine, nastavljene 3. juna 2025. godine (redovna);
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Pitanja članova skupštine i pokretanje raznih pitanja;
4. Razmatranje i usvajanje Srednjoročnog budžetskog okvira - SOB (2026-2028);
5. Šestomjesečni izvještaj o radu gradonačelnika za 2025. godinu;
6. Informacija o snabdijevanju pitkom vodom u opštini Prizren;
7. Izvještaj o radu Jedinice za ljudska prava i rodnu ravnopravnost za period januar-juna 2025. godine;

Predsjedavajuća Skupštine
Antigona Bytyqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ

No. 001/060 – 74479

Tarih: 18 Haziran 2025

Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetimi Yasasının 43.maddesi, Belediye Meclis toplantılarının düzenlenmesi için 02/2015 sayılı (YYB) İdari Yönergenin 3. Maddesi, 1. Fıkrası, 1.2. noktası, 5. Maddesi ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35.maddesi, 2.fıkrası gereğince **30 Haziran 2025** tarihinde (Perşembe günü) saat **11.00'dan** başlayarak "Beyaz Evde" Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin V. / 2025 (Beşinci) düzenli oturumunu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz.

İşbu Oturum Çalışması için aşağıdaki:

GÜNDEMİ

öneriyorum

1. 29 Mayıs 2025 tarihindeki (olağan oturum) tutanağın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların ortaya atılması;
4. (2026-2028) Orta Vadeli Bütçe Çerçevesi - KAB görüşülmesi ve kabul edilmesi;
5. Belediye Başkanının 2025 yılı altı aylık çalışma raporu;
6. Prizren Belediyesi'nde içme suyu temini hakkında bilgi;
7. İnsan Hakları ve Toplumsal Cinsiyet Eşitliği Biriminin Ocak-Haziran 2025 dönemine ilişkin çalışma raporu;



Meclis Başkanı
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja IV/ 2025 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 maj 2025 e vazhduar më 03 qershor 2025, duke filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 32 anëtarë të Kuvendit të Komunës, u bashkëngjitën edhe anëtarë të tjerë gjatë zhvillimit të mbledhjes.

Të pranishëm në mbledhje ishin: Kryetari, Nënkryetari dhe Drejtorët Komunal.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar drejtor, zëvendës kryesues, media, shoqëri civile, të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Për sot kemi ftuar mbledhjen e katër të rregullt të kuvendit për vitin 2025. Të pranishëm jemi 32 anëtarë të kuvendit, kështu që konstatoj se kemi kuorum për me i vazhduar punimet e kësaj seance. Dhe rendi i ditës për sot që është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa është ky:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 24 prill 2025 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraparak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të Shoqërisë Civile;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovicë;
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për Emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-212080, të datës 15 dhjetor 2016 – Zonave të Qarkullimit Publik në Komunën e Prizrenit.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 24 prill 2025 (e rregullt);

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë pa humbur kohë po fillojmë menjëherë me pikën e parë që ka të bëjë me procesverbalet. A ka dikush diçka me shtuar rreth procesverbaleve? Në qoftë se jo po e hedhi në votim. Jemi 34 anëtarë prezent. Kush është për që të miratohen procesverbalet? Ju kisha lut ta marrni pak dorën më lart derisa t'i numërojmë. 33 jemi për, 0 kundër, 0 abstenim. Atëherë miratohet pika e parë e rendit të ditës. Ju faleminderit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush diçka me shtu? Në qoftë se jo jetekemi 35 anëtarë. Kush është për që të miratohet ky rend i ditës? Unanimisht. ju falenderoj të gjithëve. Kryetar, mirëse erdhët.

3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Kush dëshiron prej anëtarëve të kuvendit me e marrë fjalën? Mund të lajmëroheni. Po, Agnesa Sinanaj.

Agnesa Sinanaj: Përshëndetje për të gjithë. Unë e kam një kërkesë për drejtorinë e shërbimeve publike, edhe pse s'qenka drejtori, unë dua me lexu. Është prej banorëve të lagjes Naim Berisha në Tuzus, në komunën e Prizrenit. Përmes kësaj kërkesë ju drejtohen me shqetësim të vazhdueshëm, lidhur me gjendjen jashtëzakonisht të keqe të rrugës së tyre, si dhe mungesën totale të rrjetit të ujësjellësit, që deri më tani nuk është trajtuar asnjëherë nga organet përgjegjëse të qeverive lokale paraprake. Rruga është në gjendje të dëmtuar dhe vështirë e kalueshme, çka paraqet vështirësi të mëdha për lëvizjen e këmbësorëve dhe automjeteve. Sidomos gjatë kushteve të këqija atmosferike e mos të flasim më për gjendjen gjatë sezonës dimrore. Kjo gjendje jo vetëm që e vështirëson jetën e përditshme të banorëve, por paraqet edhe rrezik për shëndetin dhe sigurinë publike. Përveç kësaj, lagjia e tyre vazhdon të përballet me mungesën e ujësjellësit, gjë që e bën jetën e banorëve jashtëzakonisht të vështirë dhe është në kundërshtim me të drejtën elementare për çasjen në ujë të pastër dhe të sigurt. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe urgjencën e këtyre problemeve, kërkoj ndërhyrjen e juaj sa më të shpejt. Për rregullimin e rrugës Naim Berisha në afatin më të shkurtër të mundshëm sipas matjeve tuaja dhe vendosjen dhe funksionalizimin e rrjetit të ujësjellësit në këtë lagje. Ju lutem që ta trajtoni këtë kërkesë me prioritet të lartë dhe të i njoftoni për hapat konkretë që do të ndërmerren në këtë drejtim. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Agnesa. Ju kisha lutur anëtarëve të kuvendit që të mundoheni ta respektoni kohën prej dy minutash. Fjalën e ka Haziz Hodaj, përgatitet Qemal Krasniqi.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit, faleminderit kryesuese edhe faleminderit zëvendëskryesues zoti Hoxha për ndërhyrjen, për vërejtjen. Përshëndetje për kryetarin, për ju, për ekzekutivin, të gjithë për anëtarët e kuvendit, median. Unë kam një pyetje edhe unë për drejtorinë e shërbimeve publike, por drejtori s'qenka këtu, sigurisht që e merr përsipër kryetari me u përgjigj. Nuk e kam të qartë neglizhencën e kryerjes punimeve të rrugës kryesore në Gjonaj. Domethënë aty është ndërhyrë, është prish, e tash është tu u prolonguar, nuk e di arsyen, e di pak a shumë arsyen, sepse

kur të keni ndonjë punë në qytet i tërhiqni këto kompanitë menjëherë në mënyrë urgjente, hajde se në qytet, se në fshat s'ka lidhje që nuk kryhet puna edhe mbetet me u krye më vonë, po nuk është në rregull. Domethënë nuk është në rregull se është pengesë për për qarkullim, për hyrje, dalje nëpër shtëpitë të njerëzve, kështu që do të duhej me me ndërmarrë diçka në këtë drejtim. Një pyetje tjetër e kam, problemin e parkingjeve në qytet. Vazhdimisht e kemi ngritur këtë problem, po e kam një pyetje konkrete. E kam një pyetje për parkingun, të cilin është marrë vendim këtu që me u bë një parking në një parking nëntokësor te ajo pompa aty karshi komunës, karshi administratës dhe nuk ka asnjë ndërmarrje rreth realizimit të këtij projekti. Atëherë pata kërkuar bile që i pata thënë kryetarit që nuk është zgjidhje, ky tha është zbutje. Po nuk po ndodh as zgjidhja as zbutja e problemit. Dhe krahas këtyre pyetjeve i kam edhe dy kërkesa. E kam një kërkesë për drejtorinë e arsimit, po natyrisht edhe për kryetarin, që të fillojnë procedurat për pavarësimin e shkollës fillore në Brez, në Gjonaj, sepse po konsiderojmë që i plotëson të gjitha kushtet, të gjitha kriteret, edhe numrin i nxënësve, edhe efikasiteti i procesit edukativo-arsimor do të jetë më i mirë. Kështu që është kërkesë edhe e Këshillit të Prindërve, edhe e arsimtarëve që të pavarësohet shkolla në Brez. Dhe një kërkesë e kam për, ndoshta e kapërceva, kohën por rrallë më ndodh me e kapërcy. E kam një kërkesë për drejtorinë e shëndetësisë. Një orë përpara të sigurohet një autoambulancë në qendrën e mjekësisë familjare në Gjonaj. Duke pasur parasysh se është një qendër e madhe e mjekësisë familjare. Është një numër i madh i nxënësve që gravitojnë. Unë nuk e di a ka ndonjë shkollë në rrethinë të Prizrenit që i ka 1000 nxënës, e shkolla në Gjonaj bashkë me shkollën e mesme i ka mbi 1000 nxënës. Dhe sigurisht që duhet siguri. Mandej ju e dini që tash Gjonaj është edhe qendër e kulturës, edhe qendër sportit, ndodhin ngjarje që do duhej me qenë autoambulanca për çdo eventualitet në qendrën e mjekësisë familjare. Jashtë këtyre organizimeve është edhe numri i madh i banorëve. Edhe është mesi i Hasit. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit, zotëri Hodaj. Fjalën e ka Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Përshëndetje për të gjithë. Para disa muajve, ka filluar realizimi i projektit të ujësjellësit ku investitor është kompania Dukagjini apo KRU Gjakova, tash edhe ajo i ka bërë dy-tre emra. Gjithashtu edhe Ministria për Ekonomi, çka është njëra prej tyre. Gjithashtu është edhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, ka participuar. Mirëpo realizimi i projektit ka ngec. Edhe pse është përfunduar diku rreth 90%, ka ngec. Tash në takime me ta, në konsulta me ta, se cila ja hedh fajn njëri-tjetrit. Kërkesa është kryetar që të kontaktoni KRU Gjakova, gjithashtu edhe Ministrinë e Infrastrukturës në këtë rast për shkak se si pasojë e mosmarrjes leje për gjurmimin në rrugë thonë që është ndalu projekti. Është një investim goxha i madh, banorët e asaj anë, konkretisht një pjesë e fshatit Piran, Medvecë dhe Zojz, e presin atë ujë sepse ka kohë që ka pasur këtë kërkesë dhe është shumë e nevojshme. Kërkoj nga ju që të merrni masa dhe ta dimë ku është problemi që punët janë ndaluar. Faktikisht që dy tre muaj punët nuk realizohen dhe thonë që kemi pengesa në marrjen e lejes për rregullim, domethënë çështja është e rrugës. Gjithashtu kërkoj edhe prej drejtorit të bujqësisë të na njoftoj a ka pasur biseda në lidhje me kërkesën që kemi bërë para një vite në lidhje me këto ndërtimin e stacioneve anti breshër. A është punuar në atë drejtim apo fare, sepse po e dimë është koha që më së tepërmi kjo dukuri shfaqet do të thotë si pasojë e breshit që dëmton edhe kulturat bujqësore. Edhe si çështje tretë për drejtorinë e shëndetësisë, është mirë drejtor që t'i rrini pak më gati punonjësve në ambulanta dhe në QKMF ta respektojnë orarin e punës. Unë e di që orari i punës është deri në ora 4:00, jo në ora 2:00, 3:00 me lëshu, me lëshu

punën edhe me hec. Ka shumë ankesa prej njerëzve të cilët kanë nevojë për kontrolle. Kaq kisha, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Krasniqi. Fjalën e ka Shqipe Shatri, përgatitet Erton Simiçiu.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesuese. Kërkesë DKA-së. E nderuara drejtoreshë e Arsimit, zonja Veselaj Gutaj. Po ju drejtohem lidhur me organizimet e trajnimeve për mësimdhënës dhe stafin tjetër arsimor, që është për t'u vlerësuar nga se zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga komponentat kryesore që ndikon në ngritjen e cilësisë së arsimit. Andaj e kisha kërkuar nga DKA që të planifikoj, pra, të ndaj mjete me kohë për kompensimin e udhëtimit dhe shujtave ditore për punëtorët pjesëmarrës nëpër trajnime. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zonja Shatri. Fjalën e ka Ertan Simiçiu. Përgatitet Mergjan Osmani.

Ertan Simitçi (YTHP): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje të gjithëve. Kam një pyetje unë drejtorit për bujqësinë. Drejtor, deratizimi dhe dezinfektimi, a ka filluar për vitin 2025 apo është në fazë? Se kemi edhe vërejtje edhe ankesa nga qytetarët. Pata dy kërkesa prej drejtorit të shërbimeve publike, po sidoqoftë besoj që adresohet. Është rruga, tregu i ri nga Ambëltorja Jupa deri te rrethi i Edi Durhamit. Është një rrugë me kubza, po është e dëmtuar shumë. Ka nevojë dhe kërkesa, nga qytetarët që të rregullohet ajo pjesë. Ndërsa është edhe një hapësirë publike në mbrapa ambulancës të në lagjen Lakuriq. Ka kërkesa nga qytetarët që të rregullohet ajo hapësirë, po përdoret si parking, por nuk i ka kushtet për parking e besoj që edhe është mundësia e mirë që të rregullohet ajo zonë. Unë disa herë kam ngritur çështjen e të varrezave të qytetit për arsye se nuk ka aty ujë, mbi ndoshta pesë-gjashtë muaj. Nuk e di, kryetar, a keni pasur ndonjë takim me kompanitë Ekoregjionit apo Hidroregjionit, a kanë bërë ndonjë zgjidhje, ndonjë send? Për arsye se qytetarët ende nuk po informohen mirë edhe po mendoj që është përgjegjësia e komunës. Po mendoj që është mirë që të dalim edhe me një njoftim publik që të njoftojmë mirë qytetarët, cila kompani e ka përgjegjësinë aty edhe çka është problemi? Jemi në fazën e Kurban Bajramit, besoj që është mirë tani të bëjmë një zgjidhje përkohësisht nëse ka mundësi, që qytetarët mos të dëmtohet edhe më shumë. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Simiçiu. Fjalën e kam me Erxhan Osmani. Lajmërohuni anëtarë të tjerë të cilët dëshirojnë me e marrë fjalën.

Merdzan Osmani (NDS): 14:20 – 16:25

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Osmani. Fjalën e ka Shukri Çuni. Përgatitet Karanfil Haxhillari.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje kolegë kuvendarë. Përhëndetje kryetar, përhëndetje media, përhëndetje të gjithë të pranishëm. Kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike, është fjala tek rrethi Hib petroll, që shkon rruga për Nashec, kam bërë kërkesë edhe më parë që aty të bëhet një rreth. Nuk është realizuar kjo kërkesë, ndërsa gjatë asaj rruge diku tani janë pesë rrathë mos gabofsha, edhe nuk kanë qenë në gjendje do të thotë me bë një rreth i cili është shumë i nevojshëm që shkon rruga për Nashec, por plus tash u bëj ndërtim i lartë aty, që ka

me pasur nevojë edhe më tepër me u zgjeruar edhe rruga, por jo veç rrethi, por dhe edhe rrugë të tjera me u ndërtuar. Po ashtu dhe trotuare. Kam bërë kërkesë për pastrimin e rrugëve në Nashec, rruga nëpër fshat, prej Prizrenit, pastaj rruga Nashec Tupec edhe rruga Nashec Kojush. Domethënë janë bërë të pakalueshme për shkak të shkurreve dhe llugave që janë zgjatur dhe kanë dalë në rrugë. Çështja ndriçimit u bë problematike tash nuk po e di edhe unë qysh do t'i vijë fundi kësaj. Sa herë kam ardhur në mbledhje e kam ngritur këtë çështje. Domethënë s'po shoh që ka me pasë ndonjëfarë zgjidhje për ndriçim. Drejtoria e Arsimit, a do të rregullohet kulmi në shkollën fillore Luigj Gurakuqi në Nashec? E kam fjalën për 2025. Drejtor i inspektoriateve. Si qëndron çështja lejeve të ndërtimit të cilat ndërtohen afër rrugës apo afër trotuarit? Nëse është pronë e personit privat, ai duhet me pas disa rregulla sa duhet me u largu prej pronës publike ose pronës të shtetit. E jo ai me bë, e me ndërtuar në rrugë, qoftë ndërtesë apo qoftë morë apo çka do qoftë me pas një një rregullore ai me ikë prej pronës së shtetit, nëse s'është prona e tij private edhe po thonë që s'kemi çka me i bë atyre. Drejtori i bujqësisë kam bërë kërkesë për hapjen e disa rrugëve fushore edhe malore për fshatin Kojush, fshatin Plane dhe Milaj. Mu desht me intervenu përmes kolegëve po prapë nuk pranove, tash përmes kryetarit duhet me intervenu që kryetari ndoshta pak më tepër ka me të dhënë zor në këtë drejtim. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Çuni, po fjalën e ka Karanfil Haxhillari, përgatitet Selman Sokolaj.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese, të dashur kolegë kuvendar, qytetarë të komunës së Prizrenit. Sot do t'i ngresh shqetësimin e banorëve të lagjes Bajram Curr. Kjo pyetje shkon për drejtorinë e shërbimeve publike, por meqënëse nuk është, besoj që do të kemi përgjigje me shkrim. Shqetësimi ka të bëjë me rrugën Liman Shala, e cila rrugë kalon nga rrethi te tregu i Fatonit dhe shkon nëpër shkollat fillore dhe të mesme deri në fund të rrugës. Aty kur nuk ka rrjedhe të ujit, nga plasaritja e gypave të ujit ose kanalizimeve, e cila është edhe rrezik potencial për epidemi dhe shëndet të mijëra nxënësve aty. Por kur nuk ka rrjedhe të ujit qarkullimi i kamionave me tonazh të lartë krijon një pluhur të hatashëm në atë pjesë të lagjes. Dhe me të vërtetë është një rrezik për komplet atë lagje për banorët. Dhe ky është problem gati një vit, që ndoshta nuk po e paraqes veç unë, por edhe më herët është paraqitur ky problem. Por pyetja shkon, a keni ndonjë plan më urgjent për sanimin e kësaj rruge? Meqënëse me të vërtetë është një arterie e cila kalon fëmijët tanë, nxënësit tanë dhe shumë qytetarë të asaj pjese. Pyetja e dytë dhe shqetësimi i dytë shkon për drejtorinë e inspektoriateve. Neve e dimë që me qindra ndërtime sot kemi pa leje, por në ditët e fundit e pamë edhe në media rrënimin e një objekti, pothuajse montazh tek rrethi i tranzitit të ri. Bëhet fjalë për Mobilerinë Mani, është një, pothuajse prodhim i mobiljeve. Meqënëse nuk keni ndonjë, politikë për ndihmesë të prodhuesve vendor, unë u habita kur e pashë dhe deklarinimin e avokatit të familjes, por edhe familjes, që bëhet rrënimi i objektit ku bëhet një prodhim të mobiljeve dhe aty ceket që pa një vendim është bërë një rrënim dhe pa asnjë paralajmërim, po ashtu ku edhe familja atë pronë e ka në kontekst gjyqësor, është në atë pronë. Tash pyetja është, kisha dashur prej drejtorit të inspektoriateve një sqarim se si është bërë ky rrënim dhe pse është bërë ky rrënim. Po edhe cili është plani, për më tutje çfarë do të bëhet në atë, në atë pronë. Tash edhe një pyetje për kryetarin e komunës. Pas aktakuzave të tetë zyrtarëve të komunës për kurdisje të tenderëve, në fushatë kryetar pate premtuar se në momentin kur do të ketë aktakuzë për ndonjë zyrtar të komunës, po ju citoj qysh pate thënë që s'do të ketë asnjë dilemë që do të marrë masa.

Tashmë është vala e dytë e aktakuzave, njëherë i patëm dy zyrtarë, tashmë i kemi edhe tetë të tjerë, dhe pyetja shkon, paska pasur shumë dilema dhe paska dilema për ndërmarrje të veprimeve nga ana e juaj. Dhe pyetja konkrete është, a do të jetë ky edhe një premtim i papërmbushur si shumë të tjerë gjatë fushatës, apo ndoshta mund, tash do të merrni masa? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit dhe zotëri Haxhillari. Fjalën e ka Selman Sokolaj. Përgatitet Agim Muçaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Kryesuese pasi kolegët tuaj partiakë kështu nuk po përgatiten me na dhënë përgjigje. Po zakonisht na tregojnë metafora, lexojnë dy tre metafora dhe vijnë në kuvend komunal. Unë veç po e ngris si çështje, ndërtimet e egra. Ndoshta moto e drejtorit inspeksioneve qenka, do të rënojnë ndërtimet e ulëta e do t'i lejoj paligjshëm ndërtimet e larta. Domethënë, jemi dëshmitarë që në komunën e Prizrenit, i kemi edhe të konfirmuar, po vazhdojnë ndërtimet e larta pa leje, të kundërligjshme. Kjo definitivisht është e palogjikshme që në këtë vit, në këtë kohë, pasi i kemi nxjerrë dy ligje për legalizim, ne si komunë, komuna e dytë në Kosovë, komuna që ka një status të veçantë, si qendër historike kulturore e këtij shteti, lejon kaq hapur që të ndodhin ndërtimet e larta. Kam pasur një rast konkret ku nga zyrtarët e drejtorisë së zotit Ukimeri, se më duket unë nuk e di çfarë zëri ka ky drejtori, se kurrë s'na u ka përgjigjur. Kisha me qenë shumë kurioz nëse përgjigjet e ja njohin edhe qytetarët zërin se veç ja kanë parë fytyrën kështu, po zërin nuk ja kanë dëgjuar. Mirëpo, kam të konfirmuar që në qytetin e Prizrenit edhe jo në vendet periferike që mbase mund ta quajmë do të ishte kështu vështirë e kontrollueshme, mirëpo brenda qytetit në lagje të urbanizuar po ndodh ndërtim pa leje. Kryesuese ai ndërtim pa leje nuk do të mund të kishte ndodhur nëse ndërtuesi kushdoqoftë nuk ka lidhje me inspektorët, me vendimmarrësit ose me personat e fuqishëm këtu. Unë e kam parë kryeprokurorin e prokurorisë themelore të Prizrenit që i ka dhënë prioritet dy gjërave, ruajtjen e urbanizmit edhe të ambientit, kështu që po i bëj thirrje edhe atij prej këtu që të merr masa edhe fjalët që i ka thënë ti shndërrojë vepra. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Sokolaj. Fjalën e ka Agim Muçaj, përgatitet Florent Ukaj.

Agim Muçaj (AAK): Përshëndetje kryesuese, kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, media qytetarë të nderuar. Unë edhe sot ngrej disa shqetësime për arsye nga rregullorja e vitit të kaluar pasi që është shkurtuar numri i kryetarit të bashkësive lokale, sigurisht se nganjëherë edhe ne po jemi të obliguar që shqetësimet e qytetarëve dhe komuniteteve nëpër lagje të ndryshme të qytetit dhe bashkësive lokale na drejtohen neve si kuvendar. Unë sot ngrej disa çështje, pasi që drejtori Qelë Lamaj edhe për herë të dytë sot nuk qenka këtu, mirëpo sigurisht se do ta përcjell me vëmendje edhe kërkesat e tona. Kërkesa ime është për fshatin Shpenadi, ku janë një lagje apo familja janë rreth 10-12 shtëpi të cilët kanë nevojë për kanalizim, ku perimetri është diku rreth 100m dhe njëjtë njëkohësisht për fshatin Shpenadi janë edhe dy ura të cilat mbledhin shumë mbeturina nga lumi nga që rrjedh nga fshati Korishë në drejtim të tyre, që ka nevojë urgjent për pastrim dhe mundësisht që në perimetër 10 deri në 15m që në të dy urat s'paku të murohet apo të betonohet, të gjendet një zgjidhje që sado kudo të jetë pak më i pasur lumi edhe vetë urat aty për banorët që mos të kundërmojnë mbeturinat. Kemi edhe në fshatin Shpenadi duhet ta potencoj pasi që me vetë iniciativën kanë investuar te vorrezat e fshatit, mirëpo ka nevojë edhe për edhe këtu

për një kanalizim i cili është në një perimetër rreth 70 deri në 100 m për kanalizim të ujërave të zeza. Për fshatin Malësi e Re, kërkesë e familjarëve dhe bashkësisë lokale në bashkëpunim me OVL në Prizren kanë bërë një kërkesë në qoftë se është e mundur që për martirët e fshatit, për pesë martirët e fshatit Malësi e Re, që të ndahet një buxhet, të cilët kanë potencuar që 3.500 deri në 4.000 euro, është një investim të cilët kërkojnë ndihmë nga komuna, në qoftë se është e mundur, të respektohen këta martirët e fshatit të Malësisë e Re. Dhe për fshatin Korish, rruga nga Mehmet Akif, e cila kemi bashkëbiseduar me drejtorin Çel Lamën në të kaluarën dhe ka qenë e premtuara për vitin e kaluar është një perimetër i shkurtër, disa qindra metra, 500-600 metra që të ngjitet dhe të bëhet asfaltimi i rrugës nga Mehmet Akifi deri në bashkangjitjen e me rrugën Grejkoc e cila kishte për të ta lehtësuar shumë qarkullimin e banorëve të fshatit Korish, Grejkoc dhe të gjithë asaj rrethinë. Mendoj se është një perimetër shumë i shkurtër dhe ka mundësi që të realizohet. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Muçaj. Fjalën e ka Florent Ukaj. Përgatitet Marin Përgjoka.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit e nderuar kryesuese. Unë i kam tri çështje me i ngrit në këtë seancë. Çështja e parë do me ja ngrit kryetarit se pasi që s'di sa herë ne këtu i kemi bërë pyetje drejtorit të shërbimeve publike, po a është i pafuqishëm të merr ndonjë veprim? Edhe personalisht kam qenë disa herë në zyrë për çështjen e ndriçimit publik, po veç afate dhe asnjëherë realizim nuk ka pasur. Kryetar, ku qëndron problemi i ndriçimit publik në komunën e Prizrenit? Sidomos nëpër fshatrat e Përdrinisë është gjendje kisha sugjeruar me ardhë njëherë në mbrëmje dhe me pa çfarë gjendje janë ndriçimi publik në fshatrat e Përdinisë. Pyetja e dytë ka të bëjë me çështjen e ndërprerjes së kanalizimit në fshatin Randobravë. A mundemi të dijmë arsyet pse është bërë ndalimi i punimeve në fshatin në çështjen e kanalizimit në fshatin Randobravë edhe çfarë është duke ndodhur me ndërtimin e prockës në këtë fshat. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Ukaj, fjalën e ka Marinë Përgjoka.

Marin Përgjoka (LDK): Përshëndetje kryesuese, përshëndetje kryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit. Pyetja është për drejtorin e Kulturës. Para disa ditëve është bërë publikimi i listës përfundimtare të shpërndarjes së subvencioneve. Pa dashur me gjyku a është vlerësim i drejtë apo jo, konsideroj që disa projekte të cilat kanë aplikuar e që përveç që zhvillohen në komunën e Prizrenit, janë edhe reprezentativ në gjithë rajonin, nuk janë shpallur fitues. Për herave të tjera, drejtor, ju kisha lutur që projektet të cilat janë reprezentative, siç është ekspozita Zogjët Thërrasin, kuratori i ekspozitës tu qen në prezantim në Shëngjin, i ka ardhur imeli që nuk është fitues. A ka qenë me ftesë të veçantë prej kryetarit të Shëngjinit në hapjen e sezonit. Do të thotë ne nuk po mundem me i përkrah njerëz të cilët po na përfaqësojnë në rajon. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Përgjoka. A ka anëtarë të tjerë të cilët dëshirojnë me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë po Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për të pranishmit, për kryetarin dhe gjithë të tjerët. Kryetar, dje apo pardje u njoftua nëpërmjet rrjeteve sociale dhe mediave lokale, se në lagjen 2 korriku janë ndarë 2 milionë euro për të rregulluar rrugët, ndërsa ato rrugë aty ashiqare vërehen që nuk ka ndonjë problem të theksuar, po nuk e di motivet pse bësh në atë rrugë aty.

Mundem me ja qëllu po mos të paragjykoj publikisht. Shumë afër atyre rrugëve që keni filluar punimet, është rruga Janina, është rruga Rust Kabashi, të cilët janë gati të pakalueshme nga shemja e kubzave. Pastaj kemi rrugën Dervish Saliu në afërsi të Hipit që shkon për Jetën e Re, është pothuajse e pakalueshme dhe asnjë investim për katër vite. Kemi në lagjen Ralinë dhe në Kurill shumë gropa që janë hapur, po asnjë ndërhyrje. Rruga Jakup Feri, Albrim Fanaj, në Ortakol, asnjë ndërhyrje, janë gati të pakalueshme. Ju kisha luajt që edhe nëpër këto rrugë t'i orientoni investimet komunale, që të jenë në shërbim të qytetarëve e jo për interesat e planeve të ndryshme. Në lidhje me subvencionet e Drejtorisë së Kulturës. Drejtor, personalisht kam ankesë, po edhe kam pranuar edhe ankesa nga OJQ-të dhe individë të tjerë, që procesi i vlerësimit ka qenë shumë jo korrekt, ka qenë ndëshkues ndaj personave dhe OJQ-ve të caktuar, që me gjasë i keni konsideruar mbas orientimeve të tyre politike. Po fillojnë nga ajo personalja, si organizator i 17 edicioneve të Panairit të librit, që sivjet e keni përgjysmuar. Nuk kuptoj këtë pse ka qenë. Ankesën e kemi dërguar. Ankesa është skandaloze. Unë ta dërgoj nëse s'e ke lexuar ti vetë. Arsyetimin që e ka dhënë komisioni i ankesave është skandaloze. Shkresa nuk përmban asnjë lloj arsytimi. Vetëm pjesa ku shkruan arsyetim është bërë përsëritja e vendimit. Do të thotë arsyetim është që është refuzuar. Kjo është arsyetim. Është është absolutisht pa kurrfarë logjike. Do të thotë së paku të kishin dhënë një arsyetim që Panairi është i panevojshëm për Prizren, nuk duhet me pas aq shumë, promovime për shembull, ju vetë keni qenë prezent çdo edicion, keni qenë i ftuar aty edhe keni parë se si organizohet. Nuk e kuptoj. Është shoqata e Bjeshkatarëve Axhi Beda, është pastaj Alban Berisha, nga klubi Prizreni, që ka 160 medalje, edhe është vlerësuar me çmim edhe nga Kuvendi Komunal, nga klubi i sportit të automjeteve, do të thotë një një sportist jashtëzakonisht shumë i suksesshëm, është refuzuar. Ka dhe të tjerë, por nuk dojnë publikisht, kanë frikë sepse po ndëshkohen nga komisioni vlerësues dhe nuk po merren parasysh nga komisioni për ankesa. Unë bëra një kërkesë për qasje. Pse nuk është publikuar lista e gjithë përfituesve edhe shuma sa kanë përfituar? Pse mbahet kjo sekret? Unë bëra kërkesë për qasje në dokumente, por nuk mora përgjigje, edhe pse ju atë listë më e keni të gatshëm me një email më të thjeshtë, kishit mund shumë lehtë me dërgu që ta kemi edhe unë të shoh se kush sa ka përfituar. Ka festival që janë iniciuar nga kryetari, dy festivale, natyrisht të vlefshme, të nevojshme për qytetin. Është hera e tretë që organizohen, po marrin shuma marramendëse. A është vetëm pse kryetari ka iniciuar ato? Apo janë shumë më të vlefshme sesa një panair i librit apo një një projekt tjetër? Për drejtorin Edin Shehu. Drejtor, ju lutem vizitoni zyrën e gjendjes civile në Tusuz. Është në gjendje të mjerueshme. Ka nevojë për intervenim urgjent dhe emergjent. Zyrat e gjendjes civile tregojnë do të thotë përfaqësojnë Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe është pasqyrë pasqyra e kujdesit tonë. Do të thotë janë në gjendje të mjerueshme. Ju lutem të keni kujdes që ta vizitoni. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, zotri Gashi. Fjalën e ka Levent Bush.

Levent Bus (KDTP): 35:50 – 39:50

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Bush. Fjalën e ka Shkëlzen Kastrati. Përgatiten Bajram Kastrati.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Faleminderit shumë kryesuese. Përsëritet për të gjithë këtu në sallë. Në rend të parë dua ta falenderoj edhe ta përsëritës kryetarin, të gjithë stafin e tij ekzekutiv, për punët që po bëhen në Prizren vazhdimisht, për angazhimin e tyre për t'ju shërbyer sa më shumë

qytetarëve. Në fakt nuk deshta me marrë fjalën, po ja që u detyrova, mbase që u përmend lagja 2 korriku, në atë lagje jam i lindur dhe i rritur dhe e di saktësisht çka ka nevojë dhe sa ka qenë e nevojshme intervenimi në atë lagje. Minimum nja 20 apo 30 herë në ditë kaloj aty dhe nuk ka rrugë më të dëmtuara sesa rruga Janina në nivel të Kosovës mendoj. Rrugët të cilën i përmendi kolegu janë rrugë të cilët janë shtruar para luftës dhe asnjë intervenim që 26 vjet nuk ka nuk ka pasur në atë rrugë. Mëse e nevojshme ka qenë intervenimi dhe rregullimi. Po njerëzit të cilët nuk jetojnë vazhdimisht keq informohen nga të tjerët edhe mendojnë që duhet ashtu. Ë, ditëve të fundit dëgjova kështu, tash mundet mos me qenë edhe e saktë, por njerëzit zakonisht kur dojnë me ble prona, shtëpia, po kanë qejf me i lënë ato lagje të pazhvillura vetëm sa t'i arrijnë qëllimet e veta personale. Dhe nuk i interesojnë qëllimet, të të gjithë qytetarëve për me marrë shërbime sa më të mira. Nëse është qëllimi individual, i një person del tash, i dezinformon të tjerët, mendoj që nuk është fer edhe e drejtë, mirëpo duhet të falenderohen të gjithë aktorët, të gjithë njerëzve që kanë kontribuar për me ardhur deri në këtë ditë me filluar punimet, mëse të nevojshme, po normalisht që ka nevojë për intervenim edhe punë të tjera, mirëpo më e mirë sepse asamblenë po e përdorim vazhdimisht me kërkesa për të punuar, por ka kategori të njerëzve që thonë mos punoni. Është është e pa kuptim kjo, kështu që edhe njëherë faleminderit për të gjithë ata që kanë kontribuar, për t'i rregulluar këto punë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Kastrati. Fjalën e ka Bajram Kastrati. Përgatitet Dafina Alishani.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, qytetarë të Prizrenit. Meqë drejtori i shërbimeve publike nuk është prezent, megjithatë po parashtoj dy kërkesa, një që është e ripërsëritshme, qasja e rrugës te tranziti poshtë, pas një takimit me zyrtar policer, kryetar, ata janë, kanë idenë që te tranziti përderisa duhet të kalohet tri korsi për kyqje, duhen me patjetër me qenë semaforët. Meqë, nuk ekziston mundësia një rrethrotullimit. Gjithashtu e kam edhe një kërkesë, kërkesë të përditshme nga lagjja Jeta e Re, infrastruktura e lagjes Jeta e Re. Kur ka me u zhvilluar ky projekt edhe kemi rrugë plotë që janë ende në baltë aty. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Kastrati. Fjalën e ka Dafina Alishani. Përgatitet Petrit Hoxhaj.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. I nderuari kryetar, e mirëpres emërimin e një drejtoreshe në ekzekutiv. Edhe po ju përkujtoj që ende jeni larg premtimit tuaj që ekzekutivi juaj do ta respektojë barazinë gjinore. Mirë është që keni shtuar një grua, por nuk mjafton, sepse keni premtuar për 50-50. Drejtoreshë, po më vjen mire që po ju shoh edhe po e shoh një grua këtu, uroj që nuk do të jeni vetëm numër, por do t'i shtoni vlerë këtij ekzekutivi. Edhe uroj që ju kanë treguar që keni një drejtori më sensitive të qytetit, keni punë për shërbime sociale, për mirëqenie. Uroj që do të keni sukses sepse njëmend është një kategori sensitive e këtij qyteti. Neve na keni këtu, nëse doni me bashkëpunu, këtu jemi. Nëse doni me qenë si këta kolegë të tjerë që as nuk përgjigjen, as nuk bashkëpunojnë, atëherë ju e dini atë punë. Drejtor, dezinfektimi dhe deratizimi kur do të bëhet, për shkak që ka filluar edhe para se me u nxehtë shumë koha, mirë është me i parapri këtij problemi, sepse çdo vit kemi pas probleme, së paku në vitin e fundit i paraprim. Kërkesë për drejtorinë e shërbimeve publike, edhe pse s'është këtu, po ja përcjellni zotëri Çel Lamaj, qytetarët

janë lodhur më me kualitetin e dobët të punimeve të kësaj qeverisje. Unë ju kisha lut që kur i filloni punimet ose investimet kapitale t'i tregoni e sa ta herë është. Domethënë sot drejtorja e shërbimeve publike e shtron asfaltin për herë të pestë ose për herë të katërt. Lagjja Tabakane është lodhur më prej juve. Dini tregoni edhe sa herë do ta investoni ose edhe sa herë do ta shtroni atë asfalt sepse sinjerisht janë lodhur qytetarët me këto punime të dobëta. Sa i përket subvencioneve të drejtorisë së kulturës rinisë dhe sportit, sikurse çdo vit unë mendoj që ky vit ka qenë kapak i kësaj qeverisje, ku e tregon qartë politikbërjen e PDK-së, karshi këtij qyteti. Edhe ky vit i ka anashkaluar dhe diskriminuar OJQ-të, që kanë kontribuar me vite të tëra në jetën kulturore edhe sportit të këtij qyteti dhe tash vjen një qeverisje ku organizon festival për qejf të kryetarit. Hajde, ju kuptuam që po bëni festival për qejf të kryetarit, ama me subvencionu më së shumti këtë festival, duke pasur festivalet që organizohen me vite të tëna, sinjerisht është më fyerje për qytetarin e Prizrenit. Unë e di tash drejtori del thotë, "Unë nuk kam çka të bëj se janë komisionet", krykëput përgjegjës je ti drejtor. Komisionet nuk kanë çka, se komisionet ju i zgjidhni. Po është për të ardhur keq edhe shumë po e mirëpres kolegun tonë që nuk po i pranon këto subvencione. Unë mendoj që të gjitha klubet, të gjitha OJQ-të do të duhej më t'ju japin juve përgjigje, merrni ato subvencione. Besoj që je gëzuar që s'ka me i marrë Leventi. Se menjëherë ke me i kanalizuar dika tjetër me një OJQ që ke bashkëpunime të duhura dhe të mira. Mua po më vjen shumë keq që Prizreni e ka një drejtor të tillë, që ka keqpërdorur me vite edhe vazhdon me keqpërdorë, po çka është më e keqja që edhe kryetari është pjesë e këtij keqpërdorimi edhe është domethënë hesht në këtë diskriminim që po i bëhet edhe klubeve, edhe OJQ-ve. Edhe së fundi, kryetar, a e dini sa tender janë dhënë për ndriçim publik gjatë qeverisjes tuaj? Edhe a kërkon llogari pse hala ne kemi problem me ndriçim publik? Si dhe së fundi, domethënë nuk ka mjaftuar me pas tender për ndriçim publik, tash edhe për mirëmbajtje të këtyre ndriçimeve publike, por ne hala jemi në terr. Ju lutem, a mundeni me na tregu ju si kryetar, a keni informatë për këtë? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Alishani. Fjalën e ka Petrit Hoxha, i përgatitet Sevil Kazaz.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtor, koleg, kuvendar, drejtoreshës së mirëqenies sociale, ju urojmë mirëseardhjen dhe punë të mbarë në këtë dikaster. Mbasi nuk është drejtori i shërbimeve publike, atëherë po ju drejtohem kryetarit. Kryetar, është mirë që sheshi i Shatërvanit e di që është duke u punuar do të thotë në këtë shesh, mirëpo është mirë që edhe të mirëmbahet. E di që ec për çdo ditë në atë pjesë dhe shih se është shumë, do thotë, edhe kubëzat e kanë marrë ngjyrën formë tjetër. Nuk janë ata të cilët kanë qenë në fillim. Është mirë të mirëmbahet dhe unë si ide ju kishte propozuar që së paku dy-tre punëtorë të kompanisë të jenë, do thotë, prezent në këtë shesh dhe komuna ka objekte dhe pronë në atë pjesë dhe t'ju jepet ekoregjoni që t'ia shfrytëzojnë për ato punëtorë të cilët janë në sheshin e Shatërvanit dhe jo mos të rrinë në kafe, në kafe. Mirë ish kanë që të mirëmbahet sepse me dalë e sheh që gjithmonë ke duqe të cigareve, ke letra, ke dhe gjëra të tjera. Përpos këtyre, sheshi i Shatërvanit ka filluar të bëhet edhe një lloj cirku sepse çdo qoshe ki individë të cilët përfitojnë nga, nga forma të ndryshme, është mirë edhe inspektoriat i të merret masa me këtë drejtim dhe t'ia kthejmë dinitetin Shatërvanit që ka qenë dikur. Ndërsa, pyetja tjetër ka të bëjë me shitësit ambulantë në Bazhdarhane, drejtor, do të thotë ka shumë shitës ambulantiv të cilët tash kanë filluar edhe rrugët po i bllokojnë. Ndërsa, me sa kam informata, para do muajve do thotë, a është rrënuar vetë një

objekt apo jo, mbi Qylhan, është mirë që, pasi që është pronë publike, pronë e komunës, është mirë që së paku nja pesë-gjashtë shitës ambulantiv të sistemohen në atë parcelë dhe të lirohet rruga nga këto. Ndërsa pyetja tjetër ka të bëjë, mbasi jam i fundit, me drejtorin e bujqësisë, drejtor çka është duke ndodhur me projektin shtrimin e rrugëve fushore, që sivjet nuk ka filluar ende, kërkesat janë të vazhdueshme dhe është mirë që të fillojmë sa më parë. E di që buxhet s'ka, mirëpo bëni edhe ti qysh po ja bëjnë këta drejtorët të tjerë, gjeje buxhetin dhe fillo që të shtrohen rrugët fushore dhe kërkesat e këtyre. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hoxha. Po tregoj që nuk je as i fundit as i parafundit po ka dhe të tjerë. Zonja, zonja Sevil Kazaz fjalën e ka. Pastaj përgatitet Naxhije Memaj.

Sevil Kazaz (Ythp): 50:05 – 53:25

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Kazaz. Fjalën e ka Naxhije Memaj. Përgatitet Sehad Arifi.

Naxhije Memaj (LDK): Përshëndetje kryetar, kryesuese, ekzekutiv, kolegë kuvendar, ju media dhe ju qytetarë të nderuar. Jemi në fund të mandatit edhe çështja e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Lutogllav mbetet i pazgjidhur. Kjo kërkesë e imja e vazhdueshme ka hasur në vesh të shurdhër si nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ashtu edhe nga ana e Hidroregjionit. Pastaj kam një kërkesë tjetër prej banorëve të fshatit, rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Lutogllav. Edhe një pyetje për drejtoreshën e arsimit. Drejtoreshë, deri ku kanë mbërritur punimet në shkollën Besim Ndrecaj?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Naxhije Memaj. Fjalën e ka Sead Arifi. Përgatitet Alban Bislimaj.

Sead Arifi (Vakat): 54:20 -55:10

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Arifi. Fjalën e ka Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, media, kolegë, kuvendar, qytetar. Unë duhet të ndërlihem me disa gjëra që u folën nga kolegët e opozitës. Kinse nuk po punohet, kinse çdo punë është keq në qytet, por unë e desha me përgëzu kryetarin për punë të mira që janë duke bërë, por kisha njëkohësisht edhe një kërkesë në lidhje me punët që janë duke bë. Ne po e shohim që sinjalizimet rrugore tani më janë duke vendosur çdo pjesë të qytetit. Tashmë janë duke dalë edhe nëpër rreth, domethënë të qytetit, nëpër fshatra. Dhe kisha kërkuar prej kryetarit që sinjalizimet të rriten buxheti sa i përket punimeve të sinjalizimit që mos të mbetet asnjë rrugë pa sinjalizim, sepse e dimë që janë shumë të rëndësishme, e kemi diskutuar edhe më herët në kuvend këtu se sa është e rëndësishme edhe nga pamja e bukurisë qytetit sinjalizimit, por edhe nga siguria rrugore. U fol për Shatërvanin, ne duhet ta përgëzojmë për punët e mira që janë bërë në Shatërvan dhe jo të themi që Shatërvani është keq, është duke përly sepse aty ka vizitorë jashtëzakonisht shumë në Shatërvan edhe normalisht kur rritet numri i vizitorëve bëhet edhe barlog edhe se smund i rrin menjëherë të hiqen bërlllogut ose papastërtia. Po megjithatë kemi arritur me punë të mira që të rritet numri i vizitorëve në qytet dhe kështu që po shohim që numri është i madh i vizitorëve. Sa i përket ndriçimit publik, ne e dimë qysh ka qenë gjendja më herët dhe çfarë gjendje jem. Normal që ka dhe rrugë që s'është bërë ndriçimi, por këto punë nuk kanë përfunduar, por sa i

përket ndriçimit, unë po shoh që çdo çdo lagje ka ndriçim, çdo fshat ka ndriçim. Por a ka mundësi me u bë më shumë, normalisht që nuk do të ndalet kryetari dhe nuk do të ndalet qeverisja e Shaqir Totës. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Bislimaj, fjalën e ka Islam Thaçi.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për ju, kryetarin, koleg kuvendar, ekzekutivin. Meqënëse para disa ditë ose ka filluar veç java Remzi Ademaj, këtu në këtë sallë të kuvendit edhe nga unë, por dhe nga disa kolegë kuvendar është ngrit çështja e mirëmbajtjes së busteve dhe lapidareve që janë shumë në komunën e Prishtenit. E di që për një pjesë bukur të madhe të tyre është përgjegjës Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve. Mirëpo prekëse është që monumentet e dëshmorëve në këtë rast, unë e pashe që ekzekutivi në shenjë respekti ka vendosë kurora lulesh pranë lapitarit të komandant Petritit Remzi Ademaj. Mirëpo njëkohësisht, s'di si ta quaj, është keq ta shohësh se 100 e kusur dëshmorëve, gjysmës prej tyre i mungojnë shkronjat. Kërkoj nga ekzekutivi, që të paktën të bëjë përpjekje presion në trusni, nëqoftëse të gjej mënyra për, mirëmbajtjen e këtyre lapidareve. Në veçanti në zonën e parë apo në qendrën historike, ku kemi një numër të konsiderueshëm të këtyre dëshmorëve që janë brenda zonës së parë historike. Çështja e dytë është, kërkoj informacion, meqënëse Kuvendi Komunal këtu ka votuar ndarjen e mjeteve për hapjen e rrugës që do të lidh nga ura në Tusuz, me lagjen Bajram Curr. Mua më intereson ku është procesi dhe deri ku kemi mbërritur me këto procedura të shpronësimit të disa parcelave aty që më se nevojiten për t'u hap ajo rruga dhe për t'u lidh lagja Bajram Curr me lagjen e Tusuzit. Kaq kisha. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Thaçi. A ka anëtarë të tjerë të cilët dëshirojnë me e marrë fjalën? Shukrie Berisha dhe Kujtesa pastaj.

Shukrije Berisha (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje kryetar. Kolegë kuvendar, ekzekutiv, media dhe të gjithë ju të pranishëm. Meqënëse drejtori i shërbimeve publike nuk është këtu, besoj që është duke na përcjellur dhe mund t'i kthej përgjigjet me email në mënyrë elektronike, sidoqoftë. Kërkesa për drejtorinë e shërbimeve publike është lidhur me vendosjen e vijave të bardha për këmbësor, para hyrjeve të shkollës fillore Mustafa Bakiu dhe gjimnazit Gjon Buzuku që t'ju mundësohet pra nxënësve të këtyre shkollave një siguri gjatë lëvizjes së tyre për hyrjen e shkollave dhe daljen jashtë shkollës. Po ashtu kërkesë tjetër është për drejtorinë e shërbimeve publike që të na jepet një sqarim dhe arsyetim lidhur me dënimet për parking të veturave që jepen të gjithë banorëve të lagjes dhe kjo ndodh shpesh. Është fjala për lagjen vëllezërit Dehiri nga policia dhe pa asnjë arsyetim, nuk japin arsyetim policia. Ku secili banor i lagjes e ka të parkuar veturën para derës së shtëpisë, gjë që askujt nuk i pengon. Po ashtu kjo rrugë është rrugë tretësore. Nuk është rrugë kryesore, dytësore, tretësore, gjë që askujt nuk i pengon. Nga policia thuhet se kanë marrë ankesë, kishte nga një banor i lagjes, mirëpo nuk e tregojnë se cili është ai. Ka mundësi, kur ne e diskutojmë në lagje, asnjëri nuk ka bërë ankesë. Ka mundësi që mos të ketë ankesa nga banorët e lagjes dhe thirrjet mund të bëhen nga një qytetar i pandërgjegjshëm. Andaj është mirë që të na tregojnë se kush është personi që ankohet dhe pastaj të verifikohet se me të vërtetë është banor i kësaj lagje. Dhe nëse është banor i kësaj lagje, atëherë ne mund ta bëjmë zgjidhjen vetë si banor, por nëse nuk është atëherë nuk është e drejtë të vihen këtë dielë rreth orës 11:00 vjen policia dhe gjithë banorëve ju vendosin ditë vikendi normal që të gjithë janë në shtëpi

dhe i vendosin të gjitha dënimet në çdo veturë që kanë gjetur, para hyrjes së shtëpisë së tyre. Unë e shkova dhe e bisedova ata thanë keni ankesat asnjani asnjë as sqarim nuk e dha atëherë është mirë banorët më thanë që ta adresoj këtë problem këtu në kuvend. Atëhere ose nga kryetari ose nga drejtori i shërbimeve publike pres përgjigje. Faleminderit shumë.

Kujtesa Kabashi- Shatri (LDK): Faleminderit kryesuese. Përsëritet për të gjithë juve të pranishmëve. Më së pari dua ta falenderoj kryetarin për projektin që është duke u realizuar në fshatin Gjonaj tek Procka. Drejtori po na mungojka, kështu që shumë falenderit. Uroj që dhe shpresoj që punimet të përfundojnë ashtu qysh kanë filluar. Dashta me u ndalë edhe tek lagja Jeta e Re. Faleminderit shumë edhe drejtoreshës së arsimit. Salla e edukatës fizike ka përfunduar brenda dhe jashtë është duke punuar për një sallë tjetër, në ambient të jashtëm. Ndërsa tek lagja Jeta e Re, kryetarit i kisha bërë lutje, deri tani nuk kanë filluar asnjë punim në këtë lagje, as në rrugë, as në ndriçim. Kështu që planifikimi i buxhetit kur do të bëhet, e kemi për, domethënë muajt e ardhshëm. Shpresoj që kodët buxhetore dhe që do të ndahen për këtë lagje, të rregullohen rrugë në lagjen Jeta e Re. Do të thotë infrastruktura është shumë e dëmtuar. Ndërsa tek lagjia Arbana, mbrapa Kastratit, një dy rrugë e kam ngritur shumë shpesh, do të thotë, rruga e Arianitasit dhe rruga Raif Elezi. Këta banorë kanë problem edhe me ujërat e zeza, do të thotë, kanalizimin, është një pjesë shumë e shkurtë, edhe që s'di sa vite nuk kanë ujë të pijes fare. Kështu që shpresoj që edhe këta të merren parasysh. Shumë faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Shatri. Atëherë ju nderoj, ju falenderoj të gjithëve të nderuar koleg kuvendor përkontributin në këtë pikë, po kalojmë te pjesa e ekzekutivit. Fillimisht fjalën do ta ketë kryetari i komunës. Kryetar, fjala për ju.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Të falenderoj, zonja kryesuese. Së pari po do me i përsëritet asambleistët edhe me i falenderu për kontributin që po japin edhe për çështjet që po i ngrisin. Kryesisht janë gjëra të njoftura me të cilat ballafaqohem që një kohë të gjatë, mirëpo megjithatë secila prej tyre e ka rëndësinë e vet. Disa çështje parimore po dua me i përmend. Patë shumë kërkesa për investime në infrastrukturë, për rrugë, për kanalizim, për ndriçim, për ato, për këto. E vërteta është që tërësia e nevojave të komunitetit, territorit të komunës së Prizrenit është më e madhe sesa buxheti i komunës së Prizrenit. Çdo kërkesë është legjitime edhe çdo kërkesë është rezultat i nevojës. Edhe si e tillë, duhet të plotësohet edhe do të plotësohet. Pse nuk plotësohen më tepër kërkesa? Përgjigja është shumë e thjeshtë, sepse s'kemi buxhet më tepër. Ne e dimë sa e kemi buxhetin edhe e dimë që q'atë buxhet e kemi krijuar edhe e kemi votuar bashkë edhe kemi caktuar prioritetet, që nuk janë ideale, por janë racionale. Edhe e dimë që sikur të kishim pasur më tepër buxhet, kishim plotësuar më tepër nevojat. Për këtë arsye, po ju lus për mirëkuptim, për shkak se punët janë në vijim. Edhe ato që s'mundim me kry këtë mandat, vazhdojmë mandatin tjetër, vazhdojmë vitin tjetër. Në qoftë se jemi ne, vazhdojmë ne, në qoftë se është dikush tjetër, vazhdon dikush tjetër, por gjithsesi punët do të vazhdojnë e nuk do të ndalen. Por edhe njëherë po e përsëris, buxheti është ai që është. Nuk ka mjete financiare, s'ka pare më tepër. Sikur të kishte pasur më tepër pare, mjetet financiare kishin kryer punë më tepër. U përmendën disa gjëra kështu në mënyrë jo parimore, disa shembull, kryetari pjesë e keqpërdorimit. Unë e konsideroj se secili prej neve në mënyrën se si flet për një person tjetër, më tepër tregon për veti, sesa për atë tjetërin. Prandaj, ju kisha qenë mirënjohës në qoftë se kur të adresoni çështjet, keni mundësi me argumentuar.

Përndryshe, ngritja e një çështjeje edhe një akuze pa argumente, më shumë e dëmtoni reputacionin e juve, secili prej juve, edhe unë, se sa që e akuzon dikë në tjetër edhe arrin ndonjëfarë efekti. Mbasi na kualifikimet e jo të vërteta, si përshëmbull thotë Shadervanit me ja kthy namin si dikur, konsideroj që është një keqpërdorim i mundësisë që ju ka dhënë dikujt këtu në këtë asamble, sepse të paktën tash Shadervani ka vlerësime shumë dimensionale se në Shadervan është bërë një punë e mirë. I kemi disa çështje që janë ngritur këtu po përgjigje për shumicën e çështjeve të tyre është te kjo qasja në mënyrë parimore. Punët në Gjonaj po vazhdojnë. Normal që kurrgjë nuk është perfekte, mirëpo me gjithë atë po punohet. Parkingu te pompa e vogël presim përgjegje prej AKP-së, sepse duhet me e shpronësu atë pompën e vogël. Nuk kemi përgjegje hala prej AKP-së. Për varrezat e kemi pasur një takim ku kanë marrë pjesë shumë akterë dhe kemi diskutu edhe kemi harmonizuar rregulloren e re, për kalim te lokacioni i ri te varreza të tjera, edhe kemi diskutuar qysh derisa jemi akoma duke u shfrytëzuar lokacionin te varrezat e vjetra me bë sa më funksionale edhe sa më të shfrytëzueshme, mirëpo jo çdo gjë varet prej neve. Sepse hidroregjioni jugor nuk është kompani ku ne kemi kompetenca ekzekutive për me mujt me i ushtru ato kompetenca në mënyrë që ata me kry punën e vet në mënyrën se qysh duhet. U përmend çështja e drejtorit edhe aktakuzës së tij. Unë e kam parë prej mediave edhe unë si kryetar i komunës nuk e kam asnjë informacion me shkrim. Por po ashtu as Edini nuk e ka asnjë dokument me shkrim që ka ardhur ose prej prokurorisë ose prej gjykatës. Të jeni të bindur që në momentin kur e pranojmë një dokument të tillë do të pasojnë veprimet tona konform standardeve të qeverisjes lokale edhe të lidërshiptit të cilat deri më tani i kemi implementuar. Ndërtime pa leje, në qoftë se dikush ka argumente që ka ndërtime pa leje, urdhëroni bjeni argumentet. Unë nuk e di, nuk kam argumente që diku ndërtohet pa leje, nuk e besoj që ka as Islami, kushdo që të ketë, ju lutem bjeni dëshmitë, argumentet këtu ose të paktën dyshimet. Edhe ne dalim në terren edhe i verifikojmë. Një pyetje mu duket interesante, nuk e di kush e paraqit, tha, pse po punohet në rrugën 2 korriku? Me ju thënë të drejtën, me më pas thënë pse s'po punohet, kishte menduar qysh me u përgjigjur. Po kur më pyet dikush pse po punohet, s'kam përgjigje, nuk di, nuk di qysh me argumentuar pse po punohet. E përmendi, dikush e përmendi mungesën e transparencës. Po jua përkujtoj që komuna e Prizrenit është në katër komunat më transparente në Kosovë edhe është komuna më e madhe e cila është e shpallur zyrtarisht si komuna më transparente, kurse poashtu te subvencionet pat ankesa që nuk është përkrah një organizatë apo një organizatë tjetër. Në qoftë se ka dikush një dëshmi që një organizatë që është përkrah, nuk e meriton përkrahjen, e marrim shumë seriozisht. Në qoftë se kemi ankesa, pse s'kemi mjete më tepër me përkrah, më shumë organizata, nuk kemi përgjigje. Të kishim pasur më shumë buxhet, kishim përfshirë më shumë organizata. E çështja shpërndamjes atyre subvencioneve që kemi në dispozicion, është më tepër punë e komisioneve të cilët e bëjnë ato. Edhe po jua përkujtoj që këtu s'ka festivale private. U përmend një rrethrotullimi të Hibi, Nashicit. Aty e kemi bërë një zgjidhje para një kohe, mirëpo ne ndërkohë, në qoftë se tregohet e nevojshme, për shkak se situata urbanistike ndryshon, edhe në qoftë se tregohet e nevojshme, edhe ekspertat, edhe banorët e lagjes apo banorët e qytetit e vlerësojnë si të tillë, me siguri do të intervenojmë në mënyrë që me mund me e lehtësu lëvizjen e makinave. Po jua përkujtoj që kemi bërë disa zgjidhje nëpër qytet me këto rreth rotullimet, të cilat shumica e njerëzve i pëlqejnë, por ka dhe të tillë që i kritikojnë, por rezultati i arritur është zvogëlimi i numrit të makinave nëpër vende të caktuara, gjithmonë duke u bazuar në planin e mobilitetit, studimin e që e kemi bërë edhe zgjidhjet e propozuara që na i kanë dhënë ekspertat. Për të rruga Tusuz Bajram Curr është në vijim

procedura shpronësimit, po kanë dalë pengesa të natyrës pronësore juridike. Edhe për këtë arsye po vonohet ka pak procedura. Kurse, për dënimet në trafik, komuna nuk është kompetence. Po jua përkujtoj që edhe te shtëpia ime ka ndodhur e kemi lënë kerrin përjashtë, edhe kur kemi dalë e kemi parë dënimin në gjamë. E kemi paguar dënimin edhe prej policisë nuk mund me lyp llogari pse po zbatojnë ligjin për ndëshkim të makinave që pakohen në vende të palejueshme. Kjo është një qasje kështu parimore, por patë edhe përgjigje të cilat do t'i merrni nga drejtorët, përndryshe Çela s'ka mund me ardhë se ka pak probleme shëndetësore. E tash po ja jap, juve po ju falenderoj për vëmendjen, kurse po ja jap fjalën drejtorave, të cilët me siguri kanë me pasur përgjigje.

Luljeta Veselaj Gutaj (DKA): Faleminderit për pyetjet e juaja dhe interesimin rreth institucioneve shkollore. Po filloj prej shkollës Besim Ndrecaj në Malësi të Re, punimet po vazhdojnë e nderuar zonja Memaj. Nëse keni dëshirë kur do me u ndalemi dhe bashkarisht i shikojmë edhe shpresojmë shumë që deri në shtator do të përfundojmë dhe do të vazhdojmë në objektin e ri të renovuar. Sa i përket lirimit të hapësirave të oborreve të shkollave, si çdo vit edhe këtë vit do të ndodhë lirimi i hapësirave të oborreve për mërgimtarët, të cilët i shfrytëzojnë. A duhet të rritet numri i shkollave? Të gjitha shkollat janë në shërbim të gjithë qytetarëve, kështu që nuk është ndonjë problem. Sa i përket rregullimit të kulmit në Nashec, veç e kemi diskutuar në drejtorinë arsimit jemi tu i pa mundësitë, mirëpo ka probleme edhe për hapjen e thirrjes publike, e cila nuk është e planifikuar për këtë vitë në zyrën e prokurimit edhe me buxhet. Megjithatë, në vazhdimësi kemi diskutuar dhe po shohimi se çfarë mundësi do të kemi për me vazhduar më tutje. Përndryshe, për vitin 2026 në shkollën e Nashecit kemi paraparë rregullimin e kulmit, lyrje të brendshme, të jashtme edhe rregullimin e oborrit dhe hapësiravetë jashtme, po dhe nevojat të cilat janë brenda. Sa i përket trajnimeve të mësimdhënësve dhe zhvillimit profesional, Shqipe e dini që është edhe objektiv strategjik e drejtorisë së arsimit në planin zhvillimor të arsimit në komunën e Prizrenit dhe ne kemi mbajtur vazhdimësi trajnimet dhe do të mbajmë, por e kemi parasysh edhe pjesën të cilën e potencuat ju sa i përket se si mund i mbulojmë edhe çështjen e ushqimit edhe çështjen e kompenzimit të udhëtimit. Dhe kërkesa për pavarësimin e shkollës në Gjonaj, zoti Hodaj, veçse ne jemi në proces të diskutimit me kryetarin e komunës për pavarësim po edhe për mundësi të tjera të cilat do të ndodhin. Ka shumë punë të mira dhe gjëra të mira të cilat do të vijnë ditët në vijim në sektorin e arsimit. Ju falenderoj për vëmendjen.

Adem Morina (DKRS): Faleminderit kryesuese. Të nderuar të pranishëm, unë do të mundohem që të jam i shkurtër në dhënien e përgjigjeve në pyetje të parashtruara nga kuvendarët, duke filluar nga zoti Mergjan Osmani, në lidhje me klubin e Shahut nga Zhupa, pse nuk është përkrah nga Drejtoria e Kulturës dhe Sportit. I nderuar zoti Mergjan, me thënë të drejtën, nuk jam me ndonjë informacion se çfarë ka ndodhur me klubin e Shahut, mirëpo besoj që ju japin përgjigje në drejtori, nëse kërkon realisht përgjigje pse nuk është përkrah klubi i Shahut. Sa i përket pyetjes e parashtruar nga zoti Muça në lidhje me një memorial të martirëve në këtë rast në fshatin Malësi e Re, dikush e potencoi që e kemi shoqatën e memorialeve të Kosovës e cila ka një buxhet specifikisht për ndërtimin dhe mirmbajtjen e memorialeve dhe po ashtu e kemi dhe ne si drejtori, mirëpo duke pasur parasysh buxhetin e limituar që e ka drejtoria e kulturës në këtë drejtim, është e pamundur që t'i përmbush të gjitha kërkesat që vijnë nga secili fshat, lagje dhe qytet për memorialet, ngaqë me të vërtetë është një pjesë e ndjeshme që ndihem poashtu keq sepse ka ka shumë nevojë për ndërhyrje të tilla, por po urojmë që në bashkëpunim edhe me organizatat e dalura

nga lufta, jemi në kontakt dhe do të bëjmë ndërhyrje në to. Pyetjen e shkruar nga Marini, Marin Përgjokaj, në lidhje me mosmbështetjen e një organizate me subvencione, zогjtë thërrasin. Unë e di që ajo organizatë me të vërtetë bën një punë jashtëzakonisht të mirë dhe kam qenë në ekspozita të fotografive të asaj organizate, mirëpo pse nuk është përkrahur, nuk kam ndonjë informacion. Për këtë çështje duhet t'ju drejtohem komisionit dhe po besoj që do të marrin përgjigje pse nuk është përkrah. Ilir Gashi ka shtuar pyetje po ashtu edhe për procesin e vlerësimit të komisionit në lidhje me subvencionimin edhe të organizatës e cila ka organizuar panairin e librit për vite me radhë. Me thënë të drejtën, ankesën nuk kam pa, të jam i sigurtë ngaqë e shtrova atë pyetje. Komisioni i ankesave e ka kryer punën e saj, po ashtu dhe komisioni i vlerësimit. Unë vlerësoj jo vetëm organizatën e juve që merret me promovimin e vlerave të librit, por secilin organizatë që e promovon librin në këtë rast. Po arsyeja se pse është ndarë shumë dhe pse është ndarë shumë aq, jam i sigurtë, nuk kam ndonjë informacion, ngaqë komisioni ka pasur edhe nga shoqëria civile, edhe nga drejtorja, edhe akterë të jashtëm dhe po besoj që në ankesën që ju kam dërguar është dashur me dhënë edhe arsye pse është vlerësuar mirë apo jo mirë mbështetja financiare. Levent Bush, shkolla Mustafa Bakiu në vitin 2025 është futur në projektet të cilat i ka Drejtorja e Sportit dhe po ashtu terrenet sportive këtë vit jemi afër shpalljes së apo vlerësimit të tenderit, ku janë të parapanë edhe projekti i shkollës Mustafa Bakia dhe po urojmë që brenda mundësive që kemi do t'i bëjmë ndërhyrje të gjitha objekteve sportive, qoftë në shkolla dhe qoftë në ambientet e jashtme. Kurse e keni shtuar pyetje edhe në lidhje me subvencionimin e organizatës apo klubit që udhëheqni ju apo dikush tjetër dhe klubet e tjera. Të them të drejtën, mundësia kishte me qenë më e mirë që, siç e potencionoi dhe kryetari që të ketë edhe më shumë mjete financiare të mbështeten organizatat, mirëpo duke pasur parasysh që deri në vitin 2021 mbështetja financiare për klubet edhe kulturore edhe sportive ka qenë rreth 300.000 euro, kurse në qeverisjen e zotit Totaj kjo shumë nga 300.000 ka shkuar në 1.5 milionë euro dhe normalisht kërkesat janë akoma më të mëdha, mirëpo normalisht janë mundësitë buxhetore sepse kemi një numër enorm të organizatave dhe jemi munduar që mbështetja më e madhe të jetë në organizatat të cilat me të vërtetë i japin gjallëri jetës edhe kulturore edhe sportive në qytetin e Prizrenit. Po ashtu të njëjtën pyetje ka shkruar dhe zënjë Dafina Alishani në lidhje me subvencionimin e të gjitha organizatave në këtë rast. Me të thënë të drejtën edhe unë kam qenë edhe i gatshëm edhe jemi të gatshëm që me të vërtetë organizatat të cilat bëjnë aktivitete edhe kulturore sportive në qytetin e Prizrenit, ngaqë po e shohim që fluksi i turistëve është rritur, çdo ditë e më tepër po rritet dhe normalisht jemi munduar që organizatat të cilat me të vërtetë kanë aktivitete edhe kulturor edhe sportive, janë mbështetur në mënyrë serioze. A kishte me qenë mirë të mbështeten edhe organizatat e tjera? Ndoshta ka ndonjë organizatë që me të vërtetë bën aktivitete edhe kulturor edhe sportiv të mirë, por nuk e di, ka mujt të ndodhë që organizata në thojza, në fjalë, çfarë mund ta marrim një organizatë, nuk ka pasur ndoshta dokumentacion edhe komisioni ka një rregullore që bazohet në bazë të rregullores 04/2017 dhe rregullores së brendshme të kuvendit, sigurisht aty nuk ka mujt edhe të kaloj. Kështu që nëse ka edhe diçka tjetër jemi të gatshëm me u përgjigj. Faleminderit shumë.

Bexhat Bytyqi (D.Bujqësisë): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, kolegët, kolegët, drejtorët, drejtoresha, kuvendarët të nderuar, media, shoqëritë civile dhe ju qytetarët të nderuar. Do të mundohem të jem më konkret në përgjigjet nga në pyetje të parashtruar nga nga kuvendarët. Qemal Krasniqi pyeti për sistemin antibreshër. Ëh, në këtë projekt kemi filluar qysh në vitin 2023. Ëh, në vitin 2024 jemi munduar të pajisemi me leje nga Ministria e

Ambientit dhe Planifikimit Hapësiror, gjithësisht nga Departamenti apo Instituti Meteorologjik. Po nuk kemi hasur në mirëkuptim, nuk na kanë dhënë leje për arsye se hapësirat domethënë ajrore i menaxhojnë ata, ne nuk mund t'i menaxhojmë këto hapësira dhe nuk na kanë dhënë pajisjen me leje. Dhe mjetet, domethënë, vitin e kaluar kanë shkuar në suficit për këtë arsye dhe në këtë vit nuk e kemi planifikuar, sepse nuk mund të pajisim me leje. Ertan Simiçi ka parashtruar kërkesën për dezinfektim dhe dezortizimin e qytetit të Prizrenit, gjithashtu edhe Dafina. Ne me alokimin e mjeteve, domethënë, në muajin shkurt, menjëherë kemi marrë iniciativë dhe kemi hapur tenderin. Ky projekt është tenderuar në muajin mars, mirëpo ka hasur në ankesa të shumta dhe lënda është në OSHP dhe ende është e pazgjidhur kjo çështje. Domethënë për këtë vit nuk kemi kontratë, ne kemi parapa kontratë kornizë këtu për dy vjet me bë zgjidhjen po faktikisht kjo është në OSHP ende. Gjithashtu edhe Shukri Quni ka parashtruar kërkesën për hapjen e rrugëve edhe Petriti. Ne Petrit the që nuk jemi tu punuar, ne jemi tu punuar në këtë projekt edhe jemi në vazhdim të punimeve, lëndë apo kërkesa të cilat janë të parashtruara jemi në shqyrtim e sipër dhe jemi duke u munduar që ato rrugët që janë me distanca pak më të shkurtra me me mund me i përfshirë të gjitha dhe me me i realizuar, por kjo është e pamundshme për shkak të buxhetit që ne e kemi. Ju e dini se Drejtoria e Bujqësisë për këtë vit i ka të ndarë me 190.000 euro në këtë projekt dhe me këtë kapacitet që ne kemi do t'i shohim mundësitë komisioni do t'i shoh vetëm ato rrugë që janë më të nevojshme t'i përfundojmë, pasi që nuk kemi mundësi të gjitha t'i kryejmë. Po kërkesat e juaja gjithsesi do t'i, do t'i rishqyrtojmë edhe njëherë, do të do të shohim mundësitë tona. Ju faleminderit.

Islam Ukimeri (D. Inspektorateve): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje për kryetarin, nënkryetarin, koleg, drejtor, asamblesë, media dhe të gjithë të pranishëm. Mua më janë bërë disa pyetje këtu në asamble. Pyetja e parë ka qenë nga Shukri quni në lidhje me trotuarët afër banesa kolektive, ndërtesat e reja, ku janë duke u ndërtuar që është, nuk po ka hapësirë. Sa i përket hapësirave, lejet i jep urbanizmi dhe ne si drejtori inspektojmë, a janë duke respektuar ato leje? Hapësirat sa ju përcaktohet me ligj është urbanizmi që jep. Çfarë hapësira? Janë të mëdhaja apo të vogla? E përcakton urbanizmi, drejtoria e urbanizmit. Ndërsa ne si inspektoriat i inspektojmë, a janë duke u respektuar ato lejet e ndërtimit? Kjo është përgjigja sa i përket kësaj pyetje që është bërë. Ndërsa pyetjet e Karanfilin dhe pse s'është këtu, po do ta jap për shkak të qytetarëve. Kinse është bërë një rrënim tek tranziti i ri rreth një objekti të vjetër apo demolim. Ne si drejtori kemi zhvilluar të gjitha procedurat, kemi pasur vendim për rrënim, urdhër të ekzekutimit, kemi pasur vendim për edhe edhe vendimin nga komisioni i ankesave që ju ka refuzuar ankesa e një qytetarit. Dhe ne mbasi janë ankimuar të gjitha ankesat, ne e kemi rrënuar atë objekt. Dhe ai objekt është pronë e komunës dhe ajo është bërë për arsye të bëhet liri hapësirave publike, kudo që janë hapësira të uzurpuara që janë pronë publike. Kjo ka qenë pyetja për Karanfilin. Ndërsa sa i përket Selman Sokolit mu bë pyetje rreth një shtëpie që ka një ndërtim të egër. Mua më vjen mirë që e ka identifikuar Selmani këtë ndërtim të egër në qytet, po po e njoftoj Selmanin që drejtoria e inspektoratit në këtë rast sektorit e ndërtimit e ka bërë pak më herët atë identifikim dhe i ka zhvilluar të gjitha procedurat. Dhe ndoshta besoj tash edhe zërin ma keni dëgjuar, mirë. Ë, pyetja tjetër ka qenë nga Sevil Kazaz në lidhje me ekranet afër shtëpive të banimit. Sevil ne i kemi inspektuar të gjitha ekranat, kemi pasur edhe më herët disa ankesa nga banorët, nga qytetarët që janë për rreth aty dhe janë të gjitha ekranat janë të pajisur me leje. Është e vërtetë që ka rezolucion pak më tepër, por në mbrëmje, i kemi kërkuar nga aty që të bëhet, ulet ndriçimi më për shkak që është te orët e vona, por ne kujdestarët natën nuk kemi inspektorët, po nga 1 qershorit do dalin

edhe inspektorët, faktikisht mbas orës 16:00 do ketë edhe në mbrëmje, do të inspektojnë të gjithë ata që e kanë rezolucionin pak më të lartë, do t'i lajmërojmë që ta ulin rezolucionin. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po po ka replikë, zoti Quni, pastaj edhe Selmani. Tash po, tu ka përmendur emrin edhe në rregull jemi.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Drejtor, unë u orientova pikërisht edhe e di shumë mirë që nuk e ngarkoj veten me punë që nuk më takojnë. Këtu ka drejtor që ngarkohet me punët, i merr të gjitha drejtorive po s'e kryen asnjë. Unë e kam një elektorat ku e përfaqësoj. Është fjala Nashec, Grazhdanik, Kojush, Planej, Mazrek qaty pari, asnjëherë nuk më ka dhënë përgjigje çka ka ndodhur midis Shatërvanit. Inshallah e ndërtoni të qeshmja aty ku është. Për mua. Nëse unë për shembull e ngris një çështje të tillë. Problemi që po e ngris unë është problem shumë i madh. Rruga që shkon prej Nashecit ose prej Prizrenit në Nashec. Është rrugë, koleg, ju kisha lutur veç pak. Është rrugë që e kemi ndërtuar me vetë kontribut, me participim në atë kohë, kur ka qenë LDK-ja në pushtet, kryetar ka qenë Eqerem Kryeziu. Rrugë as 6 m nuk na kanë bërë, 5 m e gjysmë. Sot ajo rrugë është e ngarkuar me ndërtesa me ka 15 kate. E kam ngritur këtë çështje edhe më herët jo sot. Qysh mundet me ju dhanë leje që tash kur po thoni nuk jemi, po kush është aty? Me një rrugë 5 m e gjysmë me u bë tërë ato ndërtime. Tani me zor erdha, se kerret po i lënë tash, një troh trotuar është. Unë e kam pasur vetë ballafaqime me njerëz që i kanë ndërtuar. Më ka thënë personi, zotni, unë e kam mexhën deri këtu. Thashë, ti e ke mexhën deri këtu, por me pasur shtet, ty t'i qet shteti kushtet, përderisa ti nuk i plotëson këto kriteret, ti në ndërtim sun bën këtu. Unë kam rast kur e livron arën e vetë deri në asfalt. Për çka jemi ne shtet këtu? Për këto ne jemi shtet. Me i treguar atij që ti e jotja është, po edhe ti me ndërtuar duhet me i plotësuar këto kriteret. Me ik 5 m prej rrugës të shtetit. A të tri a sa ja përcakton? Shko kqyret tash, çfarë çfarë ndërtimi është? Ku shkon kanalizimi aty? Ku shkon aty? Kush e mbush me ujë ato ato pjesa aty? Që as ujë s'ka. Këto janë ato kriteret që po i lypni unë. Pikërisht në ato pjesë ka vijon. Edhe kurrë s'kam ngritur çështje që nuk më takojnë mua përshembull. Me ngritur çështje për Korish. Unë e koriti Agim Muqën aty. Me ngritur çështje për, Malësi të Vrrinit atje, e koriti Adem Shabanajn. Unë i kam pjesëtë ka vij. Edhe që ato pjesë i ngre, si çështje unë i bëj këtu në këtë kuvend. Edhe rrugët që s'po që s'po pastrohen prej llugave. A dojna me bë në atë qytet, fshat turistik Nashecin? Për çdo ditë ke ndeshje. Pse kanë ardhur llugat, e kanë zënë, e kanë zënë rrugën? Unë qëto i ngres këto çështje. Nuk ngres unë çështje që nuk i kam unë në përgjegjësi. Edhe hala nuk e kam bëra një kërkesë të tillë që s'më takon. Që ato më takojnë, për atë jam këtu unë. Ndash që s'po flasim hiç, po ju lavdojmë, po them, merre maro edhe një rrugë, medis se ku kemi pasur një, që me zor e kemi hequr. Por kushgjo mos u përmend që ky kuvend, edhe kryetari Shaqir Totaj, ka me u përmend për të mirë që e ka liruar rrugën e tranzitit. Mbajen mend çfarë po them këtë? Sa herët jam këtu, nëse i kam ymër me qenë hala në këtë kuvend, po kam mendjen edhe njëherë me kandiduar mbrapa shëndosh. Sikur që po e përmendi këtë kuvend që e ka bë, profesor, doktor Eqerem Kryeziu? Kjo ka qenë, a do me po e them në atë gjuhën e kojshive atje. Jugosllavenska naroda armija është quajtur që ky kuvend. Sot është kuvend që flasim ne shqip. Edhe çfarë i thonë këto edhe minoritetet. Nuk është punë e vogël kjo. Unë një njeri që punon edhe kontribuon, o ke kush ke, unë hiq se kam dert, ja jap lavdatat sa i ka. Veç, kur nuk punon, ka me t'i thënë që s'ke punuar edhe ka me të dhënë vërejtje, kritika deri sa munde. Këtu është ajo mua që po më djeg. Kurrigjo tjetër? Edhe rruga që u pre asfalti. A mos

me e ngrit si çështje unë atë? Komplet ma ki borxh ju si drejtor edhe drejtori Çel Lamaj. S'po di çka me i thënë atyre trap i kerrit që mu ka dëmtuar për asfalti që është prej të. Jo mos kesh. Jo jo po ti ma ki borxh ata se e keni pre asfaltin. Duhet duhet me i rregulluar dikush aty, jo unë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Quni. Po kryetari fjalën e ka. Pastaj Selmani, po.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Po ju kërkoj falje se mbeta po e dhënë një shpjegim me tash po e shoh që pasa kalu, kjo rruga që shkon prej stacionit të autobuzeve për me dalë te trekëndëshi aty te prokuroria që po punohet. Ai nuk është projekti i komunës të Prizrenit, është projekt i hidroregjionit. Është punuar më herët, kur e kanë hapur rrugën e kanë rregulluar infrastrukturën nëntokësore, pastaj ka pasur ankesa që asfaltin nuk e kanë shtruar mirë edhe nuk e kanë rregulluar qysh duhet. Prandaj ne kemi kërkuar prej tyre që edhe njëherë të bëjnë punën edhe të rregullojnë më mirë. Domethënë nuk shpenzohen mjetet të buxhetit të komunës, por mjetet të investitorit i cili e ka rregulluar infrastrukturën nëntokësore. Ju falenderoj për vërmendjen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit kryetar, po replikën e ka Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, nëse ju kujtohet në fillim të mandatit, me pompozitet, një projekt shumë serioz, në thonjëza e keni promovuar rregullimin e unazës. Edhe shtresa e asfaltit është fundi, gjithë infrastruktura do të duhej të përfundonte. Tash ne po shohim ajo rrugë tri herë, katër herë, pesë herë ka me u shtru, mirëpo po dalin probleme të tjera. Kaq sa i përket seriozitetit të projekteve. E dyta, mirë që kryetari nuk qenka në dijeni, domethënë, çfarë është duke ndodhur në Prizren. Drejtori paska evidentuar, mirëpo evidentimi i një paligjshmërie, një parregullsie nuk mjafton. Në 23 mars 2025 ka mundësi që inspektorati ka evidentuar rastin konkret të ndërtimit të paligjshëm, pa leje mbi ndërtim, si do që ta quani. Mirëpo aty po punohet. Tash unë po e sfidoj drejtorin në bazë të kodit penal të Republikës së Kosovës, neni 359, nëse s'gaboj, ndërtimi pa leje është i kundërlindshëm edhe është vepër penale. Inspektorati komunal edhe drejtori pasi që është në dijeni, a ka nxjerrë akt vendim për rrënim të mbindërtimit ose ndërtimit pa leje edhe ka bërë kallëzim penal për palën që po bën ndërtim pa leje, kushdo qoftë. Nëse këtë nuk e bëjnë, tash mirë që fole drejtor, këta duhet me pas përgjegjësi për mosveprim. Përgjegjësi mundet me pasur edhe kryetarin, mirëpo kryetari nuk e ka paska idenë që çka po ndodh në komunën e Prizrenit. Tamam kështu kryetar në letër me quajt, po kujdeset më shumë për pjesën... Po vazhdimisht ne marrim nuk marrim kurrë përgjigje shpifje, insinuata, jo po folni pa lidhje jo pa argumente. Tash, dulë që drejtori e pranoi edhe kryetari, domethënë ashtu e paska kasetën gjithmonë, pa e verifikuar faktet. Të paktën duhet me marrë seriozisht çështjen që e ngrit një asambleistë, mundet me thënë sot nuk di me të kthy përgjigje, në seancën e radhës ose me shkrim ta kthej përgjigjen të detajuar. Kaq, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zonja Sevil.

Sevil Kazaz: 1:34:40- 1:35:

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po hajde Karanfil.

Karanfil Haxhillari (LVV): Se u përmenda. Është në rregull me i liru hapësirat publike drejtor, por edhe në qoftë se dëmtohet një biznes e sidomos prodhues, me të vërtetë është rast i ndjeshëm. Prandaj sipas informatave që i kam nga ai biznes, ata janë të pajisura me... rasti është për rrënimin

e objektit të ndërtimit të mobiljeve familjes Mani. Është dashur me u trajtu pak më ndryshe, ku kemi uzurpime gjithëandej komunës, prapë unë po e përsëris lirin e pronave të huaja. Edhe në fund i mbeta borbë kryetarit. Kryetar, unë nuk përmenda emër. Unë thashë tetë zyrtarë. Nuk jam prokuror me aludu në fajësi. Ju e përmendët emrin. Edhe unë besoj që Edini është i pafajshëm, por unë nuk përmenda emër sa i përket aktakuzave. Unë veç ju pyeta a do t'i mbani fjalët apo jo? Kaq.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Meqënëse më përmenda emrin, po të përgjigjem ashtu shumë shkurt. Për stafin politik, kemi dhënë premtime dhe qëndrojmë mbrapa atyre premtimeve. Nuk po aludoj a është fajtor apo nuk është fajtor. Nuk kemi asnjë dokument me shkrim, as unë si kryetar i komunës, as drejtori, as prej prokurorisë, as prej gjykatës. E kemi parë nëpër media, nuk po e komentojmë ato, veprimet e prokurorisë nuk komentojnë. Kur ta marrim dokumentin me shkrim, ose unë, ose Edini do t'i shoh veprimet tona. A për punëtorët shërbyes civilë që janë, janë standarde të tjera, për stafin e emëruar politikë janë standarde të tjera.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Kryetar, unë mendoj që ju këtu e keni detyrë me na u përgjigj në pyetje e jo me i klasifiku a jemi parimorë apo nuk jemi parimorë. Nëse ka diçka që është jo parimore, është me e përkrah një festival i cili ka vetëm tre vite, kundrejt festivaleve që kanë 20 vite e më shumë. Qekjo është jo parimore. Unë nuk po e kuptoj si po ka tolerime, kur ka lavdata për qeverisje, nuk ndalen mikrofonat, nuk ndalet fjala, kurse kur ne e bëjmë punën tonë dhe kërkojmë llogari, atëherë tentohet të ndalet edhe fjala, edhe mikrofoni, edhe të gjitha. Drejtori i Kulturës po thotë që ne i kemi përkrahur organizatat të cilët kanë përkrahur laramaninë kulturore. Drejtor, ne jetojmë në këtë qytet edhe e dimë kush e bën laramaninë edhe në kulturë, edhe në sport. Ti ke pasur fat që je këtu katër vite menaxher, në rregull, po mos e keqpërdor. Dëgjo Ojq-të, hajde leje Dafina që qenka opozitë. Ke organizata të cilët kanë ankesa çdo vit. Pse bre kjo këtu veç shurdhër me pas kështu? Çka është kjo arrogancë e këtij pushteti. Ju sot jeni, nesër nuk jeni. Secili drejtor që ka ardhur, ka ardhur me një laramaninë kulturore sportive në Prizren. Nuk është meritë e juaj. Ju vetëm çka mundeni me bë, është subvencionimin me e bë ashtu siç duhet edhe mos me diskriminu organizatat dhe klubet. Po me fol për parime e me bë festival për qejf me taksa të qytetarëve, për besë unë nuk po e kuptoj këtë. A mundeni veç me na u përgjigj në pyetje, klasifikimin e parimeve na lëni qytetarët le ta vlerësojnë se ju nuk jeni për këto. Faleminderit.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Kjo fjalë sot jeni nesër nuk jeni, a po na mohan ekzistencën fizike apo çka është pyetja?

Dafina Alishani (LVV): Tash ne mund të diskutojmë për filozofi, ekzistenca fizike, imagjinare, këto keni qejf ju, mos me u përgjigj në pyetje. Po thjesht unë po ju vlerësoj kështu edhe i thashë edhe ju e dini, sot jeni, nesër nuk jeni. Mandatin e keni katër vjeçar, Ojq-të që janë me plot mandate këtu. Edhe nuk ka të drejtë asnjë drejtor, asnjë kryetar me i mohuar të gjitha vitet që i kanë bërë këto Ojq dhe këto klube në këtë qytetin e Prizrenit. Ju tash mundeni me lujt hajgare sa të doni kryetar, se stil e keni ju kështu. Stil e keni me mohu me u përgjigj, stil e keni me lujt hajgare me kuvendar, po qytetari po e shoh shqyrr. Vazhdoni ju, a imagjinari, a fizik, a qysh doni e queni.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Sa për stil ty po ta lajm.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafinë, një replikë e kam edhe unë. Po më vjen keq që je prezente, të kuptoj që e ke bashkëpartiak zotërinë kolegun Selmani. Po mua shumë po më vjen keq që je prezente këtu edhe je tu i pa ngjarjet. Mikrofondi nuk u ndal, u ndal pikërisht për arsye që nuk e kërkoj fjalën hiç, po menjëherë filloi me. Përndryshe kur e kërkuat fjalën me ngritje të dorës edhe ju takoi replika, ju dhashë si zotërit Quni, si Selmanit, Sevili edhe juve po ashtu. Mikrofondi e kolegut i u ndal për arsye se filloi me fol pa leje. Kështu që, në rregullore na shkruan shumë qartë që kur një anëtar i kuvendit e merr fjalën pa leje, kështu që po, po patjetër, po se ta përmend emrin.

Dafina Alishani (LVV): Asesi, asesi nuk e kam për çështje teknike që ju i bëni. Përmbytjen e fjalimeve ju ndërhyjnë. Këtu është problemi. Secili kur të marrim fjalën prej opozitës jeni shumë më të vëmendshëm sesa kur flet pozita. Kur lavdërohet ekzekutivi, qoftë edhe nëse kalohet minutazha, heshtni. Këtu e kam qëllimin se kush e ka dhez mikrofonin kush nuk e ka dhez, është punë e juaja, mendoj që e bëni mirë, jo në përbërjen e fjalimeve me ndiku ju si kryesues.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull, faleminderit. Urdhëro, po të lutem, urdhëro, të lutem.

Selman Sokolaj (LVV): Meqë tash po mundohesh me ik. Pasi s'ka zotëri Selmanaj këtu, po besoj që unë isha ai që u përmend nga ju. Mundemi me i shikuar edhe videot e seancave. Ndalja e fjalës prej anës juve kryesisht ndaj meje, por edhe ndaj Dafinës ka ndodhur, ndaj të gjithë kolegëve opozitarë. Shumicën e rasteve ka qenë për çështje përmbytësore, jo procedurale. Sa i përket procedurave, seancën e radhës na e lënë rregulloren secilit asambleist këtu përpara. Nëse s'ka rregullore atëherë nuk mundem të vazhdojmë seancën. Na e lënë rregulloren, qysh e bëjnë në kuvendin të Kosovës edhe i lexojmë nenet, nuk mundesh me na interpretu rregulloren si të duash. Seancën e kaluar pas çdo fjale të ekzekutivit pat replikë për shkak se dikujt tjetër i ka konvnuar, sot nuk paska replikë. Edhe unë dashta me kërku fjalën për shkak se nuk mundem me heshtë në kësi raste të mohimit dhe të papërgjegjësisë totale qysh e ka Shaqir Totaj ndaj kuvendarëve. Edhe drejtori i inspektorateve për herë të parë foli edhe demantoi. Është mirë me fol, sa më shumë që të folin drejtorët e demantojnë. Ky nuk po folka se po e demantojka kryetarin. Shumë mirë që foli, mori guxim po qe e demantoi kryetarin. Kështu që pata të drejtë me marrë fjalën, mirëpo nuk ke interesime se zakonisht po të bën presion kryesuese, mos harro. Shaqir Totaj është kryetar i komunës së Prizrenit, nuk është legjislativ. Ne jemi legjislativ. Nëse s'i pëlqejnë rregullat e legjislativit, mundet kurrë mos me ardhë. E ka marrë votën me qeverisë Prizrenit në bazë të kompetencave, nëse mendon që ja del pa asamble, kurrë mos të vijnë, bile edhe s'kishte dalë ato qysh i blenë asambleistët. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Unë nuk e di qysh e sheh, veç mua s'po më kujtohet që thashë që sot nuk ka replikë. Kështu që ti the sot nuk ka replikë. Mbledhjen tjetër, po në rregull këtu po e përmbysim sepse ju kërkojmë falje të nderuar kolegë pse u zgjat kjo kështu, po po kalojmë te drejtori për shëndetësi.

Simir Krasniqi (D. Shëndetësi): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor, të respektuar asambleistë. Unë pata pyetjen nga baca Haziz që të pajiset qendra e mjekësisë familjare me një autoambulancë. E kemi në plan që disa qendra të mjekësisë familjare, ti pajisim me autoambulanca, do ta konsultojmë edhe këto, në planifikim të drejtorisë të shëndetësisë është furnizimi pra me autoambulanca për disa QMF, të shohim mundësinë edhe për QMF-në e

Gjonajve. Pyetja e dytë ishte e zotëri Qemalit, që orari i mjekëve dhe infermierëve në qendrën e mjekësisë familjare apo qendrat kryesore të mjekësisë familjare. Ata orari është prej orës 7:00 deri në ora 3:00, orari i punës, prej 9:00 deri në ora 10:00 e kanë pauzën e mëngjesit, por në ndërkohë ata në pauzë është të tjerët që qëndrojnë aty, nuk e lëjnë institucionin pa mjek ose pa infermier. Tash ku keni qenë ju në cilën qendër? Mundeni me bë një ankesë, është komisioni disiplinor, ata duhet ta respektojnë orarin e punës. Unë pajtohem këtu që çdo mjek çdo infermier është i obliguar që ta respektojë orarin e punës. Te pyetja e zotit Mergjan, shtimi i stafit shëndetësor të infermierëve dhe mjekëve në qendrën e mjekësisë familjare. Ju duhet ta dini se kërkesat edhe mundësitë që kërkesa është shumë e madhe për mundësi dhe ligji nuk na lejon se shtimi i stafit shëndetësor varet nga numri i banorëve që grafitojnë në atë qendër, në qendrën e mjekësisë familjare në Reçan. Në qoftë se ju kërkonit aq shumë, ne nuk na lejon ligji që ta rrisim numrin e stafit shëndetësor në Reçan apo qendra të tjera. Do ta shohim mundësinë se ku ka mungesë pra a në QMF-të Reçanit apo në AMF-të të tjera dhe të shtojmë ku na lejohet me ligj pra me numrin e banorëve që gravitojnë në ato qendra. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Atëherë edhe drejtori për turizëm fjalën e ka kërkuar. A pate replikë? Hajde zoti Qemal.

Qemal Kransiqi (LDK): Drejtor, në AMF-në në Medvecë nuk respektohet orari. Në QMF-në Piranë nuk respektohet orari. Mos të hyj edhe ma tutje. Nuk fola për qendrën e kryesore të mjekësisë familjare. Aty nuk fola se s'kam pasur rast me pa. Edhe kërkova prej teje që me u marrë me këtë çështje, nuk është çështje që me bë ankesë apo diçka, ne ta respektojmë orarin. Kaq kisha. E shfrytëzoj rastin edhe s'është replikë po me drejtorin e Bexhat. Drejtor, respekt e keni për punën që jeni duke bërë, po edhe ti vjen nga rajoni që vij edhe unë, një zonë bujqësore. Edhe këto ditë të gjithë fermerët duke bazuar në kushtet klimatike, të gjithë janë nën ethe, sepse shpeshherë e di edhe ti që breshëri ka dëmtuar perime kulturat, pastaj vreshtat dhe një mund i madh që bëhet prej dimrit dhe mos me qenë në gjendje me mbrojtë perime kulturën, s'di atëherë çka po bëjmë ne. Unë e di që hapësirat nuk menaxhohen nga pushteti lokal. Po duhet vazhdimisht me bë përpjekje edhe nëqoftëse është nevoja, kryetari, nënkryetari, ti me i thirr ata zotërit të Ministrisë të Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor edhe me bë diçka, se nuk është ku me di çfarë investimi, nuk është ku me di se çfarë problemi me i ngrit sistemet kundër antibreshër. Po unë po kujtoj këtu që jemi t'i lëmë vetëm për neglizhencë. Grunajat janë në fazën e pjekurisë. Domethënë, të gjitha janë në këtë fazë kur një breshën i dëmton të gjitha. Duhet me bë përpjekje maksimale. Në qoftë se është nevoja edhe natën me punu, vetëm me i pshtu. Kaq kisha.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtor, nëse ke diçka me shtuar.

Bexhat Bytyqi (D.Bujqësisë): Qemal, veç shkurt du me t'u përgjigj. Nuk është asnjë lloj neglizhence. Kur ju e keni potencuar këto, ne kemi qenë një vit para jush e kemi potencuar këto dhe kemi filluar. Po, po atëherë ke ke mujt, ke mujt, po pse s'e ke bërë? Po. Kundër kundër buxhetit shumë të vogël, kryetari pa hezim na ka nda mjetet vitin e kaluar edhe mjetet kanë qenë të ndame për këtë projekt, por nuk po mundet me me u realizuar. Tash mos të bëjmë polemikë në ato se ti e kupton. Nuk është në menaxhimin tonë hapësira ajrore. Edhe nuk lejohet leje. Kaq.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po, drejtor. Urdhëro fjala për juve.

Ramadan Tarashaj (D.Turizmit): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor, të nderuar asambleistë dhe ju media. Kisha një kërkesë prej Sevil Kazaz, përse i përket Filigranit, ne jemi duke investuar veç në trajnime, për renovimin e objektit, ne jemi duke menduar për një muze të Filigranit dhe po besojmë që në momentin që e gjejmë një lokacion më në qendër të qytetit, do të keminjë bisedim edhe me kryetarin dhe do t'i zhvendosim aty filigranin. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Në qoftë se nuk ka të tjerë atëherë po ju falenderoj të gjithë anëtarët e kuvendit gjithashtu edhe drejtorët për kontributin që e dhatë në këtë pikë. Po vazhdojmë me pikën tjetër të radhës. Pyetja, po vazhdojmë edhe pak. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraparak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile. Po zotin Rakaj e kemi këtu për prezantim.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraparak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të Shoqërisë Civile;

Bashkim Rakaj (Zyrtar): Mirëdita. Përshëndetje kuvendar. I nderuar kryetar, unë jam Bashkim Rakaj, e vij nga Drejtoria për punë dhe mirëqenie sociale. Po mundohem shkurtimisht t'juu prezantoj projektin që ka inicuar Drejtoria për punë dhe mirëqenie sociale në aspektin kryesisht profesional duke analizuar nevojat për ndërtimin e një qendre të autizmit në komunën e Prizrenit. Duke marrë parasysh se në qytetin e Prizrenit është një numër i caktuar i fëmijëve dhe të rritur që ka nevojë për shërbime të trajtimit profesional të fëmijëve dhe të rritur me të diagnostikuar me autizëm. Ë, Drejtoria për punë dhe mirëqenie sociale ka pasur si të nevojshme fillimin e procedurave për realizimin e ndërtimit, qendrës për trajtimin e fëmijëve, të rriturve dhe familjarëve të tyre që kanë nevojë për shërbimet me autizëm. Duke pasur parasysh nevojën e tillë, ne kemi kërkuar nga kryetari i komunës ndarjes së një prone, një parcele, ku do fillojë ndërtimi i kësaj qendre, që kemi pasur mbështetje dhe na është ndarë një pronë. Besoj që e keni nëpër materiale që e kemi dërguar përmes emailit. Modaliteti i dhënies së pronës në shfrytëzim për ndërtimin e kësaj qendre përmes organizatave të shoqërisë civile, e kemi parë të nevojshëm duke marrë parasysh se është projekt që ka ndikim të lartë financiar. Përveç ndikimit në ndërtim të lartë financiar edhe ndikim në si me thënë funksionalizimin dhe mbajtjen e institucioneve të tilla sepse kërkon profesionalizëm edhe kërkon profesione të veçanta që ofrojnë shërbime në qendër, që si me thënë në një farë forme vështirëson ofrimin, blerjen e shërbimeve përmes shtetit në ofrimin e këtyre shërbimeve nëpër qendra të tilla, kemi menduar që të propozojmë, të bëjmë një thirrje publike, një ftesë që me pa a kanë interes organizatat të specializuara që ofrojnë shërbimeve të tilla në komunë Prizrenit, me ofruar një shërbim të tillë. Pak për informacion, prona është në ngastrën kadastrale me numër 110817, e cila gjendet tek lagjia e Prizrenit Tusuz. Është e mjaftueshme, besoj se i plotëson kushtet edhe kriteret për ndërtimin e një qendrës së tillë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotëri Rakaj të lutem mundesh me u ul aty edhe nëqoftëse ka dikush pyetje mundet me e kërkuar fjalën. Po kush dëshiron me e marrë fjalën? Zotri Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit shumë. Unë përnjëmend nuk e kam të qartë. Kam menduar që veç është ofruar dikush prej organizatave joqeveritare me bë një ndërtim të tillë. Më mirë do të ishte që komuna vetë me e marrë këtë iniciativë, me parapa në buxhet vitin tjetër edhe natyrisht

edhe me e caktu edhe vendin, me e dhënë vendin në shfrytëzim. Kjo, a del ndonjë organizatë joqeveritare me konkuru, a është e interesuar, kjo është në bisht të sorrës thonë. Nëse jemi të interesuar me e bë këtë qendër, që është shumë e ndjeshme, ndoshta edhe shumë e nevojshme, është mirë që komuna vetë me nis me iniciu. Kështu që kërkesa do të duhej të jetë me u nda qaj vend, vendi që e përmende me ju dedikuar këtij ndërtimi dhe pavarësisht a konkuron kush a s'konkuron me bë komuna në buxhetin e vitit të ardhshëm. Faleminderit.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, i nderuari zyrtari i drejtorisë. Sa është numri i personave në komunën e Prizrenit? A keni statistikë sa është numri i personave me autizëm dhe në këtë qendër kush do të merr shërbimin? A do të jenë edhe personat jashtë komunës së Prizrenit apo vetëm të komunës tonë?

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. Fillimisht, ky propozim do të i ngjason propozimit për një projekt që ka kaluar në këtë kuvend komunal, hiç më larg se disa muaj apo vitin e kaluar. Do të thotë, kuvendi komunal, një parcelë të caktuar që është pronësi e saj në lagjen Bashdarhane, me një procedurë të ngjajshme si kësaj ja ka dhënë shoqatës Jetimat të Ballkanit nën pretekstin e ndërtimit të kuzhinës popullore, për familjet skamnore dhe në nevojë. Është arritur marrëveshja, i ka kaluar të gjitha procedurat dhe quditërisht, pas nënshkrimit të marrëveshjes, zotëri Halil Kastrati pastaj nuk promovon vetëm kuzhinën popullore, si qëllim kryesor, po aty prezanton një mega projekt, prej qëndrimi ditor për të mëshuar, amfiteatrit, bujtinat për studentë, e tjera, e tjera, e tjera. Kam frikën se ngjajshëm do të përfundon edhe ky projekt. Ngase nga provoja e deri tanishme e kuvendit komunal, shumë prona kur janë dhënë, kemi shumë projekte, s'po dua me hy me i numëruar që kanë deshtu. Komuna dhe marrëveshjet kur i harton, harron ta vë klauzolën aty se në moment të ndërrimit të destinimit, me automatizëm, e merr të drejtën. Po nga provaja shumicës së kontratave që i kam lexuar, në fund vihet një farë klauzole juridike që të gjitha kontestet do të zgjidhen në gjykatë. Që nga dhënia e çerdhës Yllka, dhënia e pronës për ndërtimin e banesave, në lagjen Tabakhane për 14 familje të dëshmorëve, e tjera, e tjera, e të tjera. Diqysh e kam përshtypjen që ky ekzekutiv dhe kryetari nuk lënë hapësirë publike pronës komunale që të ndërtohet një park. Ajo hapësirë në lagjen Tusus që është pronë komunale diku afërsisht nga disa parcela përbën një tërësi prej një hektar e gjysmë. Aty është dërguar qendra e dytë për punët sociale, përballë do ta keni sipas këtij propozimi, qendrën për trajtimin personave me autizëm, do ta keni qendrën e mjekësisë së re familjare, po hapësirën gjelbëruese nuk do të ketë për disa vite aty si të përfundojnë këto ndërtime, ngase janë të rrethuar me infrastrukturë joformale të qytetarëve me ndërtimin e shtëpive që i kanë. Prandaj, unë qysh dhe e pashë që organizatat Tika në Prishtinë për 250 persona të komunës së Prishtinës, veç e ka ndërtuar qendrën për trajtimin e personave me autizëm, madje ka filluar edhe kurset për zhvillimin edhe për trajnimin e stafit që do të punësohet aty. Mirëpo kjo marrëveshje për mua pak a shumë prapë është e dyshimtë, ngaqë qysh në fillim kufizohet dhe i pamundësohet pjesëmarrja në aplikim OJQ-ve të tjera, për shkak se keni vu klauzolë OJQ-të që merren me veprimtari vetëm në komunën e Prizrenit. Pse? Jo jo. Lexoje mirë çfarë keni shkruar. Ju po penalizoni të tjerët në veprimtari. Prandaj unë nuk e mbështes një iniciativë dhe nuk do ta votoj këtë propozim. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaçi. Dikush tjetër a ka prej anëtarëve të kuvendit që dëshiron me marrë fjalën rreth kësaj pike, po Faruku pastaj dhe Karanfil.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Për parcelën për të cilën po kërkojnë të votohet këtu për ndërtimin e një qendër për autizëm. Aty nuk është, nuk është vetëm kjo qendër, janë ndërtuar disa qendra të tjera, por shqetësimi çka është në ato parcelat që po bëhen ndërtimet tash nga komuna ose sipas hartës zonale, aty parashihet të bëhet një rregullore e detajuar për banim individual. Dhe nëse ne gjithë komunën që gjithë pronat që i ka komuna rreth rrugës i mbulojmë me ndërtesa të komunës, atëherë pronat të cilat janë private, mbrapa këtyre ndërtesave qysh kanë me lëviz prej aty. Do të bëhet mbyllja gjithçka. Unë mendoj që e para e punës do të ishte të bëhet një plan i detajuar rregullues i asaj zone dhe mandej të ndahen parcelat që i takojnë komunës apo veprimeve dhe investimeve të tjera. Viti i katërt është është, ka hyrë në fuqi harta zonale dhe për katër vite është dashur së paku një plan detaj të hartës zonale ta realizojmë, mirëpo ne po fillojmë me ndërtime dhe pa i respektuar pjesët e tjera se duhet të mendojmë pak më gjatë. Jo për të bllokuar një pjesë goxha të madhe të pronave private që janë mbrapa atyre objekteve që po ndërtohen tash nga komuna e Prizrenit. Prandaj edhe unë do të jem kundër nëse vazhdohet veç në këtë formë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Zotëri Hagjillari, fjalën ka.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Para neve është një vendim të cilët bëhet fjalë për një kategori me të vërtetë shumë e ndjeshme për qytetarët e komunës sonë. Derisa është shumë e ndjeshme edhe jemi para një akti ku në qoftë se nuk përkrahet i bie që ne nuk jemi në favor të atyre kushteve. Pavarësisht që edhe nga qeveria e Kosovës në Graçanicë po ndërtohet një objekt i madh për autikët e Republikës së Kosovës, po është qendër rezidenciale, por unë mendoj që edhe në komunën e Prizrenit, ka nevojë për një qendër për qëndrim ditor të personave të prekur me autizëm. Nga kjo rëndësi e cila është shumë e madhe dhe për nga këta persona dhe familjarët e tyre që me të vërtetë është, do të ishte një ndihmesë shumë e madhe. Lokacioni okej, për shkak që komuna nuk ka shumë prona, por edhe pozita ku është përcaktuar që të ndërtohet ky objekt, unë kam dilemat e mia, a do të përshtatet me veprimtarinë të cilat do ta bëjnë, pavarësisht unë nuk po dua me paragjyku se cila shoqat do ta merr, do ta përfitojë dhe do të menaxhojë me këto. Por që zakonisht nëpër të gjitha vendet perëndimore parcelat apo veprimtaritë ku zhvillohen këto janë jashtë qytetit, të cilët jo brenda qytetit, ku veprimtaria është shumë më e lehtë dhe ekspertat të cilët merren me këtë veprimtari, e kanë më të lehtë funksionimin me këta persona në fjalë. Këto janë dilemat e mia, por sido që të jetë, unë shpresoj që të mendohet edhe më mirë për këta persona, sepse edhe hapësira që është sa ari është aty, unë konsideroj që është goxha shumë e vogël.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, po Ilir Gashi fjalën.

Ilir Gashi (LVV): Kryetar, a është bërë ndonjë studim sa është e nevojshme një qendër e tillë dhe pse bash duhet nëse është e nevojshme, nëse është bërë një studim, dhe pse vazhdohet që një organizatë e shoqërisë civile ta menaxhojë një hapësirë të tillë? E kemi një përvojë të hidhur tash me këtë parcelën të qerdhja Yllka, që u nis si nevojë e komunës për një kuzhinë popullore dhe tash po përfundon si një pallat mbretëror me shumë kate, që përveç kuzhinës do të ketë edhe konvikt studentor, do të ketë edhe salla amfiteatër për aktivitete kulturore. Nëse një organizatë humanitare ka aq fuqi ekonomike me bë investime milionëshe. Pse na duhet me ja dhënë një parcelë komunale që zaten mo po na pakësohen parcelat dita ditës? Je shumë zemërgjer! Tash mos me të rikujtuar edhe parcelat të tjera që i ke dhuruar me çmime jashtëzakonisht shumë të ulëta. A po drejtor? Mu duk se po dëgjon me vëmendje. Pse nuk i ruan parcelat e komunës për nevoja të tjera, kryesisht

për ambiente të hapura. Nëse këto Ojq-të kanë aq shumë fuqi ekonomike, ne të blejnë një parcelë private edhe ne të ndërtojmë ashtu qysh dojnë. Bëhu i sinqertë, trego me cilën organizatë ke bërë marrëveshje dhe tash prapë do me i bë nder. Dhe ne t'i them atij, mbasi veç ke ndarë miliona buxhet, bleje edhe një parcelë 50.000, 60.000 euro dhe ndërto. Mos e harxho tokën e komunës. Kemi nevojë. Edhe ne tash, po edhe gjeneratat që vjen mbas nesh, mos t'i lejmë pa asgjë. Çdo kund ndërtesë po bëhet. Faleminderit për dëgjim.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): A ke në shitje ndonjë parcelë?

Ilir Gashi (LVV): Nuk kam as për vete.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotëri Levent Bush e ka fjalën?

Levent Bush(KDTP): Faleminderit. Tash unë s'po shoh asnjë problem që ose edhe me qenë Halil Kastrati, ose Leventi ose dikush tjetër që po don me bë një qendër e autizimit, për mua është shumë normale. Pse? Se sot për sot ne shumë i shumë mirë e dimë që nëpër klasa e kemi më mos me fol me një me një klasë të dy klasave një i kemi me autizim është. Kështu që këto duhet me marrë njëherë parim edhe e dyta çka është diçka një investim po bëhet në kuvendin e Prizrenit, tash qoftë se ky investimi nuk e pranon edhe meqënëse Halili ose unë si Leventi, ai investimi shkon ose Deçan ose një qytet tjetër. A për parcelën unë nuk e di, për vendin, a është i vendosur, a mundet me vendosur atë vend? A për projektin me dy duart e kisha thënë, kush është ai njeri që do me investu?

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese, parimisht ne jemi, domethënë do të përkrahim edhe me vota apo edhe nëse ka nevojë me moralisht në çdo aspekt. Arsyeja është që vetëm të kemi kujdes në aspektin ligjor, në aspektin juridik, si komun mos të bëjmë ndonjë gabim te çështja procedurale të dhënies së pronës për shfrytëzim për këtë çështje, për këtë situatë. Ndërsa nëse zbatojmë ligjet, nëse zbatojmë domethënë procedurat ligjore administrative, unë s'po e shoh të arsyeshme që mos të votohet kjo. Çështjen e ndërtesës e projektit, urbanizmi e ka ato kushtet, ato senet, aprovohet ligji edhe nuk ka problem edhe bëhet një qendër e mirë. Unë kisha bërë edhe tash edhe një kërkesë tjetër Bashkimit, se kemi qenë edhe kolegë më herët, jo vetëm për këtë çështje, por nëse ka komuna apo qytetarët nevojë edhe për çështje tjetër, për që ka nevojë. A e di, sa më shpejt të bëhet përgatitjet edhe të votojmë edhe çështje të tjera. Është mirë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Ertan, po Egzona fjalën e ka.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar. Deshta me u ndërlidh tek kjo pikë e rendit i ditës për shkak që vij vetë prej një përvojë goxha shumë gjatë sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale sidomos për komunitetin e aftësisë së kufizuar, tu i përfshi këtu edhe fëmijët me autizëm, qysh edhe ceki Leventi te çështja e procedurave, po besoj që gjithçka do të shkojë në parim me ligjin edhe do të jetë një procedurë e rregullt, po desha të ndërlidhem te rëndësia e madhe që është sa i përket që fëmijët me autizëm ose organizata e autizmit që vepron në komunën e Prizrenit me pas një hapësirë të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve. Ne e dimë që pothuajse shumica e organizatave të komunitetit të aftësisë së kufizuar që veprojnë në komunën e Prizrenit, kanë probleme për shkak të mungesës së hapësirave të përshtatshme. Kështu që nuk është në rregull që një komunitet ose komuniteti i aftësisë së kufizuar në përgjithësi me u përdor

në raste të në raste të tjera e mos me u përkrahë një projekt kaq i madh që ofron zgjidhje duke e ditur që numri i fëmijëve me autizëm është gjithmonë në rritje. Kështu që, edhe unë personalisht e mbështeti këtë, por edhe në emër të grupit të asamblistëve të PDK-së jemi pro. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zonja Ymran Fusha, pastaj edhe Selman Sokolaj.

Ymrane Fusha (PDK): Përshëndetje për të gjithë. Kryesuese, ne jemi me fat që e kemi në Halil Kastrati, që dëshiron të investon në Prizren. Edhe pse vetë kam qenë kryetar i shoqatës zejtare afarise të Prizrenit, edhe jam interesuar për shoqatën Autizmi që ekziston ende pak në Prizren për fëmijë të vegjël. Por mbas 18-ës, si e mbushin 18-vjeçarë fëmijët, nuk kanë ku të trajtohen ata fëmijët, edhe pse nëse shkojnë në privat, familjarët nuk kanë kushte të mbajnë se një trajtim kushton 20-30 euro, ndoshta një orë. E ku do të marrin ato pagesat ose mjetet për të trajtuar fëmijët e vetë, e fëmijët mbeten nëpër shtëpia. Po më vjen shumë keq që ata fëmijë që trajtohen deri në 18 vjet, të gjitha të arriturat, me psikologë e me pedagogë, ata mbeten nëpër shtëpia edhe s'kanë as ku të humbin kohën e lirë, as prindërit se janë në moshë, nuk mund të mirren me këta fëmijë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Fusha. Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, me sa jam në dijeni në një ankand publik nuk paragjykohet fituesi apo? Decidivisht po e cekni kush ka me marrë pronën. Me të vërtetë kjo është shqetësuese, është fenomen i tmerrshëm që po na ndodh neve. Edhe po të kishte organe që merren me këto keqpërdorime në emër të kategorive të ndryshme, që po donim me na moralizuar me kategori të ndryshme, secili prej neve ka edhe familjarë të këtyre kategorive. Edhe ju pa fije frike, pa fije turpi, po thoni që pronën komunale do ta merr filan fisteku. Seriozisht po ndihna ashtu i tmerruar me këtë guxim të juve, kaq hapur me i thënë gjërat. Është guxim i jashtëzakonshëm, ky kaq hapur me i thënë gjërat. Ka ndodhur edhe me pronën dikund 22 ari në qendër të Prizrenit për ta ndërtuar një kuzhinë. Aty kolegu Ilir më duket tha po përfundon pallat. Vetëm po jua rikujtoj sa ju jeni të interesuar për qytetarët, për shtresat në nevojë. Komuna e Podujevës po e ndërton një kuzhinë popullore që po kushton gjithsej 700.000 euro. Komuna e Podujevës me atë kuzhinë popullore që po i kushton 700.000 euro ka me ushqy nga fillimi i punës e në vijim, të gjithë nxënësit e komunës e Podujevës, të gjithë arsimtarët e komunës e Podujevës, të gjithë varfërit e komunës e Podujevës dhe çdo person që i mungon një shujtë ditore. Ndërtimi i asaj kuzhine po i kushton komunës 700.000 euro. Shaqir Totaj si kryetar i komunës e Prizrenit, PDK-ja si qeverisje në kuvend komunal, ka dhënë prona për kuzhina popullore, prona që kushtojnë miliona euro edhe në shfrytëzim afatgjatë. Ndërsa, po ta ndërtonte vetë do t'i kushtonte shumë më lirë edhe shumë kategori të tjera do t'i merrnin shërbimet. Tjetra, është një projekt i jashtëzakonshëm i qeverisë së Republikës së Kosovës në bashkëpunim me zyrën e OKB-së për banim. Banimi i përballueshëm dhe social. Disa e-mail, disa thirrje i ka Shaqir Totaj si kryetar i komunës e Prizrenit që të aplikoj në atë projekt. Ai projekt nëse zbatohet ka filluar të zbatohet edhe në komunat. ... Pronë komunale po japin për kategori në nevojë. Unë po të them që pronë komunale na ka kërkuar qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo është analizë. Po tërheqi një paralele. Mes asaj që ju po pretendoni, po na moralizoni neve, se ju po doni me na qit neve, që jemi kundër kësaj forme, si njerëz që nuk kemi ndjeshmëri ndaj një kategorie. E thashë qysh në fillim, që kjo s'është e vërtetë, kjo nuk është tema. Tema është, kryetari i komunës së Prizrenit, ka dhënë prona me çmime qesharake, ka dhënë

prona milionëshe, kinse për këto kategori, ndërsa ka një kërkesë shumë të thjeshtë, i duhet një parcelë, ku mundet me e ndërtu, aty mundet me përfituar, qiftet e reja, ata që kanë probleme me banim, edhe rregullimin, meremetimin, renovimin e çdo shtëpie, në komunën e Prizrenit, në çdo lagje e në çdo fshat, më i skajshëm që është, përmes atij projekti përfitojnë qytetarët e komunës së Prizrenit, të gjitha kategoritë hyjnë aty bashkë. Çka i duhet qeverisë së Republikës së Kosovës, që në këtë rast Shaqir Totaj po është dorë lirë, i duhet vetëm një parcelë që me ja dhanë një shfrytëzim. Pse nuk po ka parcela për atë kërkesë që i përfshin të gjitha, jo një nga një? Po po ka parcela mjaftueshme me dhënë me çmime qesharake edhe për kësi raste tek a tek të caktuara. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër? Po Dafina Alshani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. Singerisht ky keqpërdorim kështu i çështjeve apo trajtimi i çështjeve që po ngriten nga opozita me i marrë si të atakuara për grupet senzitive që janë, domethënë ne reagojmë për dhënien shfrytëzim, mënyrën e dhënies, ne reagojmë për mbrojtjen e pronave komunale dhe e ftojmë komunën që t'i bëj punët e veta vet, jo me OJQ, jo me biznese dhe ne akuzohemi që jemi kundër bizneseve, jemi kundër OJQ-ve, jemi kundër personave me autizëm. Unë nuk po e kuptoj këtë. Pse po na moralizoni kështu? Për çështjet e mirëqenies sociale, kjo qeverisje ka treguar veten 4 vite. Po më vjen keq që ka pasur shumë drejtori që janë ndërruar drejtoresha, drejtora, se hera e parë kemi drejtoreshë, po mirëqenien sociale ka dështuar Shaqir Totaj me qeverisjen e vet. Ne e kemi hala kategori tepër të ndjeshëm që hala nuk i kanë marrë as banimin e tyre. Keni bërë edhe marrëveshje edhe para kësaj PDK-ja, ka ditur me bë manevrime me raste sociale, edhe ne tash po kemi dyshime sepse çdo pronë që po ipet, po ipet me prapavi. Për besë! Këtu flet zyrtari për thirrje publike, këndej pozita thotë e kanë emrin edhe mbiemrin. Edhe e falenderojnë që ka vendos me investu. Kënd po e gënjeni ju? Mos i bëni thirrjet publike. Dilni, kryeni procedurat qysh i dini ju vetë edhe mos na vëni lajthitje një legjislativ të tërë. A keni koordinim ju mes vetë? A është thirrje publike, a është kurdisje? Pse po na shtini në gjynah me fëmijët me autizëm? Pazaret e juaja po na dëmtojnë neve ose neve po na atakojnë. Jo bre! Nëse keni gjetur edhe në qafë të këtyre fëmijëve me bë marrëveshje të mshefta, vallahi Zoti ju sheh. Edhe qytetari ju sheh. Pse nuk dilni si komunë me thënë nuk jemi të aftë me bë këtë gjë? Ku ka pare, bëni ndërmarrje publike, ku ka hisedar, huxhum bëni ndërmarrje publike me bë, siç e keni bë stacionin e autobusave, se keni përgjegjës aty, keni aty kush troket. A këtu e akuzoni opozitën se gjoja se ne jemi kundër këtyre kategorive. Është për të ardhur keq edhe mos luani me këta fëmijë, mos luani me këtë kategori, ne jemi në hall me votu apo mos me votu sepse kemi dyshime. Edhe ju i dini shumë mirë çfarë dyshime i kemi pasur, i kemi shprehur në KPF, po me kësi akuza të ulëta mosni, ju lutem.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Dafina. Atëherë zotëri Gursel ka e ka kërkuar fjalën për disa sqarime që u ngritën këtu.

Gursel Skënderi (Zyrtar): Faleminderit kryesuese, unë deshta me i përgjigjur vetëm zotit Islam Thaçi. Ishte pyetja pse domethënë aty në propozim vendim është çka do t'ju jepet vetëm organizatave të komunës së Prizrenit. Neni 16 i rregullores përcakton mënyrën e dhënies së pronës publike për organizatat të shoqërisë civile. Kurse paragrafi i 3 theksohet, po e theksoj, procedurat e konkurimit bëhet vetëm për organizatat e shoqërisë civile atje cilat veprojnë në territorin e

komunës përkatëse. Për ç'atë qëllim është bërë propozimi. Domethënë vetëm për këtë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Gursel. Edhe drejtoresha e ka kërkuar fjalën. Po drejtoreshë urdhëro.

Shpresa Murati (D. Mirqenies Sociale): 2:20:10 – 2:21:45

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Atëherë jemi në procedurë të votimit. Zotëri Hodaj fjalën përpara, mandej Selmani.

Haziz Hodaj (LDK): Nuk mora përgjigje. Tash pasi e mora fjalën edhe po e shfrytëzoj rast se nuk do nuk u deklarova as për votë as për.. singerisht duhet të koordinoheni pak edhe ju ekzekutivi me me anëtarët e kuvendit dhe mos me dal me ra në grack gjithë ai angazhim gjithë ajo punë tash me ra në grack se është paracaktuar një organizatë joqeveritare ne nuk jemi kundër asnjë organizatë joqeveritare. Dhe i përkulemi edhe për punën, edhe për angazhimin, edhe për humanitetin që kanë shpreh. Unë vetë kam kërkuar këtu me e shpall qytetarët nderi Halil Kastratin. Unë kam propozuar edhe është shpallur qytetarë nderi i Prizrenit. Për punën që ka bërë, për angazhimin, për strehimin e njerëzve e të tjera e të tjera. Mirëpo me u paracaktu, me u ditë se kush ka me e marrë këtë parcelë, kjo nuk është në rregull. Andaj është mirë të koordinoheni edhe në qëndrimet e juaja, edhe edhe në paraqitjet publike, sepse po na qitni në pozita jashtëzakonisht të palakmueshme. Kështu që, për shkak të ndjeshmërisë, ne do të votojmë pro dhënies kësaj parcele në shfrytëzim, po shpresojmë që procedurat kanë me u zhvilluar qysh duhet, por nuk do të jemi pjesë e komisionit. Megjithëse ju paralajmërova që unë jam i propozuar për anëtar të komisionit, unë do nuk do të jem anëtar i këtij komisioni për vlerësim. Kështu që, për shkak të ndjeshmërisë, për shkak të situatës dhe për për kategorinë të cilën po flitet, sigurisht që nuk e kemi atë guxim, nuk e kemi fuqinë që të kundërshtojmë. Kemi me votuar. Mirëpo kini kujdes në procedura dhe kini kujdes në paraqitjet publike. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po po zotëri Rakaj fjalën e ka ndoshta i merrni përgjigjet.

Bashkim Rakaj (Zyrtar): Ju kërkoj shumë ndjesë. Reagimet politike unë nuk mund me i kuptu edhe kur vijnë në forma të ndryshme unë i marr shumë nga të zemrës, sepse unë jam shërbyes civil në radhë të parë dhe jam punëtor social profesionist. T'i jap disa përgjigje, pastaj kam me bë një konstatim në mirëkuptimin tuaj. Haziz, nuk është shumë shumë e madhe për me ndërtuar shteti, por që kërkon kohë të gjatë dhe procedurat e licencimit janë të vështira. Përveç procedurat e licencimit edhe punonjësit që kanë me punu' i trajtojnë fëmijët autik, kanë shumë vështirë me u punësu' në shtet. Duke marrë parasysh shumë faktorë. Prandaj është e mirë një bashkëpunim me një organizatë serioze joqeveritare ndërtimin e e dhe funksionalizimin e qendrës. Pyetjes së Petritit. Petrit, Drejtorja për Punë dhe Mirëqenie Sociale ofron shërbim për 47 raste. Po kjo nuk do të thotë që është numri i saktë, sepse ka edhe raste të tjera që nuk dojnë me marrë shërbime në komunën të Prizrenit. Duke vlerësuar analizat e shumta, nevoja në rritje është imediate për ndërtimin e kësaj. U bënë do konstatime politike që unë s'jam idenë me ju dhënë përgjigje edhe nuk di se si me ju dhënë politikisht përgjigje. Edhe do pyetje shumë profesionale te çështja e pronës që nuk di me ju dhënë, vetëm një gjë di me ju garantuar për para kryetarit të komunës, qytetarëve, mediave që nuk

është i kurdisur. Unë ju garantoj moralisht edhe penalisht. Qysh doni, filloni hetimin kur doni. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Selmani, nëse ka, nëse nuk e mori përgjigjen.

Selman Sokolaj (LVV): Po gjysmën, unë e pata një pyetje se... Pasi është çështja e ndjeshme, sensitive, drejtorja komunale e arsimit do duhej të ishte e përfshirë këtu, ta merrnim një, ju si komision, a keni diskutuar me drejtorinë komunale të arsimit? Kurrikula e shtetit të Kosovës, çfarë ofron për këta persona? Çfarë mundet me të drejtorja diçka shtesë përtej jush? Edhe prap po dalim aty, domethënë shteti paska mundësi me ofru shërbim për kategori të tilla. Këtu veç po mungon vullneti politik i qeverisë, domethënë po më dhembë këmba hiqe krejt. Domethënë shteti ka mundësi me i drejtu, ta përfundoj tani më jap përgjigjen nëse. Ju thatë që shteti në bazë të legjislacionit pozitiv ka mundësi me i drejtuar personat të tillë ashtu siç konstatoam më herët që shteti ka mundësi me ndërtu edhe kuzhina popullore edhe banim përballueshëm dhe social. Mirëpo këtu në bazë të fjalës juaj unë po konstatoj që mungon vullneti politik. Se gjërat që bëhen shumë seriozisht edhe që janë të rëndësishme marrin kohë. Hyri edhe drejtoresha edhe njëherë kryesuese ndoshta nuk bëhet... A i keni menduar ndërinstitucionalisht këtë propozim? Çka ofron kurrikula arsimore e shtetit të Kosovës për këta fëmijë deri në një moshë, kur këta janë në shkollim, ose për shkollim, a ofron shteti ose kurrikula e institucioneve arsimore shërbime për këta? Edhe a i keni menduar, pasi tha që është vështirë, opsionin që vetë shteti, në këtë rast komuna, me ofru këtë shërbim, që do të ishte shumë më stabil, edhe nuk do të jepte mundësinë me u inkurporu tani organizata që fillojnë me ndërtu kuzhinë, po aty dalin salla të mbledhjeve, kuzhina dhe salla mbledhjeve sallë e seminareve është dallim i madh. Ne po e kemi rastin, e kemi rastin që ka ndodhur në këtë qeverisje nuk kemi tu shpik gjë. E kemi dhënë një pronë për kuzhina popullore që mundemi me ndërtu, vetë prona milionëshe aty po flitet që po dalin salla seminarësh. Kjo ishte faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Ertan të lutem edhe ti pastaj Bashkimi do të ketë përgjigje.

Ertan Simitçi (Ythp): Po vetëm pata edhe një pyetje procedurale si para përfundimit të mandatit si kuvend. A kemi të drejtë me dhënë dhënien në shfrytëzim pronat apo jo?

Bashkim Rakaj (Zyrtar): I nderuar Ertan, kjo s'është pyetje për mua se s'di me dhënë përgjigje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po që zotin Gurseli e kemi ose nënkryetari.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po Ertan, ke të drejtë, domethënë gjashtë muaj para zgjedhjeve pronat nuk mundën me u dhënë shfrytëzim. Megjithatë ne nuk kemi për momentin datë të zgjedhjeve. Nëse eventualisht ajo ndodh ditën në vazhdim, çdo procedurë pezullohet. Domethënë kështu e parashe ligji, por ne nuk mund me paragjyku sepse s'kemi datë. Na vazhdojmë procedurën, nëse nesër vendoset për datën, aty kjo procedurë përfundon.

Selman Sokolaj (LVV): A bën Gurseli me ndërhyrë këtu një minutë kryesuese? Ne ne veç nuk e kemi datën fikse, ne e dimë që kemi zgjedhje edhe zgjedhjet janë të përcaktuara me kushtetutë. Kështu që, mandati i Kuvendit Komunal është katërvjeçar. Nuk është mandati i Kuvendit Komunal i pacaktuar që neve na duhet një dekret i presidencës që gjashtë muajt e fundit mos me marrë masa me dhënë prona komunale. Mandati është katërvjeçar. Po të ishte mandati i pacaktuar atëherë...

Gursel Skënderi (Zyrtar): Selman, neni 33 i rregullores. Kuvendi i komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim dhe të gjitha procedurat të cilat zhvillohen lidhur me dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, pezullohen nga dita kur presidenti shpall zgjedhjet, nga dita kur presidenti shpall zgjedhjet lokale deri në konstituimin e organeve të komunës. Po nga dita kur presidenti.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit. Po zotëri Muçaj hajde të lutem edhe po kalojmë në proces të votimit.

Agim Muçaj (AAK): Rreth kësaj pike sigurisht se unë mendoj që nuk kemi çka me diskutuar se ne me të vërtetë e dimë që mbas 20 tetor java e fundit apo 10 ditësh e fundit kemi me pasur zgjedhje. Kjo punë është mëse e ditur. Unë mendoj që rreth kësaj pike jemi ka të diskutojmë kot sepse e dimë sigurt që ka me u pezulluar. Kështu që nuk mendoj që duhet me humbur kohë rreth kësaj çështje, pasi që e dimë që ka me u kthyer prapë, sikurse e ceku dhe nënkryetari.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. T'u kisha lutur mikrofonin. Sa jemi prezent? 29të jemi prezentë, po e qes këtë pikë në votim. Kush është për që të miratohet kjo pikë? Ju lutem t'i mbani duart derisa t'i numërojmë. 26 jemi për, 0 Kundër, 0 Abstenim. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju faleminderit. Po kalojmë edhe te komisioni.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit vlerësues.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Meqë janë edhe pika të ndërlidhura meqë janë edhe shkojmë mandej në pauzë. Siç e dini, ky komision prej pesë anëtarëve, si zakonisht prej dy anëtarëve të kuvendit, dy i kemi nga ekzekutivi edhe njëra nga shoqëria civile. Po shkojmë si zakonishtme propozime një nga pozitat dhe një nga opozita. Lus nga pozitat që ta bëjnë propozimin, kush do të jetë anëtar i këtij komisioni? Kush do ta merr fjalën?

Alban Bislimaj (PDK): Ne grupi i Partisë Demokratike e propozojmë Egzona Hoxha të jetë anëtare e komisionit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Egzona Hoxha, faleminderit. Nga opozita a kemi propozim? Ose ndonjë anëtar?

Karanfil Haxhillari (LVV): Unë e propozoj Ilir Gashni.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit shumë. Atëherë nga ekzekutivi i kemi drejtoreshat Ramize Sinanaj edhe Shpresa Murati, ndërsa nga OJQ të kemi të propozuar zotin Latif Hoxhaj, psikolog klinik, nga shoqata kosovare për psikoterapi dhe psikodiagnostik. Domethënë këto janë pesë emra, dy nga kuvendi, dy nga ekzekutivi edhe njëherë nga OJQ. Përbërjen prej këtyre pesë anëtarëve po e hedh në votim. Kush është për që të formohet ky komision? 31 jemi prezent. Ju lutem jemi në proces të votimit. Sa jemi për? 24 jemi për, 1 kundër, 3 abstenim. Atëherë miratohet edhe pika e komisionit që është pika 5, ju falenderoj të gjithëve. A jeni të pajtimit meqë s'kemi as

shumë pika me vazhdu? Apo vazhdojmë? Apo vazhdojmë edhe mandej e përfundojmë krejt edhe shkojmë? Atëherë deri në ora 2:00 kemi pushim. Ju lutem të ktheheni në ora 2:00.

PAS PAUZE

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovicë;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar anëtarë të Kuvendit, përshëndetje edhe njëherë. Mirë se jeni kthyer në pjesën tjetër të seancës. Jemi te pika e gjashtë, kemi mbetur shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovic. Prezent jemi 24 anëtar, kështu që mundemi me vazhdu me pikat të cilat na kanë mbetur. Po, ftojme anëtarin i cili ka me bë prezantimin këtu, anëtarin prej kompanisë.

Anëtari i Kompanisë: E nderuara kryesuese. Të nderuar drejtor, të nderuar asamblistë, më lejoni që në cilësinë e konsulentit i cili ka asistuar ekipin i cili është krijuar nga komuna e Prizrenit për përgatitjen e draft rregullores për varrim dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovic. Kjo ky dokument apo kjo rregullore pra është një draft rregullore e komunës që ka të bëjë me mbulon procesin e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në fshatin Landovic. Në përgjithësi rregullorja synon të sigurojë një infrastrukturë të qëndrueshme të varrezave, të ofrojë shërbime cilësore të varrimit dhe të mirëmbajtjes, të mbrojë mjedisit dhe të ofrojë mbështetje shtesë për qytetarët të cilat komuna do t'i bëjë në pikat më tutjeshme, përfshirë edhe ceremoni të nevojshme. Objektivat kryesore të kësaj rregullore janë menaxhimi efikas i varrezave, duke përcaktuar dhe detyrimet e të dy palëve, pra dhe të komunës edhe të partnerit privat apo të koncesionarit. Transparenca dhe me mbledhjen e tarifave përmes një, përmes krijimit të një sistemi të qartë se si do të përcaktohen këto tarifa dhe përgjegjësi të tjera, si dhe respektimin e ligjeve dhe standardeve të zbatueshme, harmonizimi me rregullat të cilat janë të aplikueshme në këtë rast, po po ashtu edhe me rregullat dhe standardet e përcaktuara përmes kontratës së koncesionit e cila është e nënshkruar për këtë projekt. Rregullorja siç thamë edhe më herët, ka dy palë kryesore, pra zbatim si nga njëra anë nga komuna e Prizrenit, e cila ka, përveç të tjerave, edhe përgjegjësinë për miratimin e kësaj rregullore. Mbikëqyrjen dhe zbatimin dhe inspektimin e aktiviteteve që i kryen partneri privat. Po ashtu edhe nga ana tjetër kemi koncesionarin apo partnerin privat, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e përditshme të varrezave, sigurimin e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve të nevojshme sipas dinamikës së paraparëve në kontratë. Dokumenti më tutje detajon dispozitat në disa krerë kryesorë, i keni do thotë aty edhe në dokumente dhe nëntë për nëntë të përcaktuara, ku në sipas krerëve kemi dispozitat e përgjithshme, pronësinë dhe përgjegjësitë e palëve, pra që mbetet gjithmonë si pronë e komunës. Organizimin e hapësirës së varrezave, pra dimensionet e deri te plani urbanistik i varrezave, pastaj praktikat dhe procedurat e varrimit, sjelljen dhe masat, sjelljen në varrezat dhe masat ndaj shkelësve, tarifat dhe arkëtimit të ardhurave, duke përcaktuar edhe mënyrën se si përcaktohen këto tarifa dhe si ndryshohen kurdo që ka nevojë, si dhe standardet e mirëmbajtjes dhe inspektimin, pra përcaktohen edhe palët të cilat do t'i kryejnë këto shërbime dhe inspektimin.

Në fund, sipas kërkesave pra edhe të udhëzimit administrativ përkatës për rregullore të këtij lloji, është dhe zbatimit dhe dispozitat përfundimtare. Më lejoni që të ketë në fund të përmendi që kjo rregullore pra bazohet përveç në ligjin për vetqeverisjen lokale dhe nenet përkatëse aty që lejojnë komunës që të hyjnë që të përgatisë kësi lloj të rregulloreve, po ashtu edhe marrëveshjen e koncesionit ku janë të përcaktuara pra obligimet dhe përgjegjësitë e të dy palëve edhe plotësimin e kushteve dhe para kushteve nga të dy palëve në mënyrë që ky projekt të mund të fillojë të implementohet. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Atëherë, po mundeni me u ul edhe me i prit, nëse kanë ndonjë pyetje ose sqarim nga anëtarët e Kuvendit. Atëherë, po e hap diskutimin për këtë pikë. Kush dëshiron me e marrë fjalën? Po, Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese, të nderuar kolegë kuvendar, të dashur qytetarë të Prizrenit. Sot na vjen përpara një rregullore me titullin rregullore për varrim dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja në fshatin Landovic. Me kujdes të shtuar e kam lexuar këtë rregullore dhe kjo rregullore 90% është rregullore për koncesionarin sesa vetë titulli i rregullores që është për varrim dhe mirëmbajtje. Neve në komunën e Prizrenit të gjithë jemi dëshmitarë që ka kohë që ceremonia e varrimit mbulohet me subvencionin nga komuna dhe kjo kryhet është një akt human që është bërë dhe kjo ceremoni e varrimit për të gjithë qytetarët para e komunës, që sa kohë është bërë pa pagesë. Sot neve na vjen një rregullore ku qytetarët e komunës së Prizrenit, apo më saktë qytetarët në qytetin e Prizrenit, do të obligohen dhe do të kthehen në vitin qysh para 2017, ku do të obligohen të paguajnë ceremoninë e varrimit. Kurse në anën tjetër, në fshatrat e komunës së Prizrenit, do të vazhdojë ajo që ceremonia e varrimit do të jetë pa pagesë nga Ekoregjioni dhe bashkësia Islame, sepse do ta subvencionojë komuna. Automatikisht përmes kësaj rregullore do të do ta kemi një ndasi në mes të qytetarëve që jetojnë në qytet dhe atyre të cilët jetojnë në fshatra. Në qoftë se ja hedhim një sy rregullores, neve të gjitha rregulloret të cilat i kemi kaluar në këtë kuvend, aty për shembull rregullorja për tatimet në pronë, rregullorja për shumë çështje të tjera, përcaktohen edhe tarifatat dhe gjenden edhe çmimet. Kurse në këtë rregullore, kjo mbetet nën diskrecionin e konsicionarit. Po i referohem nenit 6.3 të kësaj rregullore, e cila thotë, mbledhja e tarifave dhe arkëtimit. Thotë, koncesionari ka të drejtë të mbledhë tarifatat për shërbimet e varrimit dhe shërbimet e tjera shtesë. Por në qoftë se kësaj ja shtojmë edhe tjetrën që është neni 7, pika e 3, paragrafi i 2, thotë parcela private të familjeve. Nëse ndonjë familje ka të drejtë e një parcelë familjare brenda varrezave publike. Ajo do të evidentohet si e tillë, por do t'i nënshtrohet rregullave të kësaj rregulloreje, por që në këto rregulla të kësaj rregullore nuk pashë ndonjë rregull për familje. Tash shtrohet një pyetje shumë e thjeshtë dhe legjitime. Ajo pronë është pronë e komunës. Dhe nga koncesionari që i bjen që do t'ju shitet familjeve. Pra për rezervimin e varrezave të familjeve. Gjëja që bien në kundërshtim me aktet normative sepse nuk mund të shitet prona komunale për familjarë. Kjo aludohet. Në qoftë se shkojmë te nen i 7 pika e 3, sepse po e bëj lidhshmërinë në bazë të neneve. Thotë parcela private të familjeve. Në Komunën e Prizrenit deri tash ceremoninë e varrimit e ka kryer ndërmarrja publike ekoregjioni. Së bashku me bashkësinë Islame ku komuna e ka marrëveshjen e cila ende është në fuqi, ku çdo ceremoni e varrimit të kryhet nga këto dy njëra shoqatë joqeveritare bashkësia Islame dhe tjetra është ndërmarrja publike Ekoregjioni. Pse duhet që të kemi koncesionarë derisa deri tani ndërmarrja publike edhe unë çuditë edhe nga anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve qysh nuk reagojnë për këtë çështje. Sepse një punë shumë e

rëndësishme kësaj ndërmarrje po i kalohet një kompanie private. Nuk po dua të aludoj, në qoftë se ajo kompani private ka punuar paraprakisht në vitet e mëhershme në atë parcelë, komuna mund t'ia paguaj punën e saj që e ka bërë dhe të vazhdohet me ata të cilët si komunë qysh nga 2017 e kemi bërë që ceremonia e varrimit të kryhet me subvencione dhe falas. Duke i pasur parasysh që qytetari i komunës së Prizrenit goxha shumë ballafaqohet me sidomos në këto momente mortore me shumë pengesa e sidomos financiare. Në qoftë se kalojmë në tanësi, kjo bie ndesh, pra, po i përmendi edhe njëherë, ndasi në mes të qytetarëve, nën dy, eliminohet një ndërmarrje publike, duke ja ndaluar një punë dhe i ipet një biznesi, dy. Edhe nën tre unë nuk e di që, sipas informatave të cilat i kam nga, bashkësitë fetare nuk ka pajtueshmëri të plotë. Dhe tjetra, po dua me e saktësu, unë nuk jam kundër hapësirës së re të varrimit apo varrezave të reja. Por jam kundër formës dhe kundër pagesës që do të jetë një goditje shtesë ndaj qytetarëve dhe të cilët edhe kjo rregullore në bazë të gjithë kësaj të cilën e kam parë, kjo vetëm rregullore nuk është, kjo është rregullore për koncesionarin, por nuk është për ceremoninë e varrimit. Unë e kuptoj edhe larishmëri të cilët janë bërë këtu në këtë rregullore, por që këtu me shumë punë derisa ndërmarrja publike Ekoregjioni po arrin me i bërë sheshet me lule dhe rrugët e qytetit të Prizrenit, besoj që do të di të kujdeset edhe për edhe për këtë hapësirë. Sepse kjo të jep me kuptu, thotë, neni 17.1 thotë, tarifat për shërbimet bazë të varrimit dhe mirëmbajtjes përcaktohen nga koncesionari në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës së koncesionit. Po ashtu neni 17.2 kategoritë e tarifave përfshin tarifat për shërbim bazë si hapësirat për varrimin individual ose familjar pra edhe këtu nuk i kemi të përcaktuar neve në qoftë se domi me pas një rend të mirëfilltë të varrezave dhe mos të krijohet një kaos i varrezave sikur në hapësirën paraprake që e kemi, atëherë nëqoftëse fillojmë ne me ndarje familjare me shit pronë komunale, familjeve të ndryshme, që nuk rregullohen po ashtu qysh duhet në këtë rregullore, atëherë nuk kemi arritur asgjë këtu. Edhe sidomos edhe këtu pika e dytë që thotë rezervimet e varreve. Njëherë e përgjithmonë duhet ta kemi një rregullore të qartë dhe të ketë një rend, një rregull edhe të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit të jenë të barabartë. Unë jam kategorikisht kundër kësaj rregullore.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit dikush tjetër? Kush dëshiron me e marrë fjalën? Po nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune): Faleminderit kryesuese. Edhe njëherë po ju përsëndes të gjithëve anëtarëve të Kuvendit. Një pjesë që e pasqyroj prej rregullores Karanfil si shqetësim ndoshta dhe e ka të drejtë. Po ta kemi parasysh tash kemi pasur këtë javë dy takime me akterë të ndryshëm, përfshirë këtu edhe Bashkësinë Islame, domethënë njëri takim është mbajtur në 26 maj në ora 11:00 edhe tjetri në 27 maj në ora 14:00. Edhe në bazë të këtyre takimeve, ku e kemi pasur edhe operatorin, edhe Ekoregjionin, edhe INC-in si konsulent për këtë rregullore, jemi pajtuar për disa ndryshime të cilat duhet t'i përfshijnë në këtë rregullore si propozime ndash të Bashkësisë Islame, por ndash edhe të takimeve tona të përbashkëta me të cilat jemi pajtuar. E para, për me pasur parasysh pagesën e ka me bërë komuna dhe vazhdon ashtu siç ka qenë, por tash këtu i kemi dy çështje. E para, dikush tjetër e kryen procedurën e varrimit, ndërkohë Bashkësia Islame i kryen ritet fetare. Domethënë kjo pjesë do të ndahet në dy. Një shërbim financiar ka me u bërë për bashkësinë Islame me një formë të re, ndërkohë një pjesë do t'i bëhet natyrisht atij që e kryen punën teknike rreth hapjes së varrit e procedurat të tjera. Megjithatë unë duhet me lexu për shkak se janë propozime dhe duhet me u përfshirë në rregullore. E po ashtu natyrisht që kryesueses pastaj do t'ia

dorëzohet edhe të shkruar. Te pika e parë, sepse Bashkësia Islame i ka bërë, diku 11 pika si propozime, me të cilat kemi pajtuar shumicën prej tyre, ndërkohë të tjera i kemi harmonizuar bashkërisht. Te pika e parë, koncesionari dhe komuna do t'i bashkërendojnë ngushtë me Bashkësitë Fetare në organizimin e varrimit, duke garantuar qasjen e tyre në ceremonitë fetare, këtu përfshihen edhe komunitetet tjera fetare. Edhe si propozim për me përfshirë në rregullore është të koordinohen me përfaqësues të autorizuar të bashkësive fetare. Domethënë si pikë shtesë të vërejtja e tyre e parë. Te e dyta, domethënë e dini që ka pasur një praktikë aktuale të organizimit të varrimit nga bashkësitë fetare edhe aty do ta përfshijmë kësaj, të ruhet rendi, të kurseth koha e qytetarëve dhe të sigurohet kryerja e riteve fetare pa pengesa financiare. Domethënë që nënkupton se obligimet për këto siguri që i merr komuna e Prizrenit. Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me bashkësitë fetare dhe kompaninë Ekoregjioni mbulon të gjitha shpenzimet e varrimit dhe ofron shërbime mortore për qytetarët. Te vërejtja tre të përcaktimi i tarifave kjo rregullohet me një akt tjetër të veçantë të ekzekutivit komunal përkatësisht kryetarit të komunës për shkak se subvencionet menaxhohen prej zyrtarëve të kryetarit dhe shpërndahen pastaj nëpër drejtorin dhe ju e dini që kjo është ndihmë për qytetarët dhe duhet me mbulu nga kategoria e subvencioneve. Duke qenë se shpenzimet nuk janë pjesë e kontratës së koncesionit, kjo rregullore nuk mund t'i përmbajë informata dhe specifika për tarifa. Aktualisht shkruan kështu. Këto mund të përcaktohen nëpërmjet palëve respektive. Komuna e Prizrenit dhe bashkësitë fetare respektive me vendim të kryetarit e rregullojnë pra çështjen e mbulimit të shpenzimeve të varrimit. Ka qenë edhe një vërejtje ose si sugjerim për ndarjen e hapësirave të varrezave sipas bashkësive fetare. Kjo është në hartën e projektit, domethënë secili komunitet e ka pjesën e vet se ku do të varrosen muslimanët me një pjesë, katolikët me një pjesë, ortodoksët me një pjesë edhe komunitetet eventuale të tjera nëpër pjesë të tjera, domethënë po kjo është e përcaktuar në hartën të cilën e përmban edhe kontrata. Ndarja sipas bashkësive fetare do të bëhet në përpjesëtim me nevojat dhe përbërjen demografike. Domethënë ky do të jetë si propozim me u përfshirë në rregullore. Te pika pesë, specifikimi në rregulloren e skemës së terrenit, pra vendndodhja e varrezave muslimane, katolike, ortodokse sipas hartës së projektit, të cilën veç e përmenda. Sa i përket kësaj pjese që e përmendi edhe Karanfilin, te pjesa e rezervimit ose blerjes, edhe ne mendojmë edhe bashkësia islame po edhe se të gjithë ju, që duhet me pas një rregull dhe varrimet bëhen me renditje, por jo me rezervime ashtu siç ka qenë edhe aktualisht problem në varrezat aktuale. Pra të ndalohet kategorik që qytetarët me i rezervuar hapësirat për varrim. Ë, po ashtu jemi pajtuar që të reduktohet lajmërimi i varrimit nga dhjet orë në pesë orë sepse ka raste ku një qytetar që vdes në orët e hershme të mëngjesit të kryhet mundësia e ceremonisë të varrimit gjatë ditës dhe jo të pritët për një periudhë tjetër. Ndërkohë në rregullore e kemi pasur dhjet orë që na është dukur edhe neve se është kohë shumë e madhe. Edhe ajo natyrisht që eliminohet se vetë fakti që e përcaktojmë lajmërimin pesë orë më herët, nënkupton që të gjitha të tjerat të bien poshtë. Si propozim është koncesionari duhet të lajmërohet së paku dhjetë orë para kohës së planifikuar të varrimit, përveç nëse ndryshe përcaktohet me rregulloren e bashkësive fetare. Kurse ajo pjesa dhjet orë eliminohet. Është diskutuar dhe ajo çështja e lajmërimit se kush kë e lajmëron kur të vdes, ne e kemi pasur praktikë edhe traditë që qytetarët me lajmëruar imamin e fshatit, të lagjes, ku jeton, ose në raste të tjera të komuniteteve të tjera fetare prisnin fetarë të lokalitetit të caktuar. Nëse ata eventualisht nuk e kanë ndryshe me rregullore të tyre të brendshme. Është propozuar të ketë një zyrë të koordinimit, të varrimit brenda komunës dhe kjo mund të bëhet, por megjithatë në fund kemi arritur në përfundim që këto duhet të lajmërohen përmes udhëheqësve

fetar. Po ashtu si propozim e kemi të përfshihet në rregullore njohja e rolit të bashkësisë fetare edhe Bashkësisë Islame, më konkretisht sepse propozimi është i tyre, si kontakt për varrimin e komunitetit islam, ajo që e thashë, që e thashë deri tash. Po ashtu, është diskutuar dhe është kërkuar që të ketë edhe hapësira për ritet fetare brenda, përkatësisht në ndërtim të objekteve fetare dhe siç dihet edhe me hartë të varrezave është përfshimë një pjesë prej 1200 m², ku aty mund të kryhen ritet fetare për komunitetet fetare dhe po besoj që këto janë pikat me të cilat edhe ne i kemi pasur si vërejtje edhe jemi dakorduar në takimet të cilat i kemi pasur me akterët të cilët e kanë trajtuar këtë rregullore. Dhe si e tillë, dokumentin që ju e keni përpara është, ka ardhur nga një konsulencë edhe nga një grup punues që ata e kanë bërë edhe e kanë trajtuar në kuptimin juridik edhe në kuptimin e dhënies së kontributit të ekspertëve. Ndërkohë, kjo që po e përfshijmë sot janë shqetësimet tona të përbashkëta edhe të juajt po besoj sepse një pjesë u thanë, po edhe të aktorëve të tjerëve që kanë qenë të përfshirë. Ndërkohë po e ripërsëris që me një akt tjetër të kryetarit të komunës ose edhe të kuvendit të komunës, do të rregullohet çështja e mbulimit të varrimit ashtu siç e kemi pasur deri tash, për shkak se kjo rregullore nuk e ka në domen trajtimin e pjesës së subvencioneve, por kryesisht është dokument teknik që e rregullon çështjen e hapësirës së varrezave. Besoj që pika të shkurta u mundova me e përmbledh. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit nënkryetar. Atëherë meqë fjalën e patë shefi i Lëvizjes Vetëvendosje, në qoftë se vetëm keni me shtuar diçka, po shkoj me prononcime, po merrni fjalën përsëri. Edhe po shkoj me shefat e grupeve njëherë, pastaj edhe anëtarë të tjerë.

Karanfil Haxhillari (LVV): Nënkryetar, në bazë të kësaj që e thotë, atëherë kjo rregullore po pësojka ndryshime thelbësore dhe shumë të mëdha, që i bjen që ne nuk mundemi me e votu sot këtë rregullore. Sepse në nëqoftëse votohet sot që kjo rregullore shkon pa këto ndryshime të cilat i përmende. Edhe tjetra ju e thatë komuna i bën pagesën e ceremonisë së varrimit. Por që kërkund nuk e kemi në këtë rregullore. Dhe unë konsideroj që të përmirësohet kjo rregullore, le të vendosen edhe këto ndryshime të tjera dhe pasi të vendosen këto, atëherë edhe mund të diskutojmë. Por unë prapë mendoj që në këtë formë, kjo rregullore po na kthen prapë po e përsëris në 2017-ën, duke e ditur shumica kush ka qenë këtu kuvendar në vitet e mëhershme, se çfarë është punë e madhe është bërë që t'i ndihmohet qytetarëve të Prizrenit për subvencionim të ceremonisë të varrimit dhe tash të rikthehemi prapë tek, nga një çështje humane prapë të bëhet çështje biznesore, për neve është e papranueshme.

Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune): Nëse e bën edhe 20 sekonda në formë replike. Rregullorja nuk ka nevojë me u kthi pas për shkak se dokumenti në thelb është ai që e keni. Ndryshimet i përmenda, përfshirjen e neneve të caktuara që rregullojnë edhe që ato krejt që i tha ai ti Karanfil. Përndryshe nuk ka pse ndërrohet, ky është në dokument teknik që ka me menaxhuar hapësirën e varrezave, pjesën të tjera të financimit, pagesave, mbulimit, veç e thashë formën qysh kemi me e bërë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, atëherë vazhdojmë me Partinë Demokratike.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese, pas propozimeve dhe sugjerimeve të nënkryetarit. Ne si grup i kuvendarëve të PDK-së votojmë pro për këtë rregullore të varreza.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. LDK.

Haziz Hodaj (LDK): Singerisht po krijon një konfuzitet sepse edhe ne kishim vërejtje shumë në dokumentin e parë. Po nuk ju ka kushtuar kurrëgjë në fillim me e bëni një transkrip të asaj një me shtyp një kopje me na servuar në mëngjes kur kemi ardhur në mbledhje edhe me e parë ndërkohë edhe me e votu këtë dokument. Se këto që i thatë ju, sigurisht janë të pranueshme, sepse nuk jemi ne. Unë thashë, unë personalisht, po edhe si grup ne kemi iniciuar atëherë mbulimin e shpenzimeve të varrimit në vitin 2017. Dhe sigurisht që jemi pro. Por kjo mangësia në dokumentin që e kemi ne edhe në dokumentin që ju ju referuat me këto përmirësime, sigurisht që ka ndryshime radikale. Po është mirë ta kemi q'atë dokument dhe nëse e votojmë ta dimë ç'a kemi votuar. Kështu që ndoshta është mirë, do të ishte mirë. A fizikisht te të gatshme varrezat me pranë tash varrime aty me prej kurit mundet me u fillu? Jo se s'u prononcova hala po thashë veç po si pyetje.

Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune): E para Haziz, ky është hapi i parë. Na duhet me pasur një dokument që e trajton këtë çështje në mënyrë ligjore. E dyta, sa më par që është e mundur operatori me fillu përgatitjen e pjesës teknike për fillim të varrimit tashmë s'caktot data, po po besoj kjo mund të bëhet afërsisht brenda dy-tre muaj. Nëse ne i kryejmë këto obligime të tjera.

Haziz Hodaj (LDK): Operatori a dihet apo duhet me u përzgjedh?

Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune): Operatori është i kryer, domethënë është përfunduar ai proces, shumë më herët është me partneritet ka përfunduar, është koncesion edhe këtu është e definuar, neve na ka mbetur puna jonë pa e kryer, operatori kryen punët e veta edhe vazhdojmë me e kryer punën.

Haziz Hodaj (LDK): Singerisht unë kisha kërkuar, kisha kërkuar që të shtyhet në seancën e ardhshme, kjo të na servohet një dokument preciz, final, i cili, i cili do të votohet, ta dimë çka kemi votuar dhe mos të, mos të bëjmë ndonjë, ndonjë gabim pa nevojë, se s'kemi nevojë me u gjetur, nëse ka kohë edhe dy-tre muaj, atëherë në muajin të ardhshëm ne kemi seancë tjetër, e votojmë këtë dhe nuk ka asnjë problem. Kështu që kisha kërkuar që të shtyhet për seancën e ardhshme.

Kujtim Gashi (Nënkryetar Komune): Ju mundeni me shtyrë edhe një seancë edhe dy edhe tre, po asnjë hap tjetër s'bëhet pa kaluar kjo rregullore. Nëse e thashë për tre muaj, tash nënkupton për katër. Domethënë me automatizëm edhe një muaj shkojmë tutje, për shkak se nuk po besoj që ka këtu shumë paqartësi. Rregullorja si dokument është i mirë, është dokument që e rregullon çështjet teknike. Nëse e keni pasur brengën për pagesa, unë e thashë që ato i merr për obligim komuna, për shkak se i ka pasur edhe atë deri tash. Edhe e kemi tradicionale këtë punë. Ndërkohë nëse doni me ditë çka keni votuar ne mund me ju përcjellë mbas seancës me email. Ke mi votuar këto që i përmenda unë Haziz, nëse më ke ndëgju.

Haziz Hodaj (LDK): Shiqo, në cilin vit ka qenë Hasan Hasani drejtor i shërbimeve publike? 2000 e sa? E në 2015-ën kur ka ardhur na ka prezantuar këtu një vajzë pat planimetrinë planin e varrezave, unë bile i thashë thashë na paska shti në qef edhe vdekjen. Kështu tekstualisht i kam pas thënë. E tha dikush më tha mua tha jo s'të lajmë tha ti me u varrosë atje se ti je Gjonaj e se s'ka lidhje. Ndoshta edhe s'des hiç unë, mes qetu gjallë... Kur është mbajte prej 2015-tës, të shtyhet edhe një muaj, bjerëni një dokument qysh duhet edhe ta votojmë, shkojmë tutje. Faleminderit.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Unë e pajtohem plotësisht me zotin Hodaj, përveç në këtë komentim e fundit, se kemi raste në Arbanë, sidomos në Arbanë, është urgjencë që varrimet duhet të bëhen diku tjetër. Është urgjencë. Deshta me pyet nënkryetarin, tash duhet me ditë ju për afërsisht, tha dy-tre muaj. Cilat janë ato hapa të tjerë që duhet me i ndërmarrë? Cilat janë, duhet me ditë për afërsisht, çka vonon dy muaj? Kush e vonon këtë procedurë dy muaj?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): E para po pajtona që kjo është urgjente. Është bërë punë goxha e madhe për me ardhë deri këtu. Jo vetëm Arbana, por edhe në Prizren ne kemi informatën e fundit prej kompanisë Ekoregjioi që ata tash momentalisht nuk kanë asnjë vend ku mund me varros nesër një banorë të vdekur të qytetit të Prizrenit dhe aktualisht janë duke i varros nëpër ato rrugicat që kalohet për me shkuar nëpër varre. Ndërkohë, procedura të tjera, kjo është parakusht për me hyrë në kontratën, implementimin e kontratës me koncesionerin, domethënë është parakusht rregullorja dhe në momentin kur kjo aprovohet, ju e dini, janë dy dy-tre javë që duhet me u prit konfirmimi i dokumentit dhe nëse ajo kthehet gjithëçka në rregull, atëherë vazhdon operatori me e përgatitur terrenin për varrim. Domethënë nuk ka procedura të tjera. Natyrisht që neve na duhet edhe një vendimmarrje të pjesa e mbulimit të shpenzimeve. Kështu që kemi pasur deri tash përmes Ekoregjionit, tash shkojmë përmes Ekoregjionit sërish. A shkojmë me Bashkinë Islame drejtpërdrejt, a shkojmë me koncesionerin po ashtu drejtpërdrejt, janë çështje që duhet na duhet edhe pak kohë me i trajtu sepse edhe ato janë aspekte ligjore.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit nënkryetar. Atëherë po vazhdojmë me nismën.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Unë nuk po zgjoj shumë se veç këtu kolegët i cekën disa gjëra. Nëse është në fakt kjo është e nevojshme me marrë sa më shpejt këtë vendim. Po e thirrjmë edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, që të na qesin letër të gjitha qato çka i tha edhe nënkryetari, t'i shikojmë, t'i lexojmë edhe ne edhe ato, e pastaj e votojmë. Është mirë që të shtyhet, i përkrah këta kolegë që folën para meje, që kjo pikë le të shtyhet ose ta marrim një vendim edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, unë po mendoj që duhet me u ngut patjetër. Le të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Levent Bus (KDTP): 32:50- 33:05

Sead Arifi (Vakat): 33:20 – 33:25

Admir Aljilji (SDU): 33:30 – 33:35

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po nënkryetar, a je i mendimit me vazhdu?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Okej, meqë ka një disponim edhe pak me shty. Nëse kjo kalon në votim natyrisht konsumohet si pikë për ose jo edhe duhet me pas me një seancë tjetër. Nëse e pajtoheni, unë po pajtohem me propozimin e Las Shuk, s'po besoj që ka nevojë për një seancë të jashtëzakonshme, po ju konsumoni edhe pikën e radhës edhe nëse ka mundësi me e përcaktuar për sot një javë votimin e kësaj pike, se besoj që ne për dy-tre ditë mundem me i inkorporuar të gjitha këto në rregullore dhe me ja përcjell nëse veç po pajtohem për do çështje teknike edhe pse po e përsëris që ato që kanë me hy në rregulloje janë këto që i thashë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Ilir urdhëro.

Ilir Gashi (LVV): Mbasi veç po shtyhet edhe një propozim teknik nënkryetar. Edhe zotëriu nga konsulenca një propozim teknik, nëse është e logjikshme, nëse pranohet, përveç sistemimit të varrezave në baza religjioze, a kishim mujtur që edhe pjesën brenda atij konfesionit me nda së paku me një 10 pjesë në bazë të mbiemrit, prej A deri filan shkronjën, që me pas më lehtë edhe, veç si si ide kjo, si propozim? O, okej. Veç thashë me mbiemra ndoshta edhe vijmë më afër. Po.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ilir. Dikush tjetër? Po Selman?

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, veç përmes sqaru, domethënë seanca po shtyhet edhe diskutimet përmbajtësore duhet me i mbajt në seancën ku votojmë, apo? Se shpesh herë ka ndodhur që kur kemi ardhur te seanca, te data që është shty atëherë ka pasur tendencë me na qit para aktit të krymë që tash duhet veç me votu formalisht, me sqaru këto, domethënë. Nëse po e shtyjmë edhe e diskutojmë përmbajtësisht, po diskutimi nënkupton edhe me i mbledh shefat e grupeve, me inkorporu çdo vërejtje edhe të bashkësive fetare, përndryshe s'kemi arsye me shty. Nëse ndodh, ajo në rregull, nëse ajo nuk ndodh, atëherë mund të themi tash, çka.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ka ndodhur ashtu që po thua ti, sepse kemi pas mbetur mu te procesi i votimit për shkak të kuorumit është pas ndërpre.

Selman Sokolaj (LVV): Tash me sqaru kryesuese, nuk po hyjnë në përmbajtje tash, në rregull.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull. Po po, do të kemi mundësi edhe po sot në javë është propozuar nga nënkryetari, ose po e marrim si vazhdim të seancës e shohim një orar edhe ju njoftojmë me kohë. Po e lëmë kështu. Që javën tjetër, po ju lajmëroj me kohë edhe e mbajmë vazhdimin për këtë pikë. Ju falënderoj të gjithëve atëherë. A jeni të pajtimit kështu që me e lënë për javën tjetër e qesim votim? Unanimisht, ju faleminderit. Atëherë po kalojmë te pika e shtatë, Raporti financiar për periudhën janar mars 2025. Drejtor, fjala për juve.

7. Raporti financiar për periudhën janar mars 2025.

Sulltan Badalli (D.Financave): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për nënkryetarin, ekzekutivin dhe të gjithë kuvendarët. Pra kemi raportin financiar për tremujorin e parë të vitit që jemi. Pra buxheti përbëhet prej të hyrave të përgjithshme dhe të hyrave vetanake. Në kuadër të hyrave të përgjithshme janë granti qeveritar, të hyrat vetanake, të hyrat nga donacionet e brendshme, participimi, donacionet e jashtme si dhe një pjesë nga financimi nga huamarrjet të cilën ne kemi. Pra prej një total prej 70 milion e 563 euro. Ndërsa te të hyrat të vetanake të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2025, planifikimi ka qenë për këtë vit 10.677.000 euro, ndërsa janë realizuar 1.795.000 euro, në përqindje do të thotë 16.94%. Pra, gjithnjë bëhet fjalë për tremujorin e parë. Ndërsa te shpenzimi i buxhetit komunal i kemi në pesë kategori kryesore te pagat, e kemi shpenzimin prej planifikimi prej 27.513.000, ndërsa janë shpenzuar 7.139.000, 25.95% e shpenzimit nga kjo kategori. Ndërsa te mallrat dhe shërbimet, e kemi buxhetin prej 14.247.000, ndërsa shpenzimi 3.535.000, përqindja 24.82%. Shpenzimet komunale, planifikimi është 1.550.000, shpenzimi 132.000, përqindja 12.55. Subvencionet, planifikimi është 4.642.000, ndërsa shpenzimi është 572.000, përqindja 12.34%. Ndërsa te investimet kapitale, planifikimi

është prej 23.000.000, ndërsa janë shpenzuar 7.360.000, përqindja 30.45%. Pra në total shpenzimi i buxhetit për tre mujorin e parë të këtij viti është 26.10%. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. A dëshiron dikush me diskutu? Po Selman Sokolaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Kështu, pa hyrë në detaje në numra, unë e kam një çështje me ngrit ose një pyetje për drejtorin. Komuna e Prizrenit, obligimet që i ka marrë deri tani financiare, në bazë të punëve që ka me i kryer edhe disponueshmërinë e financave për ato punë. A ke një analizë të tillë? Për shkak se tani po jemi dëshmitarë që kemi problem edhe me përmbarues, domethënë jo veç te kontratat, por kemi problem edhe në mos ekzekutimin e kontratave për punët e kryera. Edhe për shkak se është vit zgjedhor, zakonisht hapet kuleta, mirëpo në atë kuletë jo domosdoshmërisht janë financat e duhura. Nëse ke një analizë të tillë, na kishte ndihmuar shumë në këtë raport për me e kuptuar më qartë. Faleminderit.

Sulltan Badalli (D.Financave): Faleminderit Sokol. Shumica e projekteve kapitale që janë nga kontratat kornizë janë dy ose tre vjeçare. Prandaj një analizë ose një informacion të tillë që e kërkon për momentin normalisht që nuk e kemi këtu, po mund me ja siguru, me ja dërgu përmes emailit ose me shkrim po mendoj.

Selman Sokolaj (LVV): Okej, atëherë po e merr përsipër. Ndoshta s'ka nevojë me ju drejtuar me një kërkesë të veçantë, për shkak se drejtor mundem vetëm një rast me e përmend. Se kjo po shkakton pasoja, kushdo që të është pushtet shkakton pasoja financiare për qytetarët në fund të fundit, se ata janë kontribuesit i kësaj kulete. Edhe në vitin 2018 kemi pasur shumë punë pa mbulesë financiare. Jo, ndoshta duhet se ai personi që e mban kuletën e komunës me shku në mënyrë më rigorozë edhe mos me sjellë komunën që me qenë subjekt i përmbaruesve se tani mo tashmë po besoj jeni të njoftuar që çka nënkupton me qenë objekt ose subjekt kur ke punë me përmbarues. Penallti të ndryshme, vonesa, kamata, gjithçka është barrë pothuajse pesëfish më shumë se nëse ajo faturë do të ishte paguar normalisht. Faleminderit.

Sulltan Badalli (D.Financave): Po, po e vërtetë është që na çrregullon normal planifikimin edhe te pagesat normale. Po jemi munduar gjithnjë që me reflektuar edhe me minimizuar sado pak atë gjendje që është. Po ashtu edhe në planifikim, tash që jemi në fazën e planifikimit të buxhetit, kemi diskutuar dhe jemi munduar që projektet të jenë të mbuluara, të gjitha projektet, pavarësisht sa hapen të reja, një, dy, tre, a pesë, a dhjetë, po për me pas disponueshmërinë e mjeteve që e ceke. Domethënë janë marrë masa në atë drejtim, po normal kemi pasur edhe probleme me përmbarim që na ka shkaktuar këto probleme që i ceke. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, drejtor. Dikush tjetër? Zotëri Hodaj, po.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Pikërisht e pata dhe unë çështjen të përmbaruesit, sepse në pyetjet tona për mosrealizimin e disa projekteve që i drejtohem drejtorëve, thonë s'ka, nuk na kanë mbetur mjete sepse i ka marrë përmbaruesi. Unë edhe njëherë e kam thënë dhe prapë po e them. Unë e di që ka zbrazëti ligjore dhe vjen puna deri te përmbaruesi me ja shti dorën në xhep edhe me ja marrë paratë kështu me delikatesë. Por kur e dimë, kur e dimë se kemi probleme me përmbaruesin, do të duhej me parapa edhe në buxhet çështjen e përmbaruesve. Domethënë se

e din tash kush mundet me t'i marrë mjetet me përmbarues, e din ku i ke zbrazëtitë ligjore, sepse ato zbrazëtitë ligjore nuk janë faji i ynë, nuk janë faji i kuvendit, as i juaj, po janë faji i Parlamentit të Kosovës, që ai duhet me pru ligje konkrete edhe me s'me pru punën te përmbaruesi me ja u marrë parat komunave apo drejtorive të caktuara, por duke pa këtë gjendje çfarë është, atëherë është mirë me e parapa si pozicion buxhetor edhe një pozicion për përmbaruesit. Mos me i lënë projektet pa realizuar që parashihen me buxhet. Sepse mandej dalim keq para qytetarëve, para njerëzve që ju kemi premtuar, sepse përmbaruesi po na i shkurton këto, këto të drejta elementare. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hodaj, dikush tjetër? Në qoftë se nuk dëshironi dikush tjetër me marrë fjalën, po ju falenderoj shumë për kontributin që e dhatë edhe në pikën e shtatë. Atëherë po kalojmë te pika e tetë, vetëm që ta shohim a kemi kuorum, që vetëm t'i numërojmë. Hamdi, a mundesh me i thirrë, të lutem? Fiks a? Se po vijnë, po vijnë. Po po kemi, kemi. Atëherë po vazhdojmë meqë u kthyen anëtarët e kuvendit. Po kalojmë te pika e tetë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës së Prizrenit, për emërtimin e rrugëve në territorin e komunës së Prizrenit të datës 15 dhjetor 2016, zonave të qarkullimit publik në komunën e Prizrenit. Fjalën nga komisioni kush do ta ketë? Po Egzona urdhëro.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës së Prizrenit, për emërtimin e rrugëve në territorin e komunës së Prizrenit të datës 15 dhjetor 2016, zonave të qarkullimit publik në komunën e Prizrenit

Egozna Hoxhaj (Komisioni): Faleminderit kryesuese. Unë po jap një sqarim shumë të shkurtër si anëtare e komisionit edhe për shkak që jam marr më shumë bashkë me Bajramin edhe me Lajën Shuk. Ne si komision i kemi shtjerrë të gjitha mundësitë e takimeve, puna që për me marrë emra edhe ata emra me u përfshi në listën në listën rezervë. Neve na është lejuar që me plotësu, ndryshuar listën në rezervë për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në komunën e Prizrenit. Kjo për shkak që lista që ka qenë deri më tash ka një numër të vogël të emrave në të dhe kërkesat për emërtimin e rrugëve të reja janë shumë më të mëdhaja. Një sqarim që duhet me bë për të gjithë neve në asamble komunale por edhe për të gjithë qytetarët e komunës të Prizrenit, për shkak që të gjithë këtë kohë kemi pasur jashtëzakonisht shumë pyetje, është që ne kemi kërkuar prej tyre emra me të cilët do të emërtohen rrugët e reja. Dhe ne si komision nuk neve si komision realisht nuk na lejohet që deri në vitin 2029, të bëhet ndryshimi i emrave apo emërtimeve tek rrugët ekzistente. Ne përpos që pjesë e komisionit jemi përfaqësues nga të gjitha partitë politike, ku përmes tyre kemi kërkuar propozime të emrave. Në të njëjtën kohë kemi mbajtur edhe dy takime me kryetarët e këshillave lokal, ku fatmirësisht kemi pasur një pjesëmarrje jashtëzakonisht të mirë të tyre, ku edhe prej tyre kemi pranuar emra apo propozime të emrave, për të cilët kanë propozuar që në lagjet ose në këshillat lokale, ku ata përfaqësojnë që me u vendos këta emra tek rrugët që do të regjistrohen. Ne si komision kemi vendosur që të gjithë emrat të cilët e kanë pasur një biografi

me u përfshirë në listë, nuk janë përfshirë emrat që na kanë ardhur që personat vazhdojnë me qenë gjallë, për shkak që kjo nuk është e ligjshme edhe nuk na lejohet me ligj, ndërsa emrat të tjerë, të gjithë propozimet të cilat ata emra e kanë pasur një biografi edhe e kanë dhënë një kontribut në qytetin e Prizrenit, në rrethin ku ata kanë jetuar dhe kanë vepruar, janë përfshirë. Normalisht ka pasur kërkesa që ka pasur edhe emra, propozime që në disa rrugë ose lagje të caktuara ku jetojnë një familje me u quajtur edhe në bazë të mbiemrave të tyre ose edhe në bazë të kryefamiljarëve të tyre, që kjo ka qenë diçka e pranuar për shkak që edhe ligji na i lejon. Ne si komision e kemi ndarë bashkë me juve listën. Kryesuese, kjo listë që e kemi ndarë me juve edhe bashkë me kolegët duhet t'i ketë disa ndryshime për shkak që të një emër ka pasur një gabim teknik. Është shkruar si Ilir Shala, ndërsa u dashtë me u shkruar Hajdar Shala, që është njoftë edhe me nofkën Iliri. Kjo ka qenë një mos informim i saktë edhe është dashur me u ndryshuar edhe në të njëjtën kohë në bazë të disa kërkesave që na kanë ardhur mbas mbajtjes së KPF-së, nga kolegët kuvendarë janë propozuar edhe pesë emra të tjerë me u përfshi. Kështu që po i lexoj për transparencë emrat për shkak që nuk janë pjesë e listës edhe për shkak të procesverbalit që tani kjo listë me u plotësu. Bëhet fjalë për Hajrim Shaban Badalli, lagja Shabanajt, me u emërtuar, Kadri Llapçeva, Bislim Bislimaj dhe Kujtim Paçaku. Janë emrat që më kanë ardhur nga kolegët kuvendar, pasi që e kemi nda na listën me juve si kryesuese që me u përfshi. Kaq.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit shumë Egzona. Po Selmani fjalën e ka kërkuar.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, unë pata veç një ndërhyrje të shkurtër edhe në bazë asaj që tha kolegja po u lejoka, në Romaj, është një rrugë që po besoj është e emëruar gabimisht, është De Dufi. Realisht do duhej të ishte Del Dufi. Edhe mundemi me i këqyrë në arkiva, vendimet kur janë marrë, nuk besoj që komisioni ose ata anëtarë të mëhershëm e kanë propozuar për shkak se të gjithë banorët e njohin si Del Dufi. Edhe ka një kuptim aty se është rrugë në bazë të një burimi që është aty në fshat, edhe de duf nuk ka kuptim, domethënë del duf ose del dufi ka kuptim, kështu që Egzona tha që nëse ka gabime teknike e mundmi mi evidentuar në bazë të procesverbaleve, po propozoj që me përmirësuar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po po patjetër derisa të i votojmë hyjnë edhe këto propozimet. Dikush tjetër? Po zotëri Agim Muçaj.

Agim Muçaj (AAK): Faleminderit kryesuese. Unë njëherë të i falënderoj grupin apo komisionit të cilët kanë pasur një angazhim të veçantë rreth kësaj pike, mirëpo unë çfarë kisha dashur ta diskutoj sot, ne si në këtë mandat edhe në mandatet e kaluara, mendoj se ka mjaft vërejtje për të diskutuar sa i përket emërimit dhe kategorizimit të emërimit të rrugëve. Ne e dimë që edhe në të kaluar, kemi mjaft emra në qytet, lagje, fshatra që ndoshta nuk e kanë vendin adekuat dhe mendoj se duhet të jenë disa kriterë pak më të rrepta sa i përket emërimit dhe kategorizimit të rrugëve. Në këtë pikë ka, jo veç nga unë, por mendoj që nga shumica e qytetarëve ka vërejtje. Ne e dimë mirë se qindra emra ekzistojnë në qytetin e Prizrenit edhe nëpër fshatra të mëdhaja se ndoshta dhe nuk e meritojnë atë vend aty apo ndoshta dhe hiç. Kemi raste nga komisionet e kaluara, ndoshta kemi emra dhe sot në këtë komision, të cilët janë të përfshim njerëz që kanë futur familjarët e vet, ndoshta edhe nuk e meritojnë, por mendoj se nga ne është e turpshme, në qoftë se gabojmë, sepse do të na mbajë në mend historia. Kështu që kemi emrat e heronjve, kemi heronj kombëtar, kemi sportista të nderuar, secilit i gjendet vendi aty ku e meriton, dhe jo ndoshta një heroit kombëtar të

shkon me një preferi, me një rrugë 20 m, e dikush veçse e ka pasur babë ose nënë, t'ia qet me një rrugë 500 m. Kështu që mendoj që kriteret duhet të jenë pak më të rrepta, pavarësisht grupi, kush do të jetë sot apo nesër. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Muçaj. Dikush tjetër? Okej.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Sa i përket emërimit rrugëve me të vërtetë kemi pasur vërejtje të shumta nga qytetarët për emërtimet të rrugëve, të cilët nuk kanë të bëjnë me banorët që gravitojnë në atë rrugë. Ka emra të njerëzve të cilët as për së afërmi nuk lidhen me atë rrugë dhe janë emërtuar rrugët. Ka pasur një kriter, faktikisht nuk ka pasur kriter hiç për përzgjedhjet të emërtimeve të rrugëve në atë kohë, në atë komisionin që është bërë. Edhe unë mendoj që jam i privuar nga e drejtë për të propozuar si asambleist këtu një emër. Tash ndoshta duhet ose dajën ose tezën ose hallën dikënd e kisha propozuar, se ashtu emrat ishin në çasi farë forme. Dhe thashë ta kisha propozuar thënë dikënd prej familjarëve ndoshta e meriton ose. Po tregoj që jam i provuar i privuar nga kjo e drejtë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po po urdhëro po.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Egzona i sqaroj në përgjithësi të gjitha veçoritë që i kemi përfshirë deri më tani. Unë po dua me ju përgjigj Agim Muçës për një sqarim. Sa i përket ndryshimit të emrave, ne s'kemi mundësi me bë tash, po nëse bëhet lista rezerv, emërtimi i rrugëve të reja mund të bëhet në ato rrugë ku i kemi kërkesat, do të thotë në bazë të kërkesave, këshillave lokal ose të komisionit ose të komunitetit ku jetojnë. Do të thotë në bazë të kërkesave emërtimet e reja mund t'i bëjmë aty. Sa i përket biografive, ne si komision e kemi dhënë maksimumin edhe krejt përfaqësuesit e partive politike me u konsultu me krejt asambleistët, fillimisht si përfaqësues lokal, pastaj edhe me këshillat lokal, edhe me i pru emrat. S'kemi mujt tash se gjërat mund të kalojnë edhe personale kur e diskutojmë një emër konkret për këtë ose për atë. I kemi lutur anëtarët e komisionit, i kemi lutur edhe kryetarët e këshillave lokal, të kenë kujdes që mos na bijn emra familjarë ose emra që nuk e kanë ndonjë biografi të caktuar. Unë e kam dëgjuar dy-tre emra pastaj, mbasi është bërë lista që kështu ose ashtu, po unë s'po dua me kalu në personale tash me askënd, as s'po dua me përmend emra. Emrat i keni, nëse shihni të arsyeshme që duhet me votuar veç e veç, janë shumë emra dhe na merr kohë. Qysh do që e shini të arsyeshme ne kemi qenë transparent me të gjithë, me asambleist, me kryetarët e këshillave lokal, edhe tash e keni mundësinë me bë propozime, kështu që ju lus nëse e keni ndonjë propozim konkret, nëse e keni ndonjë vërejtje për ndonjë emër konkret, mundni me përmend, po mundim edhe me na dalë telashe, diskutime se qysh e dimë ne jemi një shoqëri që i kalojmë gjërat personale. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, faleminderit zoti Kastrati. Prit se Agimi ka replikë kryesues.

Agim Muçaj (AAK): Nuk është tash drejtpërsëdrejti me Bajramin, po po i drejtohem nënkryetarit të Kujtës, pasi që e di që është edhe bukur mirë njohës edhe i shumë ligjeve. Ne në qoftë se kërkohet nga ne që ta votojmë këtë listë, ashtu siç është. Unë për atë potencova pak më herët, se jo veç nga ky komision i kësaj legjislature, unë mendoj se ka mjaft hapësirë për të qitur kritere më të rreptë. Në qoftë se ne e votojmë tash këtë listë në tërësi, edhe ndoshta ka emra aty që nuk do të jenë aty, dhe nuk janë merituar si do ta votojmë? Kështu që, unë nuk e di sa kemi hapësirë që me

të vërtetë që të jetë, të ketë kritere, të cilët emra mund të kalojnë. Në, në këtë pikë mendoj që ka hapësirë mjaft fortë të u diskutuar dhe nënkryetar, besoj që je njohës i mirë i ligjeve. Këtu kisha dashur një përgjigje pak më të thuktë që të jemi të sqarum ne edhe i gjithë opinioni se deri ku do të arrijmë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Këto çështje kritere, këto janë të përcaktuara edhe me legjislacion edhe besoj që komisioni e ka pasur parasysh. Përndryshe, për mos me u keqkuptu, kjo nuk është listë e emërimit të rrugëve. Kjo është listë rezerv. Domethënë, rrugët aktuale nuk ndryshojnë. Edhe ato janë përcaktuara deri në çfarë periudhe nuk ka asnjë ndryshim. Domethënë, viti 2029 i gjen rrugët aktualisht qysh janë me emër, me emërtime. Ndërkohë, kjo është një listë rezervë që mund me u shtu në rrugë të reja, eventualisht nëpër këto zhvillimet që po ndodhin sot, përndryshe emërtimi rrugëve nuk ndryshon deri në 2029. Besoj këta e kanë pasur parasysh edhe komisionin edhe komisionet paraprake se në secilën legjislaturë është diskutuar tema e emërimit të rrugëve, shesheve edhe objekteve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit nënkryetar, po zotëri Thaçi fjalën.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. një pjesë të shpjegimit çështjeve që u ngritën këtu e dhënë edhe nënkryetari edhe Egzona, edhe kolegu Bajram. ajo që u, ndoshta u harru me u theksua ka qenë se, në këtë listë ka, ta quaj kërkesa të veçanta për lokalitete të veçanta. Do të thotë meqënëse, siç edhe theksoi Egzona, në dy takimet me, kryetarët e bashkësive lokale, domethënë kanë ardhur kërkesat, t'i quaj specifike për lokalitetet e tyre. Kështu që, edhe këto janë marrë parasysh. Ajo që e tha edhe nënkryetari, po edhe Agimi që ngriti shqetësim, ndoshta problemi më i madh ka qenë me, përbërjen e fundit të komisionit për emërimin e rrugëve të legjislaturës së kaluar, ku edhe në takime me qytetarë, edhe veç e veç, por edhe kështu ne si komision që kemi pasur, ka ndodhur që në shumë rrugë të qytetit apo dhe në vendbanime pa pëlqimin e banorëve janë ndërruar emërtimet, madje edhe të vetë dëshmorëve. Gjë që përpos pakënaqësisë së tyre ju ka sjellur edhe shumë probleme teknike t'i quaj vetë banorëve të atyre lokaliteteve. Shpresoj që në legjislaturën e ardhshme kur, e cila do të vijë pas nesh, në vitin 2029 do të korrigjohen të gjitha këto gabimet dhe kërkesat, edhe pres që kolegët kuvendarë ta votojnë këtë listë, meqënëse propozimet kanë qenë të hapura edhe shumica e propozuesve janë përmbajtur kritereve, sado që ndoshta duken të pakta si kritere, po ne s'kemi që të bëjmë kur si shtet do të kemi mangu disa ligje, mbi të cilën të mund të t'i gjejmë propozimet për periudhat e ndryshme kohore mbi të cilat ka kaluar shoqëria jonë. Derisa s'kemi ligjin për lustracion e të tjera, nuk mund të sanksionojmë dikënd për të kaluarën e tij. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaçi. Atëherë, në qoftë se nuk ka dhe dikush tjetër në lidhje me këtë pikë, po e hedhi në votim prezent jemi 22 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit i ditës? 19 jemi për, 0 kundër, 1 abstenim. Atëherë ju falënderoj të gjithëve. Miratohet edhe pika e tetë e rendit të ditës. Dhe për vazhdimin e seancës do t'ju lajmërojmë me kohë për pikën e gjashtë që e patëm. Ditën e mirë dhe mirupafshim.

VAZHDIMI I SEANCËS – 03 QERSHOR 2025

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zotri Quni?

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese, përshëndetje koleg kuvendarë, e kam goxha vështirë me bisedu po mendoj me u deklarë po patjetër. Unë jam këtu në këtë kuvend domethënë pas Hazizit që është më i vjetër se unë këtu unë atëherë vij me radhë, domethënë kur është ndërtuar ky kuvend jam në këtë asamble. Unë kam vendosur me dhënë dorëheqje morale, nga ky kuvend, duke i kërkuar falje elektoratit tim. Këtë dorëheqje po e bëj pa u konsultuar me askënd fare. Arsyeja e dorëheqjes është një aksident që ka ndodhur në fshatin Nashec, ku unë kam kërkuar aty shumë herë në këtë kuvend, para jush, që të vendosen vijat e bardha, vendosen shenjat e komunikacionit. Fjala ime këtu nuk ka qu pesh, kush e di sa. Edhe plus ka qenë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Edhe një inspektor ta quaj kështu i vozitjes Hamit Hazeraj, që ka kërkuar shumë herë që në atë kryq me u vendos shenjat e komunikacionit, sidomos shenja që duhet të jetë e shkollës për nxënës. Unë ju kërkoj falje edhe juve nëse ju kam lënduar ndonjëherë. E kam fjalën pa qëllim aty kur i kemi pasur ato debatet politike po flas, personale, asgjë s'kemi pasur. Mos ma merrni këtë dorëheqje që e kam bërë, që më ka thënë kush, asnjë trof, vetëm po e ndjej veten, si një akt moral me bë, si asambleist i asaj pjese, që jam munduar me i mbrojtë ma shumë se shpirtin tim. Po aty pikërisht është edhe vendi ku ka ra hero edhe Remzi Ademi, komandanti i parë i zonës operative të Pashtrikut. Po edhe unë vetë kam qenë aty, ku kam marrë edhe unë plagë. Nuk kam, nuk kam pasur dëshirë unë aty më me pasur viktimë tjetër përpos neve aty. E si nxënësi imi, Gentian Shala, që ka humbur, dje është varrosur. Unë atë e kam pasur 10 vjet aty në shkollë. Prej moshës pesë vjeçare. Edhe e ka kryer në Nashec 10 vjet shkollën. Unë i kam dhënë mësim atij katër vjet. Ka kaluar atë rrugë ndoshta 10 herë gjatë ditës. Andaj unë më këtu në këtë kuvend nuk mund më të marr fjalë ose të mbrojtë interesat e qytetarëve, andej nga vij unë. Ju falënderoj të gjithëve për mirëkuptim që keni pasur ndaj meje. Asgjë nuk ka, as nuk e din kryetari i partisë Fatmir Limaj, kryetar i nismës, as nuk e din kryetari i partisë dega në Prizren Zafir Berisha, as nuk e dinë anëtarët e familjes sime, as nuk e dinë elektorati, po qëllon kjo mbledhje domethënë, aj djeu varros, sot ne po e mbajmë këtë mbledhje. Kjo mbledhje është e fundit për mua. Ju faleminderit të gjithëve. Ditën e mirë, kalofshi si është më së mirëti.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Quni edhe ne ju falënderojmë për gjithë kontributin që e keni dhënë si anëtar i kuvendit për shumë vite këtu në këtë kuvend, për qytetarët e komunës të Prizrenit. Kështu që kontributi juaj e dimë të gjithë që ka qenë jashtëzakonisht i madh. Ju faleminderit shumë. Atëherë, mirë, vetëm ta shohim a kemi kuorum edhe po e vazhdoj me arsyen e thirrjes së kësaj mbledhje, pra me vazhdimin e mbledhjes. Po atëherë të nderuar anëtarë të kuvendit, përshëndetje për të gjithë, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtor, i nderuar zëvendës kryesues, media, të gjithë ju të pranishëm. Përshëndetje për të gjithë. Ashtu siç kemi njoftuar për sot kemi vazhdimin e mbledhjes së kuvendit pra të komunës të datës 29 maj 2025. Po prezent jemi 22 anëtarë, kështu që mund të vazhdojmë me këtë pikë. Me pikën e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja

6. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovic të Prizrenit në Landovic.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pa humbur kohë po e hap diskutimin për këtë pikë në qoftë se dëshironi ende dikush me e marrë fjalën. Po Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Ne zakonisht e kemi diskutuar çështjen e varrezave, për shembull, që do të jetë edhe forma se si do të jetë. Mirëpo nuk e kemi diskutuar edhe çështjen e varrezave për fëmijët. Do të thotë kërkoj që ato ta kenë një parcelë, do thotë, në vete. Arsyeja është sepse nëse shkojmë në formën e renditjes, atëherë një varr i një fëmije ndryshon prej një varri i një të madhit dhe do të prishet krejt forma ose struktura e varrezave. Sepse një fëmijë me dy-tre vjet nëse ndërron jetë, nuk mundet të ju bëhet një varr prej dy metrash e sa është. Kështu që kërkoj që të jetë një parcelë e veçantë për fëmijët. Ndoshta Zoti nuk na sprovon askënd në këtë aspekt, mirëpo ndryshon do thotë procedura e varrimit tek fëmijët me të rriturit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hoxha, Karanfil Haxhillari fjalën.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Dorëheqja si akt moral e kolegut Shukri Quni me të vërtetë mua si shef i grupit më la pa fjalë. Para se me kalu në pikën e rendit të ditës bashkëndejmë edhe ne fajin për atë aksident, pra nga një neglizhencë e komunës në këtë rast e cila kushton me jetën e një të riu, me të vërtetë në mënyrë direkte apo indirekte bëhemi bashkëfajtor në këtë aksident, dhe e falënderoj për këtë akt madhor të kolegut tonë Shukri Quni, si dhe i shprehim ngushëllimet më të singerta familjes Shala, me shpresën që herëve të tjera kjo qeverisje do të jetë më e kujdesshme, do t'i ketë parasysh të gjitha vërejtjet të cilët neve si kuvendar këtu i paraqesim, sepse nuk janë dëshira ato vërejtjet tona dhe kërkesat tona, janë kërkesa të cilat ballafaqohen çdo ditë qytetarët e komunës së Prizrenit dhe në rast se nuk përfillen këto kërkesa tona, përfundojmë në këtë gjendje qysh kemi përfunduar. Tash po kalojmë në pikën e rendit ditës, neve pavarësisht vërejtjeve dhe kritikave tona të cilat i dhamë në mbledhjen e kaluar sa i përket kësaj rregullore, me premtimin e nënkryetarit ku doli që në këtë rregullore do të inkorporohen edhe kërkesa të tjera si nga Bashkësia Islame po ashtu edhe nga neve kuvendarët. E lexova me vëmendje rregulloren e përmirësuar, po e quaj në thonjëza të përmirësuar, sepse aty prapë sipas meje nuk ishte ndryshuar asgjë përveçse periudhës së informimit për varrim dhe disa anekseve të vogla, por substancialisht kjo rregullore mbetet e njëjta të cilët neve kishim kundërshtimet tona. Edhe njëherë po e cek, neve nuk jemi kundër hapësirës së re të varrezave. Është shumë mirë që e kemi një hapësirë të re për shkak të kushteve që janë krijuar në varrezat e qytetit. Ne jemi kundër formës së menaxhimit të këtyre varrezave. Nga viti 2018, deri tani, derisa komuna ka pasur buxhet për subvencionim të ceremonisë së varrimit për të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit pa dallim, pse të mos vazhdojë kjo njëjtë? Në qoftë se një operator ekonomik i ka kryer punimet në vitet e mëhershme 2014-2015, pse mos t'i paguhet ai dëmi apo ato punime të cilët i kanë bërë në atë zonë apo në atë pronë komunale dhe të vazhdohet me ndërmarrjen publike të Ekoregjionit, po po e njëjta menaxhimi i varrimit qysh ka ndodhur në varrezat e qytetit deri sot. Pse duhet të kemi patjetër koncesionar? Derisa e kemi ndërmarrjen publike komunale, të cilët 64% të kësaj ndërmarrje publike i menaxhon komuna e Prizrenit. Po ashtu tjetra është planifikimi i varrimit. Prapë nuk është hekur ajo rezervimi i pronës për varrim nga familjet, pra duhet që një familje duhet të blejë

pronë, cilën pronë pronën e komunës. Kush i merr ato pare, ato pare i merr konsesionari. Prandaj, duke u bazuar në të gjitha këto, prapë neve edhe kësaj radhe, si Lëvizja Vetëvendosje, propozojmë që ajo hapësirë e varrezave të reja në Landovicë, është pronë e Komunës së Prizrenit, të, në qoftë se komuna e Prizrenit i ka borxh koncesionarit, t'ia paguajë atë borxh dhe të vazhdohet me ceremoninë e varrimit apo me menaxhimin e asaj pjese nga ndërmarrja publike Ekoregjioni dhe jo nga kompanitë private. Duke e mënjeluar edhe ndasitë të cilat do t'i kemi të nesërmen. Ndasitë sepse nëpër fshatra do të vazhdojë varrimi me subvencionim të komunës, kurse qytetarët në këto varreza do të varrosen me pagesë. Prandaj jemi edhe kundër ndarjes në këtë rast qytetar, fshatar, po e them në thonjëza dhe mos ta kemi mos të krijojmë një praktikë dhe të kthehemi para vitit 2017, ku këtë praktikë të mirëfilltë dhe humane të mbulimit të shpenzimeve për ceremoninë e varrimit që ka qenë shembull në gjithë territorin e Kosovës, mos ta rikthejmë prapë me pagesë. Prandaj edhe ne si Lëvizje Vetëvendosje për këtë rregullore jemi kundër.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hagjillari, po nënkryetari fjalën e ka.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesuese, të nderuar anëtarë të kuvendit. Nuk kam rreth rregullores me shtuar shumë veç për me qartësuar pak se Karanfili ose me qëllim po e bën ose nuk e ka kuptuar rregulloren. Janë domethënë se di, inshallah nuk e ka kuptuar. Domethënë kisha me qenë më i kënaqur sesa me bë me qëllim edhe me tentu këtu me bë një ndarje mes qytetarëve edhe fshatarëve në rastin e varrimit. E para besoj e ke lexuar pikën 5.5 edhe e dyta e ke lexuar pikën 10.3. Nëse këto dyja s'i ke kuptuar duhet një jurist me t'i sqaru pak më mirë. Përndryshe pagesën e kam thënë atë ditë, po e them sot, po e ripërsëris edhe e ke në dokument mbulimin e shpenzimeve për varrim qytet dhe në fshatra e mbulon komuna e Prizrenit. Ashtu siç ka qenë deri sot. Tjetër send nuk kam shumë me thënë.

Karanfil Haxhillari (LVV): Pika 5.5, i nderuari nënkryetar, thotë, mbështetje financiare në kllapa kur aplikohet? Pra, domethënë familjarët duhet të aplikojnë për t'u subvencionuar. Edhe unë më shumë s'kam çfarë të them. E për me kuptuar, shumë mirë e kam të kuptuar. Edhe para viteve 2017, secila familje që ka aplikuar për subvencionim, i është rimbursu dhe është subvencionuar, por paret i ka marrë mbas një vjete apo dy vjete. Pra, po kthehemi në vitet 2017.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Edhe një replikë të shkurtër rreth kësaj çështje, nuk kanë me subvencionuar qytetarët, por kanë me u paguar varreza te operatori. Pika 10.3, thotë, për familjet me kushte të vështira ekonomike, presje. Komuna mbulon shpenzimet në bazë të varrimit nga fondet e subvencionimit. Gjithashtu, gjithashtu, komuna përmes vendimeve të veçanta, rregullon çështjen e mbulimit të shpenzimeve të tjera. Ngjashëm me praktikën e deri tashme. Ngjashëm me praktikën e deri tashme. Është nen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po faleminderit. Dikush tjetër? A dëshiron me e marrë fjalën? Këtu patëm një propozim edhe prej zotërit Hoxhaj për parcelën për fëmijë. E kisha lutur Anëtarin prej institutit ose nënkryetarin, në qoftë se ka ndonjë sqarim diçka për me u bë ndarja.

Anëtar i Institutit: Përshëndetje. Veç një sqarim do të thotë të shkurtër për këtë. Pra, janë të parapamë dimensionet në kuadër të planit të përgjithshëm që dallojnë dimensionet e të rriturave dhe dimensionet për varrezat e fëmijëve dhe ato janë të renditura në të njëjtin vend përshtaten pra. Ndërsa për këto për pjesën tjetër do të thotë, është hequr ajo pjesa e parcelave private siç ka

figuruar, sepse ka qenë një gabim teknik aty i lëshuar. Përndryshe, varrezat dhe dimensionet për të gjitha janë të përcaktuara edhe për edhe për fëmijë edhe kuptohet që ato do të kenë dimensione të tjera. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër? Po, zotëri Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Unë po dua me u bëj shumë korrekt edhe me ju treguar që nuk e kam lexuar rregulloren sepse këto email adresat tona zyrtare më shumë rrinë të bllokuara se të zhbllokuara edhe sinjerisht nuk e kam marrë dhe nuk e kam lexuar. Mirëpo po e ndjej si obligim pasi që jam njëri ndër ata që kërkova atë ditë me shty dhe me sqaruar, me u sqaruar me rregulloren e re. Tani, nuk është mirë, bile që te çështja e varrimit, çështja e ceremonive mortore. Këqyrim edhe të favorizojmë koncesionara, kompania, drejt e bir, po këtu duhet me qenë shumë të ndjeshëm edhe në vendimet që i marrim. Pse duhet me aplikuar një qytetar për tu subvencionuar për t'u mbështetur, për t'u paguar shpenzimet e varrimit, kur deri tash ka qenë një vendim i qartë. Janë mbuluar shpenzimet e varrimit nga komuna e Prizrenit, me vlerën që e kemi përcaktuar, ne ka qenë 200 euro deri tash. Pse duhet me apliku? Edhe po ju them, po ju them me plot kuptimin e fjalës që njerëzve kur kanë raste të dhimbjes e raste mortuar, nuk ju bjen mend as me apliku, as i gjendet a e di qysh. Mbi tokë nuk jetë njeriu i pavarrosur, mirëpo nuk është mirë me bërë ndasi të tilla. Pse mund ta aplikoj ose duhet ta aplikoj? Duhet me heq atë klauzolë. Po mbulohen shpenzimet e varrimit. Pikë. Çështja e menaxhimit mandej sigurisht që është mirë me qenë sepse ndërmarrja publike ajo është e të gjithë neve edhe më e mirë është ajo me i menaxhuar këtu me i kry këto punë qysh i ka kryer deri tash, sa me hap probleme të tjera edhe me hap debate të tjera rreth koncesionarëve, rreth shfrytëzuesve edhe të kësaj lamiye të ndjeshme. Kështu që sinjerisht po ju them kemi dilema. Kemi shumë dilema derisa nuk kemi të qartë çka po votojmë. Faleminderit.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Edhe njëherë për me i heq dilemat që i ka Hazizi. Jo nuk i kam veç unë. Ti thaj se s'kemi lexuar, këta të tjerët që e kanë lexuar e kanë aty. Këta besoj që e kanë qartësuar edhe dilemën. Nuk aplikohet, por subvencionimi bëhet në praktikën që ka ndodhur deri sot. Po për me ardhë deri aty duhet me pasë vendime pasuese, se ne po flasim për një dokument tjetër, për një rregullore që rregullon diçka tjetër. Vendimi për mbulim të shpenzimeve është vendim që e merr kryetari i komunës. Normal duke u bazuar edhe në këtë rregullore edhe në rregulloren tjetër për subvencionet që i kemi. Domethënë se besoj që dikush tenton edhe mendon këtu me e kthi në gjendje të mëparshme kur po e përmend atë Karanfili të panevojshme. Ndërkohë sa i përket çështjes së menaxhimit të varrezave, ta kemi të qartë. Ekoregjioni e ka bërë vetëm varrimin. Nuk i ka menaxhuar varrezat. Vetëm e ka kryer shërbimin e varrimit në pamundësi me kryer dikush tjetër. Tash ne po flasim për varreza të një periudhe 100 vjeçare. Një projekt që është punuar me vite të tëra për me ardhë deri te kjo ditë. Kontrata me koncesionerin është e kryer, është e nënshkruar, ne nuk mundem me u kthi mbrapa. Edhe bëhet fjalë për investime, Ekoregjioni nuk mundet me investu, nuk mundet me ndërto, nuk mundet me e mirëmbaj. Ekoregjioni ka një profil tjetër të punës në qytetin tonë, edhe e dihet se cili është ajo. Pavarësisht që në periudha të ndryshme e kemi ngarkuar edhe me këtë shërbim, për shkak se s'kemi pasur opsione të tjera. Pra po flasim për një kompani e cila ka me bë mirëmbajtjen, investimet, varrimin, në një hapësirë ku planifikohet me pas varrim për 100 vite të ardhshme. Domethënë nuk mund Ekoregjionin një kompani e pastrimit, me bë kontratë për investime në një hapësirë të varreza ku parashihet edhe me

dokumentat e planifikimit, e ku besoj që edhe qyteti i Prizrenit edhe të gjithë qytetarët e meritojnë me pas varreza të mirëmbajta dhe të mirëfillta. Qysh i kemi sot? Në çfarë gjendje? Domethënë shërbimi që kryhet sot është shërbim varrimi, nuk është shërbim mirëmbajtje. Për atë i kemi në gjendje të keqe. Kështu se t'i kemi të qartë temat.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Falenderit nënkryetar. Levent Bush, mandej edhe Karanfil Haxhillari.

Levent Bus (KDTP): 21:27- 23:40

Karanfil Haxhillari (LVV): Tani dul që unë thënë të drejtën kam hyrë në e-prokurim edhe kërkoja kontratën a ka ndonjë kontratë me koncesionarin por nuk gjeta. Në këtë rast nënkryetari thotë që kontrata është e nënshkruar dhe pyetja tjetër është qysh mundemi ne me votu një rregullore derisa nuk e kemi kontratën. A unë me sa e kam kuptuar që kontrata nënshkruhet pasi të kryhet rregullorja. Bëhet rregullorja dhe në bazë të rregullores përcaktohen kushtet të cilat konsicionari qysh nëpër disa nena edhe thuhet. Por këtu tash paska edhe kontratë të nënshkruar me konsicionarin dhe neve nuk e di pa e parë kontratën qysh mundemi me marrë një vendim për me bërë edhe këtë rregullore.

Sevil Kazaz (Ythp): 24:46 – 27:00

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Kazaz. Po nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Sa i përket koncesionit të Karanfil, nuk mundesh me gjetur në zyrat të prokurimit sepse kjo është bën 2017. Ka kaluar me sistem PPP, partneritet publik-privat. Është votuar në qeveri, domethënë ka shkuar me sistem të partneritetit publik-privat dhe këto kontrata kalojnë në një kolegji ndërministror. Nëse e njihet si se si funksionon kontrata e partneritetit publik-privat, janë kontrata të mëdhaja që shkojnë në qeveri. Ministri i Financave i udhëheq, edhe ministrat e linjës pastaj janë pjesë e panelit ku kjo votohet e ka një procedurë që me ja nis që tash ja dy vjet shkon. Domethënë si procedurë. Edhe sa i përket bashkësisë Islame, ndarjes së parcelave, na dhe atë ditë jemi pajtuar këtu, nuk ka ndarje për familjet kështu individualisht, por ka komunitet fetar që këtë punë e ka të rregulluar me dokumente të brendshme. Në rastin e varrezave familjare e ka komuniteti katolik. Domethënë, ta keni parasysh që ne i kemi konsultuar të gjithë. Edhe si terminologji e përbashkët, aty figuron dikund që te ata lejohet, po te rregulloret e brendshme të Bashkësisë Islame, këto janë të përcaktuara qysh edhe besoj që ne, ashtu që kemi biseduar në seanc atë ditë, varrimin do ta bëjmë në bashkëpunim me komunitetet fetare. Sipas rregullave që ata i praktikojnë, sepse e kemi tash të futur edhe në rregullore. Kështu që, ju mundeni me votu, mundeni dhe mos me votu. Sa kohë që nuk e votoni, për aq kohë do të vonohet fillimi i punimeve për varrim në këtë hapësirë. Dhe ju e dini që varrezat aktuale janë në një gjendje të rëndë, nuk ka vende. E kemi njoftimin edhe zyrtar prej Ekoregjonit që nuk ka më mundësi me varrosë aty dhe tash kjo punë është në dorën e ju. Ato që kemi mujt me i përfshi, e që lejohen me u përfshi, janë përfshi. Ka dhe ndonjë detaj ndoshta që s'ka mund të bëhet pjesë. Ndërkohë, ajo që tha Hazizi, aplikim, nuk ka aplikim. Terminologjia juridike e parasheh aplikim edhe për pensionistët edhe për personat me aftësi të kufizuar. Po ata nuk aplikojnë. Ka vendimmarrje. Domethënë, si terminologji juridike q'ashtu shkruhet. Ne sun e ndërrojmë, sepse rregullorja bazohet në këto dokumenta. Po për atë punë e kemi cekur në me një nen që merret një vendim i veçantë prej kryetarit të komunës ose prej

kuvendit komunal, se varësisht prej kompetencave. Kryetari i ka do kompetenca në mbulimin e këtyre rasteve, do që s'i ka, i bjen në kuvend. Për qatë është organ kolektiv me marrë vendime për kompetencat që s'i delegohen kryetarit të komunës. Kështu që, këtu ka shumë pak paqartësi nëse do me i tejkalu edhe me kryer një punë me ecë përpara. Në fund të fundit nuk është dokument i pandryshueshëm, edhe nesër, edhe mbasnesër. Këto rregullore ndryshohet. Ju e dini që këtu na vjen çdo vit rregullorja për tarifa. Çdo vit e ndryshojmë se lëviz, ec koha, lëvizin gjërat, ndërrohet rregullorja. Lëviz edhe këtu, ndërrohet edhe kjo. Domethënë përse janë organet kolektive me i ndërruar dokumentet, me i rregulluar, me i plotësuar, nëse kanë defekte në implementim, që ne kemi e pruar shpejt në rregullore që e kemi votuar vjet, sepse po e shohim që në disa pika nuk po mundemi me kryer do punë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Qemal Krasniqi fjalën e ka, po?

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Thjesht deshta veç një pyetje me ja bë nënkryetarit. Vetëm e di me na treguar, kush është ai koncesionisti meqë tha kontratën e keni nënshkruar, edhe sa sipërfaqe ka hapësirë ajo pjesë e varrezave. Dhe kush do të menaxhoj me tonat sipërfaqe për sa vjet, për 100 vjet? Kaq.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Me emër nuk e di për besë, personin e njoh po qysh quhet tash firma aty se di. Kontrata 20-vjeçare nuk është 100-vjeçare. Varrezat janë të planifikuara për 100-vjet. Kontrata është për 20 vjet, me mundësi vazhdimi nëse eventualisht i plotëson kushtet edhe përmbush kontratën të cilën e ka kaluar në Komitetin Ndërmindor për Partneritet Publiko-Privat. Ka qenë procesi gjatë, ka filluar në kohën e Ramadan Mujës, shumë gjatë ka shkuar, ju e dini ai vend njëherë është shpronësuar, edhe është marrë prej AKP-së, pastaj me një vendim të gjykatës në kohën e kryetarit Haskuka, është rikthyer prapë në pronësi të AKP-së. Tani prapë ne e kemi nisur procedurën, e kemi rikthyer prapë në pronësi të komunës, edhe i kemi paguar obligimet që kanë dalë për 10% shin e punëtorëve të AKP-së, dhe sot prona është pronë e definuar si titullar komuna e Prizrenit. Domethënë, në aspektin legjislativ, gjithçka ka përfunduar. Ndërkohë kontrata e PPP-së është kryer diku besoj në 2017 nëse s'jam gabim. Tash mund me luajt me muaj.

Qemal Krasniqi (LDK): Hapësira, sa hapësira?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Po më duket është 58 hektar, 58 hektar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit nënkryetar, Petrit Hoxha, po.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Nënkryetar, është thashë kjo thotë që është për 20 vjet. A llogaritet prej datës kur hy në funksion apo prej datës kur është nënshkruajt? Se nëse i bjer prej datës kur është nënshkruajt, i bjer diku edhe 11 vjet me pas kontratë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Jo, kjo hyn në fuqi prej datës kur fillon me u implementu edhe me u përmbush kontrata. Se s'ka filluar me u përmbush.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, a ka dikush tjetër? Atëherë, po ju falenderoj për kontributin që i dhatë në këtë pikë edhe sqarimet i morët nga nënkryetari, vetëm t'i numërojmë sa jemi prezent, 23 janë këto.

Haziz Hodaj (LDK): Edhe njëherë, se nuk u deklarova për shkak dilemave, po kërkoj ndjesë për ndërhyrjen. Na e kemi ngritur problemin e varrezave vazhdimisht, prej vitit 2013 atëherë kur e thashë atë ditë kur ka qenë Hasan Hasani drejtor. Edhe prej atëherë Prizreni ka pasur problem me me vendin për varreza. Duke parë këtë, këtë gjendje dhe duke ditur që ne në ndërkohë gjatë ecjes mandej mundemi me ndryshuar dhe rregulloren, sigurisht që nuk do ta bllokojmë rregulloren.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotri Hodaj. Faleminderit. Prezent jemi 22 anëtarë, jemi në votim të kësaj pike. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Ju lutem ta mbani dorën lartë derisa t'i numërojmë. 16 për, pra prezent po e konstatoj edhe njëherë që jemi 23, 16 për, 2 kundër, 1 abstenim. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju falënderoj të gjithëve dhe mirupafshim në seancën e radhës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRIZREN:

16/06/2026

16. 06. 25

Për: Znj. Antigona Bytyqi – Kryesuse e kuvendit - Prizren

Përmes : Z. Shaqir Totaj - Kryetar i Komunës - Prizren

Nga: Sulltan Badalli - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet e Financa

Përgaditur nga: Lulzim Sylejmani – Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa

Lënda: KAB – Korniza afatmesme buxhetore për 2026-2028

E nderuar znj. Antigona Bytyqi – Kryesuse e Kudit,

Me këtë shkresë ju përcjellim Propozim vendimin dhe materialet për KAB – Kornizen afatmesme të buxhetit për vitin 2026-2028 të komunës së Prizrenit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2, pika d), nenit 24 paragrafit 1 dhe nenit 40 paragrafi 2, pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028 të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Pëne dhe Trasnsfereve) [hermes Qarkoresw buxhetore 2026/01 për Komunitat si dhe finansncimi nga randet nderqeveritare dhe kufijeve fillestar të buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimin për 2027-2028, nenit 27 paragrafit 1 dhe nenit 77 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr.01/011-5643 të datës 15.10.2028 pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me ___ qershor 2024, miratoi këtë:

PROPOZIM - VENDIM
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESËME BUXHETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR
PERIUDHËN 2026-2028

1. Propozohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Shpenzimeve për vitin 2026-2028, në kufit fillestar sipas Qarkores 2026/01 për Buxhetin Komunal të Prizrenit për periudhën 2026-2028 e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
2. Pjesëpërberëse e këtij propozim vendimi është Korniza Buxhetore e Shpenzimeve 2026-2028 e shpërndarë për vitin 2026 në kategori:
 - Paga dhe mëditje _____ 31,851,741 euro,
 - Subvencione _____ 5,521,785 euro,
 - Mallra dhe shërbime _____ 14,200,234 euro,
 - Shpenzime komunale _____ 1,069,493 euro,
 - Investime Kapitale _____ 22,002,059 euro.
 - Subtotal _____ 75,045,312 euro
3. Ky propozim vendim hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin komunal, ___ ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe ___ ditë pas publikimit në webfaqe të Komunes.

Propozuesi:

Kryetari i Komunës

SHAQIR TOTALJ



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Qershor 2026



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosova



Kuvendi Komunal Prizren

Skupstina Opstina Prizren
Municipal Assembly Prizren

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2026 - 2028

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Prizrenit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2026/01 për Komunat si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për 2027-2028. Ky dokument i ka kushtuar rendesi të veçantë alokimit të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponente barazisë gjinore duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punësimit, përfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj. të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prizrenit, si dhe projektet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbushë dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mirëqenies sociale dhe familjare me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2026– 2028 gjithnjë duke u bazuar në :


- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor. KAB promovon rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë, ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore. Kjo është në përputhje me KASH-in.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2026-2028 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2026-2028. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



Prioritet e Komunës

II

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi te barabarta për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimin e grave dhe burrave fermerë.
-

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile me theks te vecante te gratë dhe grupet ne nevojë
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive per vajza dhe djem.

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Ne baze te hulumtimit te nevojave te grave dhe burrave Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Ofrimi i mundësive per pjesëmarrje aktive te grave dhe grupeve ne nevojë;

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe nevojave te grave dhe burrave.

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve (burrave dhe grave) duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve per gratë dhe burrat

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2025-2027 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

II. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtë për drejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026-2028 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe domografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë të grave dhe burrave në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Prizrenit në periudhën afatmesme buxhetore 2026-2028 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

❖ **OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE**

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2026 – 2028 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve” dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2026 – 2028 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2026/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve .

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afat mesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të Planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vite tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

Deklarata e MISIONIT

Misioni i komunes eshte qe te promovon dhe ofron zhvillim dhe rritje te mireqenies se qytetareve duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar sherbime sa ma cilesore ,ne kohe dhe te barabarte per te gjithë, te ndjeshëm per nevojat e grave dhe burrave.

❖ **Objektivat e Komunës së Prizrenit:**

